

Dr. Kole Pavllov

Prof. dr. Gjorgji Pavllovski

# GJEOGRAFIA

PËR KLASËN VIII

NË ARSIMIN FILLOR NËNTËVJEÇAR



2020

**Autorë:**

Dr. Kole Pavlov  
Prof. dr. Gjorgji Pavlovski

**Recensues:**

Prof. dr. Mirjanka Maxheviq - kryetare  
Suzana Jakimovska - anëtare  
Vasko Lazarevski – anëtar

**Dizajni:**

Pepi Damjanovski

**Përkthyes:**

Refail Sulejmani

**Lektor:**

Abdulla Mehmeti

**Redaktor profesional:**

Prof. dr. Resul Hamiti

**Tirazhi:**

Me vendim për miratimin e librit mësimor nga lënda Gjeografia për klasën e VIII-të në arsimin fillor nëntëvjeçar, nr. 26-467/1 të datës 17. 06. 2019, të miratuar nga Komisioni kombëtar për libra mësimorë.

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски“, Скопје

372.891.4/.5(075.2)=811.18

PAVLOV, Kole

Gjeografia : për klasën VIII për arsim fillor nëntëvjeçar / Kole Pavlov, Gjorgji Pavlovski. - Shkup : Ministria e Arsimit dhe Shkencës Republika e Maqedonisë së Veriut, 2020. - 140 str. : илустр. (претежно во бои) ; 26 см

Превод на делото: Географија / Коле Павлов , Ѓорѓи Павловски

ISBN 978-608-226-845-3

1. Pavlovski, Gjorgji [автор]

COBISS.MK-ID 51739653

## PARATHËNIE

Të dashur *nxënës, arsimtarë dhe prindër,*

**Libri mësimor, Gjeografia për klasën VIII**, në arsimin fillor nëntëvjeçar është shkruar në bazë të programit mësimor dhe parimeve të Konceptit dhe Metodologjisë për përgatitjen dhe vlerësimin e teksteve shkollore.

**Qëllimi kryesor** i përmbajtjes së librit është arritja e njohurive lidhur me karakteristikat natyrore-gjeografike dhe socio-ekonomike të kontinentit evropian dhe ta afrojë atë me nxënësin si përdorues i fundit. Në këtë drejtim, përveç qasjes parësore, metodologjike-didaktike nga arsimtari, libri mësimor mund të ofrojë një bazë solide për mësimin, por edhe për përqendrimin në aktivitetet e punës në shtëpi dhe shkollë që hapin këndvështrime dhe dimensione të reja në të kuptuarit e shkencës së gjeografisë.

**Libri mësimor ka karakter pune** dhe mundëson mësim gradual përmes hulumtimit, të menduarit, zbulimit dhe arritjes së konkluzionit, me çka nxënësi sillet në gjendjen e pjesëmarrësit aktiv në përvetësimin e njohurive të reja, duke shmangur monotoninë e vëzhgimit pasiv. Në librin mësimor vëmendje e veçantë i kushtohet vëllimit dhe peshës së përmbajtjeve mësimore, të cilat nuk janë të ngarkuara me materiale faktografike. Ato janë të shkurtra, të qarta, të hollësishme dhe të ilustruara mjaftueshëm me materiale figurative dhe hartografike. Libri mësimor është pasuruar me statistika të reja në formën e tabelave, skemave dhe grafikëve, të cilët mund të përdoren për analizën e rishikimit, krahasimin dhe nxjerrjen e konkluzioneve për ndonjë fenomen, objekt ose problem të veçantë.

**Aparatura e pasur didaktike**, krahas tekstit themelor, në masë të mjaftueshme i thëllon njohuritë e kureshtarëve dhe nxënësve që të përparojnë më shpejt në mësim, si dhe ofron kontroll të shpejtë të njohurive dhe shkathtësive të fituara. Këto, nxënësi shpesh i zbaton në situata konkrete, zgjidhja e të cilave kërkon mësim dhe hulumtim të pavarur përmes detyrave ose përgatitjes së projekteve të ndryshme, për realizimin e të cilave është i pashmangshëm përdorimi i literaturës shtesë dhe i teknologjisë informatike-kompjuterike.

Autorët ju urojnë punë të suksesshme

# REKOMANDIME PËR PËRDORIMIN E LIBRIT MËSIMOR

Detyrë e rekomanduar hyrëse për shfrytëzimin e njohurive paraprake për konceptet e përbajtjes.

### POZITA GJEOGRAFIKE, KUFLITË DHE MADHËSIA E EVROPËS

**Dikësoni interaktivë karta:**

- Rrafshina, mendoni dhe përkrahni kuptimin e zërimit kontinenti?
- Dikësoni me origjinën e zërimit kontinenti Evropë?
- Në kartën gjeografike të botës, gjyqi dhe përcaktoji vendndodhjen e kontinentit të Evropës!

**POZITA GJEOGRAFIKE** Evropa shtrihet në hemisferën veriore. Pika më të shkuarëve të Evropës në të gjerësisë gjeografike janë në ... a) Kepi Nordkap, ndodhet në 71° të gjerësisë gjeografike veriore, ... ose në jug të saj kepi Marok, është vendosur në 36° të gjerësisë gjeografike jugore. Kontinenti i Evropës kryesht është vendosur në bordin e mesit, vlerat në Tëkalë me distancë më të shkurtër nga **Polin e Veriut**, në krahasim me distancën me Ekuatorin. Pika perëndimore e Evropës është e vendosur në krahin **Roka** në 9° 31' të gjatësisë gjeografike perëndimore. Pika më e zgaturt në lëndje është e vendosur në malin e **Uralit** në 47° të gjatësisë gjeografike lëndore. Sipas kësaj, Evropa, me gjatësi më të madha të territorit të saj, karakterizohet me gjatësi gjeografike lëndore dhe me një zonë parake prej rreth 7,000 km.

Evropa ka pozitën më të favorshme gjeografike të kontinenteve në botë. Përmasë **Oqeanit Atlantik**, ajo shtrihet me **Amerikën Veriore** dhe **Amerikën Jugore**, kurse përmasë Detit Madhe dhe **Atlantik**. Përmasë këtyre deteve dhe **Kanallit të Suezit** çonin më tej.

Evropa në botë

**Australia**  
**Antarctica**

Me të rëndësishme detare për në Azi dhe në **Australi**, Kontinenti i Evropës është gjithashtu urtë që i lidh kontinentin e Azisë dhe të Afrikës për kalimin më të shkurtër. Kontinenti i Evropës gjithashtu ka **lidhje tokësore**. Ajo janë më të përhapitura në kontinentin e Azisë. Evropa është e lidhur edhe me kontinentet më të largëta nga një numër liqenve ujore.

**KUFLITË** Evropa është kontinenti gjuhësisht që mbulon pjesën perëndimore të kontinentit të madh Euroaziatik. Evropa është e rrethuar me ujë nga të anët. Në veri, kufijtë e saj i shprehin **Oqeanit të Ngjirë të Veriut**. Në jug dhe në Detin Mendhë, kurse në perëndim i shprehin **Oqeanit Atlantik**. Vidien kufijtë lindor i Evropës është tokësor: **Vija kufitare natyrore**.

Fakte interesante që do të stimulojnë kureshtjen dhe dëshirën tënde për hulumtime.

Materiali hartografik për përfshirjen hapësinore të objekteve dhe fenomeneve.

Fotografi dhe incizime satelitore të cilat në mënyrë ilustruese dhe faktike e plotësojnë tekstin kryesor.

Tekst shtesë për kureshtarët dhe nxënësit që përparojnë më shpejt në mësim.

Ushtrime me aplikimin e teknologjisë informatike-komputerike e cila ofron mundësi të gjera për zgjerim dhe përvetësim të njohurive dhe aftësive të reja.

midis Evropës në perëndim dhe Azisë në lindje, çon përmasë objekteve relievore dhe hidrografike, të cilat natyrisht dhe pa ndihmë të veçantë të tyre vlerë të veçantë gjeografike. Kështu, ajo shprehin përgjigje: **Urali, Urali, Urali, Urali, Deti Barentsi, Legjendë Komu-Manki (sumit Maniç), Deti të Zi, ngushticat të Bosforit, Deti Marmara, ngushticat së Dardanelleve dhe Detit Egje**. Evropa, me kufijtë e saj jugorë është më e afërta me kontinentin e Afrikës, ndodhet nga ky kontinent nga **Ngushtica e Gjibraltarit**, 14 km e gjatë.

**MADHËSIA** Brenda kufijve të përmendur, Evropa mbulon një sipërfaqe prej 10,5 milionë km<sup>2</sup>. Në krahasim me kontinentin e gjatë, është rreth kontinentin në të vogël. Erazë më i madh vlerën se kontinenti i Australisë. Por Evropa sipas numrit të banorëve (742 milionë), rëndëse e treta midis kontinenteve, pas Azisë dhe Afrikës.

**Tabela 1: Gjatësi numerike e popullsisë së botës sipas kontinenteve**

Kontinenti	Azia	Afrika	Evropa	Amerikë V.	Amerikë J.	Australia
Banorë	4.400.000.000	1.200.000.000	742.000.000	579.000.000	423.000.000	24.000.000

**Përshkrimi i shkurtër:**

- Evri Evropës është nga faza e **Evrit**, që do të thotë të kalë të perëndimit detit. Ky gjatësi bazon nga gjatësi e përpjete të **Uralit** brekës dhe asiro-babilonias. Të gjithë vendet në perëndim të **Ferikës**, ata krahin **Avrit**.
- Vija kufitare natyrore midis Evropës dhe Azisë nuk përfshin me kufijtë antarë, kulturorë dhe gjuhësisht midis këtyre dy kontinenteve, të cilat kanë natyrshëm gjatësi historike. Përmasë parakohet i vija kufitare midis këtyre dy kontinenteve është detyrë komplekse dhe specifike. Detyrë më tërësi këto natyrshëm të shprehin se vlerë nga më të lartë detare në Detin e Zi. Detyrë autori në vendet fjalorë madje e trajtojë malin **Kazak** të gjera e Evropës!

**Për kontrolluar njohuritë e ditura:**

- Si shprehin gjerësisë gjeografike e Evropës?
- Cilat mal pasqyro kufijtë natyrore midis Evropës dhe Azisë?
- Cila vlerë të Evropës midis kontinenteve shprehin gjatësi historike?
- Mendoni dhe lista territorit në të madhe me ata përkrahë në të gjerësisë:
  - a) Indonidhi
  - b) Roka
  - c) Urali
  - d) Urali
  - e) perëndim
- Vlerat e saj e gjerësisë gjeografike me simbolin e saj:
  - a) Evropa është kontinenti më i vogël në botë
  - b) Gjibraltari e ndan Evropën nga Afrikën
  - c) Evropa ka ditësi në Oqeanin e Detit
  - d) Evropa ka gjatësi gjeografike veriore

**Detyrë me aplikimin e TIC-ut:**

- Me ndihmën e lista pikatoste softuarke (Google Map ose Google Earth) gjyqi dhe kontinentin në të cilat është gjerësisë gjeografike më të shkuarëve **Barent** të Evropës në raport me anët e botës!
- Gjyqi dhe raport distancën më të vogël të Evropës në raport me Azinë në ngushticat e Bosforit dhe të Dardanelleve!
- Tabela nga vija e gjatësisë gjeografike distancën nga pika më veriore detare në pikën më jugore të Evropës!

Tabela dhe grafikë me të dhëna statistikore që e pasurojnë, por nuk e rëndojnë tekstin kryesor, të përshtatshme për analiza dhe diskutime në klasë.

Pyetje dhe detyra për kontrollimin e njohurive të fituara.

## MJETET E REKOMANDUARA, LITERATURA DHE BURIMI SHITESË I NJOHURIVE PËR ARRITJEN E QËLLIMEVE TË PROGRAMIT TË KLASËS SË TETË

- Atlasi gjeografik i botës;
- Hartat memecë për arsimin fillor;
- Libër leximi nga gjeografia për klasën e gjashtë (Gjorgji Pavllovski, 1997);
- Shtetet e botës (Drzave sveta): Karel Natek & Marjeta Natek, Lubjanë, 2000;
- www.worldatlas.com;
- Google Map, Google Earth.

# PËRMBAJTJA

PARATHËNIE .....	3
REKOMANDIME PËR PËRDORIMIN E LIBRIT MËSIMOR .....	4

## **TEMA I: KARAKTERISTIKAT NATYRORE-GJEOGRAFIKE TË EVROPËS..... 7**

POZITA GJEOGRAFIKE, KUFIJTË DHE MADHËSIA E EVROPËS.....	8
PËRTHYERJA BREGDETARE E EVROPËS.....	11
KARAKTERISTIKAT E RELIEVIT TË EVROPËS.....	15
NDIKIMI I FAKTORËVE KLIMATIKË NDAJ KLIMËS SË EVROPËS.....	19
ZONAT KLIMATIKE-VEGJETATIVE NË BREZIN E MESËM TË NXEHTËSISË NË EVROPË.....	22
ZONA KLIMATIKE-VEGJETATIVE NË BREZIN E FTOHTË NË EVROPË.....	25
PELLGJET LUMORE DHE LUMENJTË NË EVROPË.....	28
LIQENET NË EVROPË.....	31

## **TEMA II: KARAKTERISTIKAT SOCIO-GJEOGRAFIKE DHE NDARJA RAJONALE E EVROPËS..... 35**

KARAKTERISTIKAT THEMELORE TË POPULLSISË SË EVROPËS .....	36
PËRKATËSIA GJUHËSORE E FETARE DHE DIVERSITETI I POPULLSISË NË EVROPË.....	39
KULTURA, TRADITA DHE ZAKONET E POPULLSISË NË EVROPË.....	42
VENDBANIMET NË EVROPË .....	45
NDARJA RAJONALE DHE POLITIKE E EVROPËS.....	48

## **TEMA III: VEÇORITË GJEOGRAFIKE TË EVROPËS JUGORE..... 51**

KARAKTERISTIKAT GJEOGRAFIKE TË EVROPËS JUGORE.....	52
GADISHULLI BALLKANIK.....	54
BULLGARIA .....	54
GREQIA.....	57
SERBIA .....	59
SHQIPËRIA DHE KOSOVA.....	61
KROACIA DHE SLLOVENIA.....	64
MALI I ZI E BOSNJA DHE HERCEGOVINA .....	68

GADISHULLI APENIN .....	71
ITALIA, SAN MARINO DHE VATIKANI .....	71
GADISHULLI PIRINEJ.....	74
SPANJA, PORTUGALIA DHE ANDORA.....	74
RREZIKIMI, NDOTJA DHE MBROJTJA E MJEDISIT TË EVROPËS JUGORE .....	78

## **TEMA IV: VEÇORITË GJEOGRAFIKE TË EVROPËS PERËNDIMORE..... 83**

EVROPA PERËNDIMORE .....	84
BRITANIA E MADHE DHE REPUBLIKA E IRLANDËS .....	84
FRANCA .....	87
BENELUKSI .....	89

## **TEMA V: VEÇORITË GJEOGRAFIKE TË EVROPËS VERIORE..... 93**

EVROPA VERIORE.....	94
SUEDIA .....	94
NORVEGJIA DHE FINLANDA.....	97
DANIMARKA DHE ISLANDA.....	100

## **TEMA VI: VEÇORITË GJEOGRAFIKE TË EVROPËS QENDRORE..... 105**

EVROPA QENDRORE .....	106
GJERMANIA .....	106
POLONIA.....	109
ÇEKIA DHE SLLOVAKIA .....	111
ZVICRA DHE AUSTRIA .....	115
HUNGARIA.....	119
ROMANIA .....	121

## **TEMA VII: VEÇORITË GJEOGRAFIKE TË EVROPËS LINDORE..... 125**

EVROPA LINDORE .....	126
RUSIA .....	126
UKRAINA.....	129
BJELORUSIA DHE MOLDAVIA.....	132
LETONIA, ESTONIA DHE LITUANIA .....	135
FJALORI I FJALËVE MË PAK TË NJOHURA .....	138
LITERATURA E PËRDORUR.....	139

*Termt kryesore:*

- *Evropa;*
- *Kontinenti;*
- *Pozita gjeografike;*
- *Kufijtë dhe vija kufitare natyrore;*
- *Vija bregdetare;*
- *Gadishulli dhe ishulli;*
- *Gjiret dhe fjordet;*
- *Rrjedhat;*
- *Masivët malorë;*
- *Ultësirat;*
- *Luginat;*
- *Dinat;*
- *Rrafshnaltat;*
- *Qafat malore;*
- *Llojet klimatike;*
- *Brezi klimatik;*
- *Stepi;*
- *Tajga;*
- *Tundra;*
- *Hidrografia;*
- *Burimet ujore.*

# TEMA I: KARAKTERISTIKAT NATYRORE- GJEOGRAFIKE TË EVROPËS

POZITA GJEOGRAFIKE, KUFIJTË DHE MADHËSIA E EVROPËS .....	8
PËRTHYERJA BREGDETARE E EVROPËS .....	11
KARAKTERISTIKAT E RELIEVIT TË EVROPËS.....	15
NDIKIMI I FAKTORËVE KLIMATIKË NDAJ KLIMËS SË EVROPËS .....	19
ZONA KLIMATIKE-VEGJETATIVE NË BREZIN E MESËM TË NXEHTËSISË NË EVROPË .....	22
ZONA KLIMATIKE-VEGJETATIVE NË BREZIN E FTOHTË NË EVROPË.....	25
PELLGJET LUMORE DHE LUMENJTË NË EVROPË .....	28
LIQENET NË EVROPË .....	31

# POZITA GJEOGRAFIKE, KUFIJTË DHE MADHËSIA E EVROPËS



## Diskutim interaktiv hyrës:

- Rikujtohu, mendo dhe përshkruaj kuptimin e termit kontinent!
- Diskuto mbi origjinën e emrit të kontinentit Evropë!
- Në hartën gjeografike të botës gjeje dhe përcaktje vendndodhjen e kontinentit të Evropës!

**POZITA GJEOGRAFIKE Evropa** shtrihet në hemisferën veriore. Pikat më të skajshme të shtrirjes së saj gjeografike janë: në veri, kepi **Nordkap**, ndodhet në  $71^\circ$  të gjerësisë gjeografike veriore, kurse në jug të saj, kepi **Marok**, është vendosur në  $36^\circ$  të gjerësisë gjeografike jugore. Kontinenti i Evropës kryesisht është i vendosur në brezin e mesëm verior të Tokës me distancë më të shkurtër në **Polin e Veriut**, në krahasim me distancën me Ekuatorin. Pika perëndimore e Evropës është e vendosur në kepin **Roka**, në  $9^\circ 31'$  të gjatësisë gjeografike perëndimore. Pika më e zgjatur në lindje është e vendosur në malet e **Uralit** në  $67^\circ$  të gjatësisë gjeografike lindore. Sipas kësaj, Evropa, me pjesën më të madhe të territorit të saj, karakterizohet me gjatësi gjeografike lindore dhe me një zonë paralele prej rreth 7.000 km.



Evropa ka pozitën më të favorshme gjeografike midis kontinenteve në botë. Përmes **Oqeanit Atlantik**, ajo lidhet me **Amerikën Veriore** dhe **Amerikën Jugore**, kurse përmes Detit Mesdhe me Afrikën. Përmes këtij deti dhe **Kanalit të Suezit** çojnë rrugët








Dardanelet

më të rëndësishme detare për në **Azi** dhe në **Australi**. Kontinenti i Evropës është gjithashtu urë që i lidh kontinentin e Azisë dhe të Afrikës për kohën më të shkurtër. Kontinenti i Evropës gjithashtu ka **lidhje tokësore**. Ato janë më të përfaqësuara në kontinentin e Azisë. Evropa është e lidhur edhe me kontinentet më të largëta nga një numër i linjave ajrore.

**KUFIJTË** Evropa është kontinenti gadishull që mbulon pjesën perëndimore të kontinentit të madh Euroaziatik. Evropa është e rrethuar me ujë nga tri anët. Në veri, kufijtë e saj i lagin ujërat e **Oqeanit të Ngrirë të Veriut**. Në jug del në Detin Mesdhe, kurse në perëndim i prek ujërat e **Oqeanit Atlantik**. Vetëm kufiri lindor i Evropës është tokësor. **Vija kufitare natyrore**,



Bosfori



**Bosfori** - ngushticë që lidh Detin Marmara dhe Detin e Zi dhe e ndan pjesën evropiane të Turqisë (Rumelinë) nga Azia (Anadoli). Në të është shtrirë qyteti i Stambollit. Është vërtetuar shkencërisht se Bosfori ka ekzistuar 7,500 vjet më parë. Në të kaluarën, niveli i ujit në Detin e Zi dhe në

Detin Mesdhe ishte shumë më i ulët se sot. Si rezultat i shkrirjes së ajsgjegëve të mëdhenj dhe hyrjes në vetë Bosforin, niveli i ujit është ritur ndjeshëm.

Nën ngushticë kalon tuneli hekurudhor „Marmara“, i lëshuar në përdorim më 29 tetor të vitit 2013.



Ngushtica e Gjibraltarit

midis Evropës në perëndim dhe Azisë në lindje, çon përmes objekteve relievo dhe hidrografike, të cilat natyrshëm dhe pa mëdyshje veçojnë dy njësi të veçanta gjeografike. Kështu, ajo shtrihet përgjatë: malit **Ural**, **lumit Ural**, **Detit Kaspik**, **Luginës Kumo-Manike (lumit Maniç)**, **Detit të Zi**, **ngushticës së Bosforit**, **Detit Marmara**, **ngushticës së Dardaneleve** dhe **Detit Egje**. Evropa, me kufirin e saj jugor është më e afërt me kontinentin e Afrikës. Ndahet nga ky kontinent nga **Ngushtica e Gjibraltarit**, 14 km e gjerë.

**MADHËSIA** Brenda kufijve të përmendur, Evropa mbulon një sipërfaqe prej 10,5 milionë km<sup>2</sup>. Në krahasim me kontinentet e tjerë, është ndër kontinentet më të vegjël. Është më i madh vetëm se kontinenti i Australisë. Por Evropa sipas numrit të banorëve (742 milionë), renditet e treta midis kontinenteve, pas Azisë dhe Afrikës.

**Tabela 1:** Gjendja numerike e popullsisë së botës sipas kontinenteve

Kontinenti	Azia	Afrika	Evropa	Amerika V.	Amerika J.	Australia
Banorë	4.400.000.000	1.200.000.000	742.000.000	579.000.000	423.000.000	24.000.000



**Për njohuri të thelluara:**

- Emri Evropë rrjedh nga fjala asire „Ereb“, që do të thotë tokë ku perëndon dielli. Kjo fjalë buron nga gjuha e popujve të lashtë fenikas dhe asiro-babilonas. Të gjitha vendet në perëndim të Fenikisë, ata i quanin „Ereb“.
- Vija kufitare natyrore midis Evropës dhe Azisë nuk përkon me: kufijtë etnikë, kulturorë dhe gjuhësorë midis këtyre dy kontinenteve, të cilët kanë ndryshuar gjatë historisë. Prandaj, përcaktimi i vijës kufitare midis këtyre dy kontinenteve është detyrë komplekse dhe specifike. Deri më tani janë bërë ndryshime të shpeshta në vijën nga mali Ural deri në Detin e Zi. Disa autorë në vendet fqinje madje e trajtojnë malin Kaukaz si pjesë e Evropës!

**Për të kontrolluar njohuritë e fituara:**

- Si është pozita gjeografike e Evropës?
- Cili mal paraqet kufirin natyror midis Evropës dhe Azisë?
- Cilin vend e zë Evropa midis kontinenteve sipas sipërfaqes dhe popullsisë?
- Mendo dhe lidhi termat në të majtë me ata përkatës në të djathtë:
  - a) Nordkap                      jug
  - b) Roka                            veri
  - c) Marok                         lindje
  - d) Ural                             perëndim
- E vërtetë ose e gabuar? (shënoni me simbolet: ✓ ose ✗)
  - a) Evropa është kontinenti më i vogël në botë                      b) Gjibraltari e ndan Evropën nga Afrika
  - c) Evropa ka dalje në Oqeanin e Qetë                                      d) Evropa ka gjerësi gjeografike veriore



**Detyra me aplikimin e TIK-ut:**

- Me ndihmën e disa paketave softuerike (Google Map ose Google Earth) gjeni dhe konstatooni se në cilat shtete gjenden pikat më të skajshme (kepet) të Evropës në raport me anët e botës!
- Gjeje dhe llogarite distancën më të vogël të Evropës në raport me Azinë në ngushticat e Bosforit dhe të Dardaneleve!
- Tërhiqe një vijë të drejtë dhe zbulo distancën nga pika më veriore deri në pikën më jugore të Evropës!

# PËRTHYERJA BREGDETARE E EVROPËS



## Diskutim interaktiv hyrës:


- Rikujtohu për kuptimin e termave: ishull, gadishull dhe gjil!
- Në cilin gadishull në Evropë gjendet Republika e Maqedonisë së Veriut dhe cilat dete e rrethojnë këtë gadishull?
- Në hartën gjeografike të Evropës gjeji dhe numëroji pesë ishujt më të mëdhenj në Detin Mesdhe!

Evropa ka bregdetin më të përthyer midis kontinenteve në botë. Në brigjet e saj gjenden një numër i madh i: **gadishujve, gjireve, ngushticave, kanaleve, kepeve** e të tjera. Përveç kësaj, në dete ka një numër të madh të ishujve dhe grupe ishujsh. Ishujt dhe gadishujt mbulojnë deri në 30% të kontinentit, dhe gjatësia totale e vijës bregdetare tejkalon 38.000 km. Megjithatë, jo të gjitha brigjet e Evropës janë përthyer në mënyrë të njëtrajtshme.

**BREGDETI VERIOR** Bregdeti verior është i përthyer më dobët. Në të ka vetëm dy gadishuj të mëdhenj - **Kola** dhe **Kanin**. Midis këtyre gadishujve, thellë në kontinent shtrihet **Deti i Bardhë**. Ai është i lidhur me **Detin e Barentsit** në veri, ku ndodhen ishujt: **Toka e Re, Toka e Franc Josifit** dhe **Ishujt e Shpicbergut (Svalbard)**.



Nordkap është komunë në qarkun Finmark, në pjesën veriore të Norvegjisë. Qendra administrative e komunës është Honingsvåg, qytezë me 2.400 banorë. Përfshin një sipërfaqe prej 925 km<sup>2</sup> dhe ka popullsi prej 3.228 banorë.



Nordkap - kepi më verior në Evropë

**BREGDETI PERËNDIMOR** Bregdeti perëndimor i Evropës është më i përthyeri. Përthyeshmëria më e madhe gjendet në **Gadishullin Skandinav**. Në brigjet e këtij gadishulli ka shumë gjire të ngushta dhe të thella me anë të larta dhe të pjerrëta, të quajtura **fjorde**. Përpara fjordeve gjenden mijëra ishuj të vegjël shkëmborë që e bëjnë të vështirë lundrimin. Në jugperëndim të Gadishullit Skandinav janë ishujt më të mëdhenj në bregdetin perëndimor. Këto janë **Britania e Madhe** dhe **Irlanda**, kurse në veriperëndim ndodhet **Islanda**. Në bregun perëndimor të Evropës, Oqeani Atlantik formon disa dete periferike. Më i madhi nga këto është **Deti i Veriut**. Në lindje të tij, thellë në kontinent, shtrihet



La Manshi, ose Kanali Anglez është ngushticë e Oqeanit Atlantik që e ndan ishullin e Britanisë së Madhe nga Franca veriore dhe që i lidh Oqeanin Atlantik me Detin e Veriut. Është i gjatë rreth 563 km dhe i gjerë rreth 240 km.

Ngushtica e Doverit është pjesa më jugore e kanalit, e cila është vetëm 34 km e gjerë dhe ndodhet në pjesën më lindore të kalimit.

Kanali është relativisht i cekët, me një thellësi mesatare prej rreth 120 m në pjesën më të gjerë deri në 45 m në pjesën midis Doverit dhe Kales.

Në vitin 1994 nën La Mansh u hap një tunel hekurudhor 50 kilometra i gjatë, që paraqet tunelin e dytë hekurudhor më të gjatë në botë.



Përthyerja e bregdetit perëndimor

**Deti Baltik.** Ai degëzohet në më shumë gjire. Më të mëdhenj prej tyre janë: **Gjiri Botnik, Finlandës** dhe i **Rishit**. Deti Baltik prej Detit të Veriut ndahet nga **Gadishulli Jiland (Jutlanda)** dhe ngushticat: **Skagerak** dhe **Kategat**. Bregdeti perëndimor i Evropës karakterizohet gjithashtu nga gadishuj dhe gjire të mëdha. Prej gadishujve më të njohur janë: **Jiland (Jutland)**, **Normandia** dhe **Bretanja**, kurse nga gjiret, **Gjiri i Biskajit** dhe kanali **La Mansh**. Ngushticat më të vogla në bregun perëndimor, të cilat paraqesin grykëderdhe të lumenjve, quhen **estuare**.

**BREGDETI JUGOR** Bregdeti jugor i Evropës është më i përthyer. Ka tre gadishuj të mëdhenj: **Pirinej, Apenin** dhe **Ballkanik**. Gadishulli Pirinej ndahet prej Afrikës nga **Ngushtica e Gjibraltarit**, kurse gadishulli Ballkanik nga Azia, përmes ngushticave të **Bosforit** dhe **Dardaneleve**. Gadishulli Apenin është më i afërt me kontinentin e Afrikës përmes ishullit të **Sicilisë**. Në bregdetin jugor të Evropës, Deti Mesdhe degëzohet në disa dete bregdetare: **Deti Tiren, Jon, Adriatik, Egje, Marmara, Ligor, Deti i Zi**, dhe ai **Azov**. Të gjitha detet në Mesdhe janë të lidhur me ngushtica dhe kanale, që kanë një rëndësi të veçantë për trafikun detar. Ekzistojnë disa ishuj dhe grupe arkipelagësh në ujërat e Detit Mesdhe. Ishujt më të mëdhenj janë: **Sicilia, Sardenja, Korsika** dhe **Kreta**. Nga gjiret më të njohur janë: **Gjiri i Gjenevës, Lionit, Boka e Kotorit, Gjiri i Selanikut** e të tjerë.



**Tabela 2:** Sipërfaqja e gadishujve më të mëdhenj në Evropë.

Gadishulli	Gad. Skandinav	Gad. Pirinej	Gad. Apenin	Gad. Ballkanik
Sipërfaqja (km <sup>2</sup> )	773.500	596.700	131,337	470.000

**Për njohuri të thelluara:**

- Pas zbulimeve të mëdha gjeografike në shekullin XV-të, bregdeti perëndimor i Evropës fitoi trafik dhe rëndësi të madhe ekonomike. Prej atëherë rrugët kryesore detare janë zhvendosur nga Mesdheu në Oqeanin Atlantik. Kjo mundësoi zhvillimin e porteve të mëdha në këtë bregdet, si **Londra, Haveri, Roterdami** e të tjerë. Prej tyre fillojnë rrugët kryesore të botës për në kontinentet e tjera.
- Përveç gjireve më të mëdha, bregdeti evropian karakterizohet nga një lloj i veçantë i gjireve më të vegjël si: **fjorde, rijase** dhe **estauare**. **Fjordet** gjenden në Gadishullin Skandinav dhe janë gjire të ngushta në formë gryke me anët e pjerrëta të formuara si rezultat i zhytjes së pjesës së poshtme të luginës së vjetër akullnajore. **Rijaset** janë karakteristikë e Gadishullit Pirinej dhe janë gjire të thella dhe të degëzuara në disa gryka që vijnë nga zhytja e pellgut të poshtëm të degëzimit më të madh. Estuaret, të cilat gjenden në bregdetin perëndimor të Evropës, janë rrjedhë lumenjsh të zhytur gjatë valës kur niveli i detit rritet për 10-15 metra. **Estuare** kanë lumenjtë: **Tamiz, Garona, Laba** e të tjerë.
- Bregdeti evropian karakterizohet gjithashtu nga ishuj më të vegjël të ndarë në disa grupe ishujsh të arkipelagëve. Të tillë ka në **Detin Adriatik** dhe në **Detin Egje** (Kikladi dhe Sporades).





**Për të kontrolluar njohuritë e fituara:**

- Si është përthyerja bregdetare e Evropës?
- Cili bregdet karakterizohet nga gadishuj të mëdhenj?
- Cilat ngushtica i lidhin Detin e Veriut dhe Detin Baltik?
- Mendo dhe lidhi termat në anën e majtë me ata përkatës në anën e djathtë:
  - a) Gad. Kola                      bregdeti jugor
  - b) I. Islandës
  - c) Sicilia                      bregdeti perëndimor
  - d) Gad. Apenin
  - e) Skagerak                      bregdeti verior
  - f) Kreta
- E vërtetë ose e gabuar? (shëno me simbolet: ✓ ose ✗)
  - a) Irlanda është ishulli më i madh në bregdetin perëndimor.
  - b) Gadishulli Skandinav është më i madhi në Evropë.
  - c) Sardenja është ishull në bregdetin perëndimor.
  - d) Gadishulli Apenin ka dalje në Detin e Veriut.

- Në hartë shkruaj gadishujt dhe ishujt më të mëdhenj në Evropë!



Google



**Detyra me aplikimin e TIK-ut:**

- Me ndihmën e disa paketave softuerike (Google Map ose Google Earth) gjeji, hulumtoji dhe përshkruaj fjordet e Gadishullit Skandinav!
- Gjeje kanalin La Mansh dhe llogaritni gjerësinë e tij më të vogël. Cilat vende i ndanë ky kanal?
- Bëje një tabelë duke i përdorur programet (Word ose Excel), në të cilat do t'i klasifikoni ishujt, gadishujt dhe gjiret më të mëdhenj nga: bregu verior, perëndimor dhe jugor i Evropës!

# KARAKTERISTIKAT E RELIEVIT TË EVROPËS



## Diskutim interaktiv hyrës:

- Rikujtohu se çfarë është relievi dhe cilat janë format kryesore të relievit?
- Shikoje hartën e Evropës dhe përcaktoje sipas ngjyrave, cili reliev është më i përfaqësuar?
- Në cilat pjesë të Evropës janë malet e përhapura dhe ku janë ultësirat?

**Relievi** në Evropë është shumë i larmishëm sipas vjetërsisë dhe mënyrës së formimit, ashtu edhe sipas madhësisë së formave të relievit. Relievi më i madh përfaqësohet me një numër të: **maleve, rrafshnaltave, ultësirave** dhe **luginave**, kurse relievi më i vogël përfaqësohet me: **kodra, fusha, pellgje të lumenjve, gremina**, etj. Sipërfaqe më të madhe në relievin e Evropës përfshijnë ultësirat, me 60%. Pas tyre vijojnë tokat kodrinore me 24%, por më pak i takojnë malet, me 16%. Lartësia mesatare mbidetare e relievit në Evropë është 300 metra. Prandaj, Evropa paraqitet si kontinenti më i ulët në botë.




Relievi i Evropës

## MALET DHE RRAFSHNALTAT

Relievi malor në Evropë përbëhet nga: male të larta, të mesme dhe të ulëta, të cilat në thelb ndryshojnë sipas **vjetërsisë** dhe **gjenezës** (origjinës). Sipas vjetërsisë, në Evropë përfaqësohen: **vargmalet e reja** dhe **masivet e vjetra malore**, kurse sipas origjinës ato janë: **malet tektonike** (të palosura ose të shpërndara) dhe **malet vullkanike**.

Paraqitja skematike e brezave të lartësisë në Evropë (në %)



## VARGMALET E REJA

Vargmalet e reja janë krijuar në kohën e re. Ato janë të lidhura me kurora disa qindra kilometra të gjatë. Këto male janë përgjithësisht të larta dhe kanë maja të pjerrëta dhe shpate të pjerrëta. Vargmalet e reja shtrihen përgjatë gjysmës jugore të Evropës. Në perëndim këto male shtrihen përgjatë brigjeve të Oqeanit Atlantik dhe përfshijnë pjesët më jugore të kontinentit. Kjo kurorë në Evropë fillon me **Malet Pirineje** në perëndim. Pirinejet pasohen nga **Alpet**. Ato, nga ana tjetër, shtrihen në kurora paralele, midis të cilave janë **rrafshnaltat** e gjera. Alpet kanë mbi 15 maja mbi 4.000 metra të larta, kurse maja më e larta në Evropë është **Mon Blan** (Maja e Bardhë), e lartë 4.807 metra. Kalimin trafikor nëpër kurorat alpike e mundësojë

**qafat malore** (Simplon, Sent Gothard, etj.). Rrafshnaltat mund të shtrihen midis vargmaleve malore. Një nga rrafshnaltat më të gjera në pjesët alpike të Evropës është **Rrafshnaltat Zvicerane**. Nga Alpet ndahen dhe degëzohen: **Apeninet**, **Dinaret** dhe **Karpatet**. **Apeninet** kanë drejtim jugor shtrirjeje. Ata përfshijnë zonën e gadishullit Apenin dhe vazhdojnë përmes Sicilisë deri në Afrikën Veriore. Përgjatë Apenineve janë të pranishme **malet vullkanike** (Vezufi, Etna, etj.). **Dinaret**, nga ana tjetër, përfshijnë pjesët perëndimore të Gadishullit Ballkanik. Drejtimi i shtrirjes së tyre është në juglindje dhe jug, përgjatë Detit Adriatik. Ata njihen si Malet Dinarike, të emërtuar sipas malit më të gjatë në mesin e tyre, **Dinara** (160 km). Malet Dinarike janë bashkuar me **Malet e Sharrit** që vazhdojnë në Greqi dhe prej andej në brigjet e Azisë së Vogël. Në verilindje, Alpet vazhdojnë dhe bashkohen me malet **Karpatet**, të cilat në të kundërt janë dukshëm më të ulëta dhe më të kalueshme. Karpatet bëjnë një hark në jug dhe në Gadishullin Ballkanik ndërlidhen me **Malin e Vjetër** (Ballkan), që shtrihet deri në Detin e Zi. Në lindje, ky varg i ri malor, nëpërmjet Kaukazit, vazhdon në Azi.

**MALET E VJETRA TË MËDHA** Masivet e vjetra malore në Evropë ndryshojnë nga malet e reja, pasi kanë shpate më të buta dhe maja të rrafshuara. Ato janë vendosur në **male të veçanta** ose **masivë malorë**. Midis tyre, përmes prejardhjes tektonike, u formuan **gropa - lugina**. Malet e vjetra janë lehtësisht të kalueshme dhe të përshtatshme për ndërtimin e rrugëve dhe hekurudhave për shkak

të **shpateve** të ulëta përgjatë kreshtave të tyre. Drejtimi i zgjatjes në këto male nuk është specifikuar. Kjo është arsyeja pse ato shtrihen në drejtime të ndryshme. Nga malet e vjetra në Evropë, **Malet Skandinave** janë më të njohura në veri dhe perëndim të kontinentit. Në këto male gjenden rrafshnaltat të gjera të njohura si **fjelde**. Malet e vjetra të mëdha mbulojnë zonën e Britanisë së Madhe dhe Irlandës. Në veri të Alpeve dhe Karpatëve shtrihen



Alpet



Rodopet



male të vjetra të mëdha, ndër të cilat më të njohura janë: **Masivi Qendror, Ardenet, Vogezet, Malet e Renit** etj. Në jug të Pirinejve në Gadishullin Pirinej shtrihen **Malet Iberike** dhe **Kastiliane**. Midis maleve të Gadishullit Iberik ndodhet rrafshnalta më e madhe evropiane - **Mezeta**. Në Gadishullin Ballkanik, malet e vjetra të mëdha janë malet e **Grupit malor të Rodopeve**. Grupi i maleve të vjetra përfshin gjithashtu malin më të gjatë në Evropë - **Ural**, i cili e ndan Evropën nga Azia.

**ULTËSIRAT** Ultësirat mbulojnë pjesën më të madhe të relievit të Evropës. Më e madhe është **Ultësira Evropiane**. Shtrihet në veri nga Pirinejet, në perëndim të Gjirit të Biskajit, në malet e Uralit në lindje. Kjo ultësirë është më e gjera në pjesët e saj lindore dhe quhet **Ultësira e Evropës Lindore**. Sipas sipërfaqes, Ultësira e Evropës Lindore mbulon pothuajse gjysmën e kontinentit të Evropës. Kjo ultësirë në veri të Detit Kaspik zbrit më poshtë edhe nën nivelin e detit - **depression**. Vetëm në disa vende në këtë ultësirë paraqiten sipërfaqe më të larta dhe rajone që



Ultësira e Panonisë



Harta topografike e Evropës

shfaqen në formën e rrafshnaltave të ulëta (**pllajave**), lartësia e të cilave nuk kalon 400 metra, siç është (**Rrafshnalta e Rusisë së Mesme**). Nga ultësirat e tjera më të njohura janë: **Ultësira e Lombardisë** në luginën e lumit Po, **Ultësira e Panonisë** në mes dhe **Ultësira e Vilahisë** në rrjedhën e poshtme të lumit **Danub**. Në Gadishullin Pirinej më të njohura janë: **Andaluzia** dhe **Aragona**. Të gjitha këto ultësira kanë tokë pjellore. Ato janë të mbuluara me rërë të imët dhe argjilë që grumbulloheshin në të kaluarën kur këto ultësira ishin pellgje deti. Për dallim nga të tjerët, Ultësira e Lombardisë u formua nën ndikimin e materialit sedimentar nga lumenjtë e Alpeve, në të kaluarën ato ishin gjire në Detin Adriatik. Nga sedimentet me rërë me origjinë detare ose akullnajore në ultësirat evropiane, të ndërmjetësuar nga era ose faktorë të tjerë të jashtëm, në të kaluarën u krijuan **duna** ranore. Dunat ranore gjenden gjerësisht në: Spanjë, Holandë, Skoci, Danimarkë, Poloni, Bullgari dhe shtete të tjera.

**FORMAT SPECIFIKE** Imazhi i plotë i relievit të Evropës plotësohet me forma të vogla relievesh që janë ngulitur në reliev të madh, kurse veçantia unike e tyre (specifikimi) vjen nga vetë dimensionet, origjina (kryesisht nga forcat erozive) dhe vjetërsia (kryesisht forma më të reja, formimi i të cilave zgjat edhe sot). Përveç rrafshnaltave të lartpërmendura, qafave malore dhe dunave, relievi evropian ka edhe forma të **relievit të vjetër vullkanik**: (kupola, kratere, pllaka), **lugina akullnajore**, **fusha karstike**, **shpella**, **shkëmbinj**, **kanione**, **ujëvara**, **delta**, etj.



**Për njohuri të thelluara:**

- **Fjeldet** janë zona të gjera të rrafshuara (**pllaja**) të Gadishullit Skandinav në gjenezën (origjinën) e të cilave ndikim të madh kishin akullnajat e dikurshme me të cilat ishte mbuluar gadishulli gjatë epokës së fundit të akullit.
- Depresionet konsiderohen ultësira që janë ulur nën nivelin e detit. E tillë është Ultësira Parakaspikë, e ulur 28 metra nën nivelin e detit.
- Akullnaja më e gjatë në Alpe - **Aleç** ndodhet në Zvicër dhe ka gjatësi 23 km.



**Për të kontrolluar njohuritë e fituara:**

- Në veri të Alpeve dhe Karpateve shtrihen malet e vjetra. Numëroji ato!
- Cilat pjesë të Evropës janë ultësira?
- Cila degë e vargmaleve të reja të Evropës shtrihet në territorin e republikës sonë?
- E vërtetë ose e pavërtetë? (trego me simbolet: ✓ ose ✗)
  - a) Alpet janë malet më të larta në Evropë
  - b) Mezeta është rrafshnalta më e madhe në Evropë
  - c) Ultësira e Panonisë ndodhet në Gadishullin Apenin
  - d) Malet Skandinave janë vargmale të reja.
  - e) Dinaret shtrihen në Gadishullin Ballkanik.



**Detyra me aplikimin e TIK-ut:**

- Me ndihmën e disa paketave softuerike (Google Map ose Google Earth) gjeji dhe konstato, përgjatë të cilave shtete në Evropë shtrihen vargmalet e reja dhe ku gjenden majat më të larta evropiane!
- Hulumto, zbullo dhe bëj tabelë për prezantim në orë duke përdorur programet (Excel ose Word) me të dhëna themelore për disa nga malet dhe majat më të larta në Evropë, si dhe ultësirat më të përhapura!
- Duke përdorur faqet e internetit, përpiku të mësosh për shfrytëzimin ekonomik të maleve më të mëdha në Evropë. Jepi përshtypjet e tua në klasë!

# NDIKIMI I FAKTORËVE KLIMATIKË NDAJ KLIMËS SË EVROPËS




## Diskutim interaktiv hyrës:

- Rikujtohu, mendo dhe përshkruaj kuptimin e termave: koha dhe klima!
- Prej çka varet klima në një vend?
- Cila është rëndësia e relievit dhe deteve në klimën e ndonjë hapësire?


Klima paraqet regjim shumëvjeçar të motit në një hapësirë të caktuar. Formimi i saj varet nga disa faktorë klimatikë. Midis tyre, më të rëndësishëm janë: **gjerësia gjeografike, afërsia me oqeanet dhe detet, lëvizja e rrymave të ngrohta ose të ftohta të detit, drejtimi i erërave, tiparet e relievit** etj.

**GJERËSIA GJEOGRAFIKE** Gjerësia gjeografike e përcakton këndin në të cilin bien rrezet e diellit dhe rrezatimin vjetor (drita e diellit), të cilat çojnë në ngrohjen e tokës dhe ajrit. Ky faktor klimatik tregon ndikime mesatare klimatike në Evropë, pasi pjesa më e madhe e kontinentit ndodhet në zonën e mesatare veriore. Vetëm pjesa më veriore e saj është në zonën e ftohtë.




Insolancioni (rezatimi diellor) në Evropë për orë në vit

**AFËRSIA E DETEVE DHE OQEANEVERE** Ndikim të madh në klimën në Evropë ka afërsia e: **Oqeanit Atlantik, Oqeanit të Ngrirë të Veriut dhe Detit Mesdhe** në jug. Oqeani Atlantik e përcakton klimën në Evropën Perëndimore, pasi mbi të formohen masa të lagështa ajri, të cilat janë më të ngrohta në dimër dhe më të freskëta se ajri tokësor gjatë verës. Përveç kësaj, nëpër Oqeanin Atlantik qarkullon **rryma e ngrohtë e Golfit**, që kalon përgjatë brigjeve të Evropës Perëndimore dhe Gadishullit Skandinav dhe mbulon pjesë të Evropës veriore. Si rezultat i kësaj rryme të ngrohtë, brigjet detare të Evropës Perëndimore dhe asaj Veriore kurrë nuk ngrijnë. Ndikimi i klimës së Atlantikut shtrihet më thellë në Evropën kontinentale përmes ultësirave dhe luginave të lumenjve. Gjithashtu, Deti i ngrohtë i Mesdheut ka efekt domethënës në zbutjen e dimrave në pjesët jugore të Evropës, por edhe në formimin e masave të lagështa të ajrit që bartin reshje në kontinent.




Rrymat e ngrohta dhe të ftohta detare

**ERËRAT** Ndikim të veçantë në klimën në Evropë kanë **erërat perëndimore**. Ato fryjnë në lindje dhe merita e tyre më e rëndësishme është krijimi i masave ajrore të Atlantikut, nga të cilat krijohen reshjet në pjesët qendrore dhe lindore të kontinentit. Erërat nga jugu bartin masa ajri shumë të ngrohta në Evropën Jugore nga Afrika Veriore. Në verë ato janë të nxehta dhe të thata, ndërsa në dimër janë të ngopura me lagështi nga Deti Mesdhe. Nga veriu dhe verilindja, përmes Ultësirës së Evropës Lindore, në muajt e dimrit, masat e ftohta të ajrit arktik depërtojnë thellë në kontinent, duke mbizotëruar mot i ftohtë dhe temperatura të ulëta.



Ndikimi i faktorëve klimatikë

**RELIEVI** Relievi gjithashtu ka ndikim të rëndësishëm në klimën në Evropë. Ultësirat dhe luginat nuk paraqesin pengesë për depërtimin e erërave perëndimore kah lindja. Vargmalet e larta malore, siç janë Alpet, Karpatet dhe Malet Skandinave, i ndalojnë masat e lagështa të ajrit dhe ndikojnë në regjimin e reshjeve. Në malet e larta, avujt e ujit shpesh kondensohen dhe kjo është arsyeja pse reshjet janë më të mëdha.



Zonat në lindje të tyre marrin një sasi më të ulët reshjesh. Ndikimi i favorshëm me zbutjen e butë të dimrave që vijnë nga ndikimi i Detit Mesdhe në Evropën Jugore është parandaluar nga degët e larta malore. Ndikimi i saj është në zonat e ulëta bregdetare dhe nëpër luginat e lumenjve të degëve të tyre.

Si pasojë e ndikimit të faktorëve të ndryshëm klimatikë në Evropë ekzistojnë dy **breza termik** dhe shtatë **lloje klimatike**.



**Për njohuri të thelluara:**

- Faktorët klimatikë shkaktojnë rënie të temperaturave minimale në tokën evropiane edhe deri në  $-52\text{ }^{\circ}\text{C}$ , në pellgun e Peçorës. Temperaturat më të larta në Gadishullin Pirinej rriten deri në  $48\text{ }^{\circ}\text{C}$ .
- Reshjet vjetore të shiut në Evropë zvogëlohen nga perëndimi në lindje. Pjesët perëndimore të kontinentit marrin sasi vjetore prej 1000-2000 mm, kurse pjesët lindore ekstreme nga 350-500 mm. Me sasi më të madhe të shiut janë disa pika matëse në Skoci dhe Mal të Zi (deri në 5000 mm), kurse më e thata është Ultësira Pre-Kaspikë me rreth 200 mm sasi të ujit vjetor.
- Nëse nuk ka ndikim të rrymës së Golfit, dimrat në Britani të Madhe dhe Norvegji do të ishin 7 deri  $10\text{ }^{\circ}\text{C}$  më të ftohta se zakonisht.



**Për të kontrolluar njohuritë e fituara:**

- Cili është ndikimi i rrymës së Golfit në klimën në Evropë, por edhe rëndësia e saj ekonomike për vendet që dalin në Atlantik?
- Çfarë ndikimi ka Deti Mesdhe në klimën e Evropës Jugore?
- Mendo dhe përpiku të gjesh përgjigje: pse pjesët qendrore dhe lindore të Ballkanit janë një nga rajonet më të thata në Evropë?



**Detyra me aplikimin e TIK-ut:**

- Me ndihmë të kërkuesit në internet përpiku të zbulosh temperaturat mesatare vjetore të disa qyteteve të mëdha evropiane në: Evropën Veriore, Perëndimore, Lindore dhe Jugore! Bëje një tabelë me rezultatet! Nxjerr përfundime nga krahasimi që mund të prezantosh në klasë!
- Hulumto dhe zbulo emrat dhe ndikimet e disa erërave kombëtare dhe rajonale që dallohen në disa vende evropiane!

# ZONAT KLIMATIKE-VEGJETATIVE NË BREZIN E MËSËM TË NXEHTËSISË NË EVROPË



## Diskutim interaktiv hyrës:

- Rikujtohu, mendo dhe përshkruaje klimën e vendit tonë!
- Prej çka varet klima në vendin tonë?
- Si është bota bimore dhe shtazore në vendin tonë dhe më gjerë në Ballkan?

Pjesa më e madhe e Evropës, nga kepi Marok në jug deri në rrethin Arktik në 66 ° të gjerësisë gjeografike veriore, i përket **brezit verior mesatar të nxehtësisë** së Tokës. Në këtë brez të nxehtësisë përfaqësohen pesë tipa klimatikë të përhapur në pesë **breza klimatikë (zona)**. Në secilin brez klimatik është zhvilluar një botë e veçantë bimore dhe shtazore, ashtu që në kuptim më të gjerë mund të flasim për **zonat klimatike-vegjetative**.




**ZONA KLIMATIKE-VEGJETATIVE ATLANTIKE** Zona klimatike-vegjetative atlantike shtrihet në pjesën perëndimore të Evropës, nga pjesa veriore e: Spanjës, Francës Perëndimore, Holandës, Belgjikës, Irlandës, duke përfshirë bregdetin perëndimor të Norvegjisë. Tipi klimatik i Atlantikut karakterizohet me verë të ftohtë dhe dimra të butë dhe me shi. Reshje të shiut bien gjatë gjithë vitit, me sasi deri në 2000 mm. Rryma e Gofit ka rëndësi të veçantë për klimën e Evropës Perëndimore. Duke kaluar përgjatë brigjeve të Evropës Perëndimore, ajo arrin në veri të Evropës dhe e ngroh bregdetin në muajt e dimrit. Kjo është arsyeja pse portet më veriore në Evropë, **Hamerfest** dhe **Murmansk**

në Gadishullin Skandinav, nuk ngrijnë dhe kanë rëndësi të veçantë për lundrimin në dimër. Në dimër, si pasojë e klimës atlantike, janë karakteristike mjegulla shumë të shpeshta dhe të dendura. Nga bota bimore në këtë zonë klimatike më të përfaqësuara janë **barishtet** dhe **pyjet gjetherënëse**. Nga bota shtazore janë të gjithë ato kafshë dhe shpendë që gjenden edhe në pjesët e tjera të Evropës.

**ZONA KIMATIKE-VEGJETATIVE KONTINENTALE** Kjo zonë shtrihet në pjesët qendrore dhe lindore të Evropës, në fushën e: Ultësirës së Evropës Lindore, Vllahisë dhe Panonisë. Klima kontinentale

karakterizohet me verë të nxehtë dhe të thatë, kurse me dimra shumë të ashpër dhe të ftohtë. Në varësi të reshjeve, tipi kontinental është i ndarë në tipin kontinental me lagështi dhe tipin kontinental stepor. **Tipi kontinental me lagështi** shtrihet në pjesët veriore të zonës, të cilat janë të mbuluara me sipërfaqe të mëdha pyjore: **pishë, bredh, dëllinjë** etj. Kjo bashkësi pyjore halore njihet si **tajga**.

Shtrihen nga Gadishulli Skandinav në perëndim, deri te Mali Ural në lindje, dhe prej aty vazhdon përmes pjesës veriore të Azisë, deri në Oqeanin e Qetë. Reshjet vjetore të shiut në këtë tip klimatik bien nga 500 në 700 mm. Pyjet e përziera shtrihen në jug të tajgës. Përfaqësuesit më të zakonshëm të kafshëve këtu janë: kaprolli, ujku, derri i egër, dhelpra etj. **Tipi i klimës kontinentale stepore** është i pranishëm në Ukrainë, Ultësirën e Vllahisë dhe Panonisë. Ky lloj karakterizohet nga dimra të thatë dhe të ftohtë dhe verë të gjatë dhe të thatë. Reshjet vjetore bien nga 300-600 mm. Klima ka kushtëzuar zhvillimin e një bashkësie bimore stepike të ulët. Shumë lloje të kafshëve jetojnë në stepë, kurse nga pyjet e larta janë të pranishme bimët e larta.



Alpet



Tajga

**ZONA KIMATIKE-VEGJETATIVE SUBTROPICALE (MESDHETARE)** Kjo

zonë është përhapur në zonën bregdetare të Detit Mesdhe, si dhe detet e saj bregdetare dhe në ishuj. Tipi i klimës subtropike (Mesdhetare) mbizotëron në këtë zonë. Karakterizohet nga vera të thata e shumë të nxehta dhe dimra të butë e me shi. Dëbora është një dukuri e rrallë në këtë zonë, përveç në malet më të larta. Në këtë zonë klimatike, bota bimore përfaqësohet nga vegjetacioni specifik - **makiet** (kaçubat). Ato janë bimë të ulëta halore, të cilat janë rezistente ndaj thatësisë. Në këtë tip klimatik rriten : qiparisi, pisha bregdetare, ulliri, limoni, portokalli, fiku e të tjerë.

Përveç tre zonave kryesore klimatike-vegjetative në zonën e brezit të mesëm të nxehtësisë në Evropë, në varësi të relievit dhe faktorëve të tjerë klimatikë, ekzistojnë edhe zona me klimë të butë kontinentale dhe klimë malore.

**Tipi i klimës së butë-kontinentale** është kalimtar dhe haset në zonat ku takohet, përzihet dhe gërshetohet klima kontinentale dhe mesdhetare, siç janë pjesët qendrore të Gadishullit Ballkanik, si dhe pjesë të Evropës Qendrore. Karakterizohet nga verë mesatarisht e nxehtë dhe dimër mesatarisht i ftohtë dhe një sasi e mjaftueshme reshesh gjatë gjithë vitit. Në zonat me këtë lloj klime, janë të pranishme si bimët halore ashtu dhe bimët gjetherënëse.

**Tipi i klimës malore** është i pranishëm në të gjitha malet më të larta në të gjithë Evropën dhe shfaqja e tij nuk varet nga gjerësia gjeografike, por nga lartësia mbidetare. Karakteristikat e tij janë: dimra të gjatë, të ftohtë dhe me dëborë dhe vera të shkurtra dhe të freskëta. Për shkak të rënies së temperaturave, së bashku me rritjen e lartësisë mbidetare, bota bimore shtrihet në kate.



Pylli mesdhetar



**Për njohuri të thelluara:**

- Klasifikimi i parë gjithëpërfshirës dhe sistematik i tipeve dhe brezave të klimës në Evropë dhe në botë u bë nga klimatologu gjerman Köppen në vitin 1918. E modifikuar dhe e plotësuar, përdoret akoma edhe sot në bazat e klimatologjisë. Llojet kryesore klimatike, Kepen i ka shënuar me shkronja të mëdha të latinishtes: A, B, C, D dhe E.
- Mund të ketë ndryshime të mëdha vjetore të temperaturave midis stacioneve meteorologjike në dy zona të ndryshme klimatike. Për shembull, në Stokholm (Suedi) temperatura mesatare vjetore e ajrit (7 °C) është dy herë më e ulët sesa në Gjevgjeli në vendin tonë (14 °C) ose në Lisbonë (Portugali) me 15 °C.
- Vendi më me shi në Evropë është stacioni meteorologjik malazez Cërkvicë!



**Për të kontrolluar njohuritë e fituara:**

- Ku ndihet ndikimi i llojit të klimës atlantike në Evropë?
- Cilat janë tiparet e klimës mesdhetare në Evropën Jugore?
- Cilat ultësira në Evropë kanë klimë kontinentale?
- E vërtetë ose jo e vërtetë? (Shëno me simbolet ✓ ose ✗)
  - a) Ultësira e Evropës Lindore ka klimë mesdhetare.
  - b) Klima në Moskë karakterizohet nga dimra të butë dhe vera të nxehta e të thata.
  - c) Vendet e Evropës Perëndimore kanë një numër të madh ditësh me shi në vit.
  - d) Italia dhe Greqia ndodhen në zonën klimatike mesdhetare.



**Detyra me aplikimin e TIK-ut:**

- Me ndihmë të kërkuesit në internet përpiqu t'i mësosh sasitë vjetore të të reshurave në disa qytete të mëdha evropiane në Evropën Perëndimore dhe atë Jugore. Bëje një tabelë me rezultatet! Nxjerr përfundime nga krahasimi që mund t'i prezantosh në klasë.
- Hulumto dhe zbulo më shumë detaje klimatike për qendrat dimërore më të vizituara në Evropë! Paraqite rëndësinë ekonomike të klimës malore!



# ZONA KLIMATIKE-VEGJETATIVE NË BREZIN E FTOHTË NË EVROPE




## Diskutim interaktiv hyrës:

- Kujtoni dhe përgjigjuni sa zgjat një ditë polare dhe një natë polare. - Cila është arsyeja për këtë?
- Ku janë të shpërndarë: ariu polar, lepuri polar dhe dhelpra polare? - Pse leshi i tyre është i bardhë?
- Cila është rëndësia e relievit dhe deteve në klimën e një hapësire?

Brezi i ftohtë klimatik i Evropës mbulon sipërfaqet kontinentale dhe ishujt në Oqeanin e Ngrirë të Veriut që shtrihen në veri nga rrethi polar verior, ose Ekuatori në gjerësi 66° e 33' të gjerësisë gjeografike veriore. Në zonën e ftohtë ekzistojnë dy zona klimatike-vegjetative: **subpolare** dhe **polare**.

## ZONA SUBPOLARE KLIMATIKE-VEGJETATIVE

Kjo zonë shtrihet në pjesët verilindore të Evropës, që del në **Oqeanin e Ngrirë të Veriut, Gadishullin Kola**, pjesën veriore të ishullit të **Islandës** dhe zonat bregdetare të ulëta të **Ishujve të Shpicbergut, Toka e Re** dhe **Toka e Franc Josifit**. Këtu mbizotëron klima subpolare, e njohur si klimë tundrash. Kjo lloj klime karakterizohet nga dimra të gjatë dhe të ftohtë, të cilët zgjasin nga shtatë deri në dhjetë muaj të vitit dhe vera të shkurta. Temperatura e muajit më të nxehtë të vitit nuk kalon 10 °C. Gjatë verës së shkurtër, bora dhe akulli shkrihen dhe formojnë kënetat të mëdha, të cilat mbulohen nga mjegulla. Rreth kënetave vijnë tufat e shpendëve që ngjallin natyrën. Kjo zonë quhet **tundra**, në të cilën ka bashkësi të veçanta bimore. Zonat më të ftohta të tundrës janë ambient natyror për bimë më të ulëta si **myshku** dhe **likenet**, ndërsa në zonat më



 tundra	 stepat e thata
 tajga	 stepat e lagështa
 flora mesdhetare	 pyjet halore

Harta e bashkësisë bimore në Evropë

të ngrohta janë të përhapura: **bashkësitë e luleve, brez i ulët bimor, shelgu arktik** dhe bimë të tjera të larta. Bota shtazore plotësohet nga: fokat, arinjtë polarë, kaprojtë, mushkrat, dhelprat, lepujt e të tjerë.

### ZONA KLIMATIKE-VEGJETATIVE POLARE

Kjo zonë shtrihet në pjesën më veriore të Evropës, gjegjësisht zonat e vogla të ngrira të **Oqeanit të Ngrirë të Veriut** dhe përreth disa ishujve ku mbizotërojnë temperatura të ulëta. Në këtë pjesë shumë të vogël dhe të pabanuar të Evropës, mbizotëron klima polare. Karakterizohet me dimëra shumë të gjatë dhe të ftohtë, me erëra të forta dhe shumë pak shi, në formën e borës. Në fakt, dimri është stina e vetme e vitit atje, kurse toka është gjithmonë e mbuluar me dëborë dhe akull të përjetshëm. Lloji i klimës polare njihet edhe si klima e akullit të përherëshëm, sepse temperatura në



Brez i polar

muajin më të nxehtë të vitit është e barabartë ose më e ulët se 0 °C. Bota bimore është e rrallë dhe e përfaqësuar nga **bashkësi bimësh më të ulëta**, kurse bota shtazore me: arinj polar, foka, elefant deti, balena, dhelpra polare e të tjera.



Tundra



Dhelpra polare



Dhelpra polare paraqitet në : Norvegji, Islandë, Grenlandë dhe në ishujt përreth, deri në Suedi. Gëzofi i saj ka dy ngjyra: kafe në verë dhe të bardhë si bora në dimër


Ajo është kafshë tipike polare. Është aktive gjatë ditës dhe në mbrëmje. Jeton në grupe të vogla në tundra dhe zona malore. Gërmon vrima, kurse në zonat shkëmbore, mbetet në tokë midis shkëmbinjve ose nën shkurre.

Ushqehet me të vegjëlit e saj me trupa kafshësh të ngordhura pranë brigjeve. Në qershor, femra lind 6-10, por shumë më rrallë 12 të reja. Ata kur lindin janë të verbër dhe fillojnë të shohin pas 10 ditësh.

**Tabela 3:** Temperaturat mesatare mujore dhe vjetore në rajone të ndryshme klimatike: subpolare (Hamerfest), kontinentale (Harkov), atlantike (Liverpool) dhe mesdhetare (Napoli), të shprehura në (°C).

Qyteti	MUAJT												Mesatarja vjetore
	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	
Hamerfest	-5,2	-5,0	-3,7	-1,0	3,2	7,8	11,3	10,5	6,6	2,0	-1,6	-3,8	<b>1,8</b>
Harkov	-4,6	-4,5	-4,5	9,2	15,6	19,3	21,3	20,3	14,4	7,9	0,9	-3,5	<b>8,1</b>
Liverpul	4,8	4,7	6,6	8,7	11,8	14,5	16,5	16,3	14,2	11,1	7,7	5,0	<b>10,2</b>
Napoli	8,7	8,8	11,1	13,2	17,8	21,4	24,3	24,7	21,4	17,1	12,4	9,8	<b>15,9</b>

**Grafiku 1:** Temperaturat mesatare mujore dhe vjetore në rajone të ndryshme klimatike: subpolare (Hamerfest), kontinentale (Harkov), atlantike (Liverpool) dhe mesdhetare (Napoli), të shprehura në (°C).



**Për njohuri të thelluara:**

- Temperaturat mesatare të verës në Ishujt e **Shpicbergut** në zonën e tundrës variojnë nga 4 - 6 °C, dhe dimri rreth - 16 °C. Dimrat në pjesët bregdetare të këtij grupi ishujsh janë relativisht të butë nga pikat e gjera të rrymës së Golfit, thellë në veri të Arktikut.
- Temperaturat e ulëta në zonën e ftohtë të Evropës janë rezultat i netëve të gjata polare, këndi i vogël i prirë i rrezeve të diellit dhe albedo e lartë (indeksi i reflektimit të dritës) nga mbulesa e dëborës, ndërsa ngrohja e sipërfaqes së tokës është minimizuar.
- Fenomeni kuriozitet në brezin e tundrës, gjatë verës së shkurtër dhe të lagësht, është infektimi i mushkonjave, i cili nuk është i zakonshëm për zonat e Tokës me verë të tillë të freskët (të ftohtë).



**Për të kontrolluar njohuritë e fituara:**

- Ku ndjehet ndikimi i llojit të klimës subpolare në Evropë?
- Cilat janë tiparet e klimave subpolare dhe polare në Evropë?
- Si është bota bimore në brezin e ftohtë të Evropës?
- Kush është përfaqësuesi më i madh midis klasës së gjitarëve në brezin e ftohtë të Evropës?



**Detyra me aplikimin e TIK-ut:**

- Gjeji dhe shikoji videot e dokumentuara të tundrave dhe të rajoneve polare. Ndaji përsh-typjet e tua për ambientin dhe botën e gjallë shkurtimisht në orë!
- Përdor program të përshtatshëm (Paint; Corel Draw...) bazuar në ndonjë hartë të Evropës, përpiqu të bësh një hartë klimatike-vegjetative të kontinentit! Puna ekipore, në çifte ose grupe, rekomandohet për një detyrë të tillë.

# PELLGJET LUMORE DHE LUMENJTË NË EVROPË



## Diskutim interaktiv hyrës:

- Rikujtohu dhe përshkruaji elementet e lumenjve: shtrati i lumit, lugina, grykëderdhja dhe pellgu!
- A dini ndonjë pellg lumor të lundrueshëm në Evropë?
- Cila është rëndësia ekonomike e lumenjve?

Evropa ka dy zona kryesore burimore nga të cilat burojnë shumica e lumenjve: **Alpet** dhe **Rrafshnalta e Vajdës**. Lumenjtë në Evropë u përkasin zonave ujëmbledhëse **të hapura** (ekzoreike) dhe **të mbyllura** (endoreike). Të gjithë lumenjtë në Evropë që rrjedhin në pellgjet e detit të hapur u përkasin tri zonave të pellgjeve detare: pellgut të **Detit Mesdhe**, pellgut të **Oqeanit Atlantik** dhe pellgut të **Oqeanit të Ngrirë të Veriut**. Lumenjtë që derdhen në **Detin Kaspik** ose liqene të tjerë u përkasin zonave të mbyllura.

**PELLGU I DETIT MESDHE** Pellgu i Detit Mesdhe përfshin të gjithë lumenjtë që rrjedhin në të ose në detet e tij bregdetare, në jug të **Pirinejve** dhe **vargmalet Alpine-Karpate**. Shumica e lumenjve të këtij pellgu janë të shkurtër, shumë të paqëndrueshëm dhe të varur nga regjimi vjetor i reshjeve. Lumenjtë më të mëdhenj që rrjedhin drejtpërdrejt në Detin Mesdhe janë **Ebro** dhe **Rona**. Megjithatë, më shumë lumenj derdhen në brigjet e Detit Mesdhe. Në Detin Adriatik, derdhen lumenjtë më të mëdhenj: **Drini, Buna, Neretva, Cetina, Po** etj. **Vardari, Struma, Marica, Bistrica** e të tjerë derdhen në Detin Egje. **Danubi, Dniepri** dhe **Dniestri** derdhen në Detin e Zi, kurse **Doni** në detin Azov. Lumi **Danub** (2850 km) është lumi i dytë më i gjatë në Evropë. Buron nga malet **Shvarcvald** në Gjermani dhe rrjedh në nëntë shtete danubiane. Në derdhjen e tij në Detin e Zi, i bashkohen disa degë dhe në derdhje formon deltën e madhe. Lumenjtë **Don, Dniepër** dhe **Dniestër** janë të lundrueshëm dhe kanë potencial të lartë hidroenergjetik. Në të gjithë lumenjtë janë ndërtuar liqene artificiale dhe hidrocentrale. Lumi Don është i lidhur me Volgën me një **kanal të lundrueshëm**. Ky kanal ka krijuar një rrugë të rëndësishme

ujore që lidh Detin Azov dhe Detin e Zi në jug, Detin Kaspik në lindje dhe Detin Baltik në veri.

## PELLGU ATLANTIK

Pellgu i Oqeanit Atlantik përfshin të gjithë lumenjtë që derdhen në Oqeanin Atlantik dhe detet e tij bregdetare. Këta janë lumenjtë e **Gadishullit Pirinej** dhe **Gadishullit Skandinav**, lumenjtë që rrjedhin nga **Masivi Qendror Francez** dhe lumenjtë nga ishujt e **Britanisë së Madhe** dhe **Irlandës**. Lumenjtë në këtë pellg janë të pasur me ujë dhe kanë rrjedhë të vazhdueshme për shkak të sasive të larta të reshjeve,



Zona e pellgjeve në Evropë

**Tabela 4:** Karakteristikat hidrologjike të lumenjve në zonat e pellgjeve të Evropës

Pellgu	Fluksi maksimal (sezoni)	Rrjedha minimale (sezoni)	Regjimi ujor (dieta)
Arktik	verë	dimër	dëborë-akull
Atlantik	njëtrajtshëm	njëtrajtshëm	reshje shiu
Mesdhetar	dimër	verë	reshje shiu
Kaspik	pranverë	dimër	dëborë- reshje shiu

të cilat bien gjatë vitit. Lumenjtë më të njohur të Gadishullit Pirinej që i përkasin kësaj zone pellgore janë: **Duero, Minjo, Tago, Guadiana, Guadalkivir** etj. Në të gjithë këta lumenj janë ndërtuar liqene artificiale dhe hidrocentrale. Lumenj të tjerë të mëdhenj që rrjedhin në këtë zonë ujëmbledhëse janë: **Sena, Loara** dhe **Garona**. Në Detin e Veriut derdhen: **Reni, Vezer, Laba, Tamizi** e të tjerë.

Këta lumenj kanë rëndësi të madhe trafikun për transportin e mallrave industrial dhe bujqësorë. Në Detin Baltik derdhen: **Odra, Visla, Njemen, Dvina Perëndimore** dhe **Neva**. Në dimër ata shpesh ngrinë, gjë që e bën trafikun më të vështirë. Shumica e lumenjve të pellgut të Atlantikut, kanë grykëderdhje të zgjeruara - **estaure**.


### PELLGU I OQEANIT TË NGRIRË TË VERIUT

Këtu bëjnë pjesë lumenjtë **Dvina Veriore** dhe **Peçora**. Në pjesën më të madhe të vitit, këta lumenj janë të ngrirë. Rrjedha maksimale ndodh në verë, kurse ajo minimale gjatë dimrit. Për shkak se të dy lumenjtë rrjedhin nëpër breza të gjerë pyjorë - **tajga**, ata përdoren si udhëkryq për të transportuar lëndë druri dhe materiale të tjera ndërtimi gjatë verës.


**PELLGU I LIQENIT KASPIK** Pellgu i Liqenit Kaspik është zona e vetme pellgore e mbyllur ku rrjedhin **Volga** dhe **Urali**, si dhe lumenj të tjerë më të vegjël. Lumenjtë në këtë pellg janë në mëdyshje me nivelin maksimal të ujit në pranverë, për shkak të rënies së borës. Volga është lumi më i gjatë dhe më i pasur me ujë në Evropë (3700 km). Ajo është e lidhur me lumenj të tjerë përmes **kanaleve**, që krijojnë një rrugë të gjatë të lundrueshme që lidh 4 dete. Volga ka forcë të madhe hidroenergjetike, kështu që shumë liqene artificiale dhe hidrocentrale janë ndërtuar mbi të. Në grykëderdhje, Volga formon një deltë të madhe.

Rëndësia ekonomike e lumenjve evropianë është e madhe. Ata përdoren si rrugë të lundrueshme, për ujitje dhe për të ndërtuar hidrocentrale. Lumenjtë më të mëdhenj janë të lidhur me **kanale të lundrueshëm**.

**Grafiku 2:** Regjimi vjetor i ujërave të lumenjve nga dy zona të ndryshme pellgore



**Derdhja e Savës në Danub**



Danubi është i vetmi lum i madh në Evropë, që rrjedh nga perëndimi në lindje. Ai buron nga mali Shvarcvald (me një lartësi prej 1078 metra mbi nivelin e detit) në Gjermani. Ai rrjedh në juglindje në një shtrirje prej 2859 km, që derdhet në Detin e Zi. Kalon nëpër shumë shtete të Evropës Qendrore dhe Lindore: Gjermani, Austri, Sllovaki, Hungari, Kroaci, Serbi, Bullgari, Rumania dhe Ukraina. Kalon nëpër disa kryeqytete: Vjenë, Bratislavë, Budapest dhe Beograd.



**Për njohuri të thelluara:**

- Falë lumenjve të lundrueshëm që janë të lidhur me kanale artificiale në të gjithë Evropën, është krijuar një rrugë ujore në brendësi, e cila është e rëndësishme për ekonominë e shumë vendeve. Kështu, nëpërmjet lumenjve Reni, kanalit Danub-Majna-Reni dhe rrjedhës së Danubit janë të lidhura Deti i Zi dhe Deti i Veriut.
- Lumi Reni ka rëndësi të madhe trafiku për Gjermaninë e industrializuar. Është i lundrueshëm nga grykëderdhja në qytetin e Bazelit në Zvicër. Kështu, Zvicra, si vend i Evropës Qendrore, ka qasje në det dhe mundësinë për t'u lidhur me botën në rrugë ujore.



**Për të kontrolluar njohuritë e fituara:**

- Me ndihmën e atlasit në hartën hidrografike të Evropës, përpiku të shkruash me laps emrat e lumenjve të shënuar përgjatë vijave të kaltra. - Detyra është e përshtatshme për të punuar në çifte!



**Detyra me aplikimin e TIK-ut:**

- Bëj vërtetim të largët përmes (Google Earth) të shtretërve të lumenjve, kanaleve të lumenjve dhe grykëderdhjeve të lumenjve kryesorë evropianë! Thekso disa veçori të përbashkëta sipas pikëpamjeve të tua, për një diskutim të mundshëm në grup në klasë!
- Bëj një udhëtim virtual (Google Map) përgjatë Danubit dhe bëj një listë të vendeve evropiane nëpër të cilat kalon!

# LIQENET NË EVROPE




## Diskutim interaktiv hyrës:

- Rikujtohu për ujërat që nuk rrjedhin në Tokë!
- Cilat liqene ekzistojnë sipas formimit të pellgut të tyre?
- Cila është domethënia ekonomike e liqeneve?

Kontinenti evropian është i pasur me shumë liqene. Sipas llojit, pra formimit të basenit të liqenit, ato janë: **liqene tektonike, akullnajore, karstike, lumore dhe artificiale.**

**LIQENET TEKTONIKE** Ato janë edhe liqene relikte, disa milionë vjecarë, baseni i te cilave u krijua nga lëvizjet tektonike. Më i madhi prej tyre në Evropë dhe në botë është Liqeni Kaspik me sipërfaqe prej 371,000 km<sup>2</sup>. Liqeni Kaspik është mbetje e detit të dikurshëm dhe kjo është arsyeja pse uji i tij është i kripur. Ky liqen ndodhet 28 metra nën nivelin e detit - **depression**. Liqeni më i madh tektonik në Evropën Qendrore është **Balaton** në Hungari (592 km<sup>2</sup>). Një numër i konsiderueshëm liqenesh tektonike ndodhen në pjesët qendrore të Gadishullit Ballkanik: **Liqeni i Ohrit, Prespës, Dojranit, Kosturit**, etj.




Liqeni i Dojranit

**Tabela 5:** Liqenet më të mëdha sipas sipërfaqes në Evropë

Liqeni	Kaspik	Ladoga	Onega	Venern	Vetern	Melarn
Sipërfaqja (km <sup>2</sup> )	371.000	18.400	9.720	5.545	1.886	1.163

**LIQENET AKULLNAJORE (GLACIALE)** Këto janë liqene më të reja, basenet e të cilave janë produkt i erozionit akullnajor në ultësirat dhe malet, të cilat gjatë epokës së akullit kanë qenë të mbuluara me akullnaja të trasha. Më shumë liqene akullnajore ka në: **Gadishullin Skandinav** dhe atë **Finlandez**. Ka mbi 60.000 liqene akullnajore. **Finlanda** (vendi i liqeneve) është veçanërisht e njohur për këto liqene.




Liqeni i Gjenevës



Liqeni i Gjenevës është më i madhi nga të gjitha liqenet alpine dhe bën gjysmëhënë të gjerë së bashku me lumin Rona që derdhet në të nga skaji juglindor, kurse del nga jugperëndimi. Edhe pse liqeni në pjesën më të gjerë është

14 km, erërat e forta mund të shkaktojnë stuhi të forta që janë më të natyrshme në dete dhe në brendësi të tokës. Bregdeti verior është i populluar dendur, kurse qytetet më të rëndësishëm janë: Gjenera dhe Lozana. Shpatet përgjatë bregut të liqenit, të kthyer nga jugu, janë zonat më të mëdha verore në Zvicër.

Liqenet më të mëdhenj akullnajorë në Evropën Veriore janë: **Ladoga, Onega, Venern, Melarn, Vetern** etj. Liqene akullnajore ka edhe në malet më të larta, si: Alpet, Dinaret, Rodopet, Karpitet etj. Liqenet më piktoreskë të akullnajave janë në Alpe. Më të njohurit në mesin e tyre janë: **Liqeni i Gjenevës, Bodenit, Cyrihut, Bledit, Bohinjit, Komos** dhe liqene të tjerë. Liqene akullnajorë më të vegjël në Gadishullin Ballkanik ka në malet: **Rila, Pirin, Sharr, Baba** dhe male të tjera.



Liqeni i Shkodrës



Liqeni i Shkodrës është liqeni më i madh në Shqipëri, Mal të Zi dhe në Gadishullin Ballkanik. Sipërfaqja e liqenit është 369.7 km<sup>2</sup> (nga të cilat 221.8 km<sup>2</sup> i përkasin Malit të Zi dhe 147.9 km<sup>2</sup> Shqipërisë). Gjatësia nga Vranina deri në Shkodër është 40 km, kurse gjerësia në disa vende është 14 km. Thellësia është nga 4 deri në 6 metra, ndërsa sa më shumë të shkohet në bregdetin perëndimor, aq më i thellë bëhet. Liqeni e ndryshon madhësinë e tij sipas stinëve, kurse merr ujë nga shumë lumenj. Lumi Buna buron dhe del nga liqeni dhe derdhet në Detin Adriatik.

**LIQENET KARSTIKE** Liqenet karstike janë të pranishëm në zonat gëlqerore dhe karstike. Shumica e tyre gjenden në vargmalin Dinarik në Ballkan. Më i madh është **Liqeni i Shkodrës** (370 km<sup>2</sup>) dhe **Liqeni Vrana**. Liqeni më i thellë në Evropë, **Liqeni i Kuq** në Kroaci, sipas formimit, u përket liqeneve karstike.


**LIQENET E LUMENJVE** Liqenet e lumenjve formohen nga ndarja natyrore e shtretërve të lumenjve nga rrëshqitjet e tokës ose nga depozitimi i barrierave gëlqerore në lumenj që rrjedhin nëpër zonat gëlqerore. Këto janë, për shembull, liqenet piktoreskë të **Plitvicës** dhe liqenet përgjatë lumit **Kërka** në Kroaci dhe **Pliva** në Bosnjë e Hercegovinë. Rreth lumenjve të rrafshët të mëdhenj që rrjedhin (Volga, Danubi, Dniepri, etj.) nga shtretërit e lumenjve, në afërsi janë krijuar liqene periodike ose të perhershme - **të vdekur**, të cilat humbasin kontaktin me rrjedhën e lumit. Lumenjtë që grumbullojnë mure ranore përpara hyrjes në dete, krijojnë liqene - **limane**. Ato gjenden kryesisht në derdhje të degëve të Detit të Zi dhe të Detit Azov.



Liqenet e Plitvicës



**LIQENET ARTIFICIALE** Ata janë ndërtuar për nevoja njerëzore. Ata gjenden në disa lumenj në Evropë, kurse liqenet më të mëdha janë vendosur në lumenjtë: **Volga**, Danub, Dniepër, Don etj. Uji nga liqenet artificialë përdoret për shumë qëllime, kryesisht për: ujitje, përfitim të energjisë elektrike, peshkim dhe qëllime turistike. Liqenet më të mëdhenj artificialë në Evropë janë ndërtuar mbi lumin Volga: **Liqeni Kujbishevë, Ribin** dhe **Volgograd**.



Matka - liqeni më i vjetër artificial në Maqedoninë e Veriut, akumulimi i të cilit ishte ndërtuar në vitin 1938. Është fituar duke e ndarë lumin Treska me digë dhe duke krijuar një akumulim artificial në kanionin e Matkës.



**Për njohuri të thelluara:**

- Ndër liqenet natyrore në Evropë ekziston një numër i vogël liqenesh të cilat janë me origjinë vullkanike dhe shtrihen në krater vullkanik. Të tilla ka në Francë dhe Itali - Liqeni Albano. Si mbetje të liqeneve të rrezikuara, ka shumë liqene moçalore (kënetore) në të gjithë kontinentin evropian.
- Liqeni më i madh artificial në Evropë (Liqeni Kujbishevë) zë një sipërfaqe prej një çerek territori të republikës sonë.
- Liqeni i Kuq (300 m), Liqeni i Ohrit (294) dhe Liqeni Kaspik (211) janë tri liqenet më të thella në Evropë.



**Për të kontrolluar njohuritë e fituara:**

- Cili vend është më i pasuri me liqene në Evropë?
- Cili është liqeni më i madh tektonik dhe akullnajor në Evropë?
- Lidhi liqenet nga e majta me llojin të cilit i përket në të djathtë:
 

a) Liqeni Balaton	akullnajor
b) Liqeni i Shkodrës	tektonik
c) Liqeni Ladoga	lumor
d) Liqenet e Plitvicës	karstik



**Detyra me aplikimin e TIK-ut:**

- Gjeji në (Google Earth ose Google Map) liqenet: Ladoga, Onega, Venern, Melarn, Vetern, Liqeni i Gjenezës, Boden, Liqeni i Cyrihut, Bled, Bohinj, Komo, Liqenin e Shkodrës dhe Liqenet e Plitvicës. - Gjej se në cilat shtete ato bëjnë pjesë dhe si përdoren ekonomikisht!
- Bëje një udhëtim virtual (Google Map) përgjatë lumenjve: Danub, Dniepër, Dravë dhe bëje një listë të liqeneve artificialë që i ke vërejtur!

*Konceptet kryesore:*

- *Popullsia;*
- *Dendësia e popullsisë;*
- *Shtimi natyror;*
- *Grupet racore;*
- *Popujt;*
- *Grupet gjuhësore;*
- *Përkatësia fetare;*
- *Zakonet;*
- *Tradita;*
- *Kultura;*
- *Rajoni;*
- *Shteti;*
- *Kryeqyteti;*
- *Republika;*
- *Mbretëria;*
- *Principata.*

Flamujt e vendeve evropiane.

# TEMA II: KARAKTERISTIKAT SOCIO-GJEOGRAFIKE DHE NDARJA RAJONALE E EVROPËS

KARAKTERISTIKAT THEMELORE TË POPULLSISË SË EVROPËS .....	36
PËRKATËSIA GJUHËSORE E FETARE DHE DIVERSITETI I POPULLSISË NË EVROPË .....	39
KULTURA, TRADITA DHE ZAKONET E POPULLSISË NË EVROPË.....	42
VENDBANIMET NË EVROPË.....	45
NDARJA RAJONALE DHE POLITIKE E EVROPËS .....	48

# KARAKTERISTIKAT THEMELORE TË POPULLSISË SË EVROPËS




## Diskutim interaktiv hyrës:

- Rikujtohu dhe përgjigju se nga çfarë varet numri i banorëve në një vend apo një shtet?
- Cilat raca janë përfaqësuar në "kontinentin e vjetër"?
- Nga kanë ardhur banorët e parë në historinë e Evropës?

Evropa, me një popullsi prej rreth 743 milionë, renditet e treta mes kontinenteve në botë, ose një e dhjeta e popullsisë në botë. Kontinenti i vjetër ka kaluar një histori të trazuar, ku: ndryshimet ekonomike, sociale dhe ushtarake-politike kanë shkaktuar ndryshime të shpeshta dhe drastike të popullsisë. Popujt e parë evropianë erdhën nga kontinenti i Azisë. Pas zbulimeve të mëdha gjeografike, Evropa shndërrohet në zonë të madhe emigrimi nga ku një popullsi prej miliona njerëzish lëviz drejt pushtimit dhe zgjedhjes së një „Bote të Re“.

**SHTIMI NATYROR** Evropa dhe bota e zhvilluar në përgjithësi, është një zonë demografike me shtim të ulët natyror, veçanërisht nga dekadat e fundit të shekullit XX-të e deri më sot. Shkalla e ulët e lindjeve (**natalitetit**) dhe shkalla e ulët e vdekjeve (**mortaliteti**) janë afër njëra-tjetrës dhe japin **shtim të ulët natyror** të popullsisë evropiane, e cila në dy dekadat e fundit lëviz nën një përmijë në vit (< 1 ‰). Disa vende evropiane madje kanë shtim natyror negativ, respektivisht popullsia e tyre bie në numër, si: Ukraina, Bullgaria, Hungaria e të tjera. Si faktorë kryesorë për këtë prirje demografike janë: kushtet ekonomike dhe shëndetësore, niveli arsimor dhe kulturor i popullsisë. Si pasojë paraqitet rritja e numrit të popullsisë së moshuar në krahasim me të rinjtë, por gjithashtu edhe mungesa e forcës së punës. Sipas rrjedhave demografike, në të ardhmen në Evropë mund të pritet zvogëlimi i popullsisë - **shpopullimi**.



**Grafiku 1:** Lëvizja e numrit të popullsisë në Evropë (.000)



**DENDËSIA E POPULLSISË** Sipas dendësisë së popullsisë, Evropa është kontinenti i dytë më i populluar me dendësi mesatare prej 74 banorë për km<sup>2</sup>. Popullsia e këtij kontinenti nuk shpërndahe në mënyrë të barabartë. Kjo varet, nga kushtet natyrore-gjeografike, si dhe nga kushtet socio-ekonomike. Zonat më të dendura të populluara në Evropë janë zonat industriale. Midis tyre, më të njohura janë zona e **Rurit dhe Sarës, Shlezia, Lugina e Renit** etj. Në këto zona ka qytete të mëdha që ndërlidhen me njëri-tjetrin. Zonat me dendësi më të madhe gjithashtu janë basenet e qymyrit në: **Britaninë e Madhe, Francë, Rusi, Belgjikë dhe Italinë Veriperëndimore**. Gjithashtu, luginat e lumenjve, ultësirat dhe luginat pjellore janë ndër zonat më të dendura të Evropës. Vendi më i dendur me popullsi është **Holanda me 395 banorë për 1 km<sup>2</sup>**. Në Evropë, zonat veriore janë më pak të populluara. Kushtet klimatike nuk janë të përshtatshme për të jetuar. Këto janë rajone polare dhe subpolare. Këtu popullsia është shumë e rrallë dhe lëviz rreth disa banorë për 1 km<sup>2</sup>. Dendësia e popullsisë gjithashtu varet nga **migrimet** e popullsisë të drejtuara nga pjesët jugore dhe lindore në pjesët më të zhvilluara ekonomikisht, qendrore dhe perëndimore të kontinentit.

**RACAT DHE POPUJT** Popullsia e Evropës është kryesisht e bardhë dhe në një masë më të vogël të verdhë. Popujt (etnitë) e racës së bardhë në Evropë u përkasin tri grupeve kryesore: **sllavët, gjermanët dhe romanët**.

**Grafiku 2:** Përfaqësimi në përqindje i grupeve etnike në Evropë



Harta e popujve të Evropës

**Sllavët** përfaqësojnë grupin më të madh të popujve në Evropë me 34% të popullsisë së përgjithshme. Ata jetojnë në Evropën Lindore, Qendrore dhe Jugore. Në grupin sllav të popujve përfshihen: **maqedonas, serbë, kroatë, sllovenë, malazezë, boshnjakë, rusë, bjellorusë, ukrainas, polakë, çekë, sllovenë, bullgarë dhe serbë të Luzhicës.**

Grupi **gjerman** i popujve me 31% është i dyti më i populluar në Evropë. Gjermanët jetojnë në Evropën Veriore dhe Qendrore, Ishujt Britanikë dhe në vende të tjera. Popujt gjermanë janë: **gjermanët, anglezët, suedezët, holandezët, norvegjezët, danezët dhe austriakët.**

Grupi i popujve **romanë** përfaqësohet me 25%. Këta popuj banojnë në pjesën më të madhe të Apenineve dhe Gadishullit Pirinej, si dhe në pjesë të tjera të Evropës Perëndimore dhe Lindore. Ky grup i popujve përfaqësohet nga : **francezët, spanjollët, italianët, portugezët dhe rumunët.** Përveç tre grupeve kryesore, si popuj të veçantë dallohen: **shqiptarët, grekët, baskët** etj.

Popujt e racës së verdhë në Evropë janë: **finlandezët, hungarezët, turqit, tatarët** etj.



#### **Për njohuri të thelluara:**

- Popujt e sotëm në Evropë u formuan si rezultat i përzierjes së gjatë etnogjenetike, shkrirjes dhe asimilimit midis fiseve antike dhe popujve në të kaluarën. Kështu, popujt e grupit roman i trashëguan dhe ende jetojnë në territoret e dikurshme të: Keltëve, Iberëve, Gotëve, Gaulëve, Etruskëve, Romakëve e të tjerë.
- Në Evropë ka grupe më të vogla etnike që nuk kanë arritur të formojnë shtetin e tyre dhe jetojnë të integruar në territoret shtetërore të një populli, respektivisht të një kombi tjetër. Të tillë janë: katalonët, baskët, vllahët, serbët e Luzhicës, romët e të tjerë. E ardhmja e Evropës si djep i civilizimit botëror nuk është në luftëra dhe përçarje, por në bashkimin e mozaikut të kombeve „të vogla“ dhe „të mëdha“ në një familje të vetme pa kufij dhe pa diskriminim.



#### **Për të kontrolluar njohuritë e fituara:**

- Si është shtimi natyror i popullsisë në Evropë?
- Cilat janë rajonet më të dendura të populluara në Evropë?
- Cilët popuj në Evropë i përkasin racës së verdhë?
- Lidhi termat nga e majta me kushtet përkatëse në të djathtë:

a) Norvegjezë	Popuj të veçantë
b) Spanjollë	Sllavë
c) Rusë	Gjermanë
d) Shqiptarë	Romanë



#### **Detyra me aplikimin e TIK-ut:**

- Bëje një tabelë në një program (Excel) duke e klasifikuar popullsinë evropiane në rreshta dhe kolona të veçanta sipas racës dhe përkatësisë etnike!
- Shiko në (Google Map) rajonet me dendësi më të madhe të Evropës dhe zbuloje se cilat qytete të njohura të mëdha, prej disa milionësh janë të vendosur atje!

# PËRKATËSIA GJUHËSORE E FETARE DHE DIVERSITETI I POPULLSISË NË EVROPË

## Diskutim interaktiv hyrës:

- Diskuto rreth kuptimit të gjuhës si e mirë shoqërore!
- Cilat dhe pse i quajmë disa gjuhë "botërore"?
- Ku, si dhe kur filluan religjionet e sotme botërore?
- Nga kanë ardhur banorët e parë të historisë evropiane?

Kontinenti i Evropës, si qendër e kulturës botërore, karakterizohet nga një larmi e madhe e gjuhëve, feve dhe vlerave të tjera kulturore. Diversiteti është rezultat i proceseve të gjata historike nga përzjerja e popujve, ekspeditave pushtuese, migrimëve, luftërave etj.

## PËKATËSIA GJUHËSORE

Mozaiku gjuhësor në Evropë përbëhet nga tri grupe: **indo-evropian**, **ural-altaik** dhe **i veçantë**.

**GRUPI INDO-EVROPIAN** Grupi i gjuhëve indo-evropiane është më i përhapuri në Evropë. Ai përfshin: grupin gjuhësor **sllavishten**, **gjermanishten**, **rumanishten**, **kelte**, **baltike** dhe **gjuhët speciale**.

**GJUHËT SLLAVE** ndahen në tri degë: **lindore** (rusisht, bjellorusisht, ukrainisht); **perëndimore** (çeke, sllovaqe, polake, serbe të Lluzhicës) dhe **jugore** (**maqedonisht**, **serbisht**, **bullgarisht**, **slovenisht**, **boshnjake**, **kroate** dhe **malazeze**).

**Dega gjermane** e gjuhëve përbëhet nga gjuhët: **angleze**, **gjermane**, **daneze**, **suedishte**, **holandishte**, **norvegjishte** dhe gjuhë të tjera.


**Dega e gjuhëve romane** përdoret në pjesët jugore të Evropës. Ato janë: **italishtja**, **frëngjishtja**, **spanjishtja**, **portugezja** dhe **rumunishtja**.

**Dega kelte** përbëhet nga gjuhët më të vjetra indo-evropiane të përdorura në Evropën Perëndimore, gjegjësisht: Gadishulli **Bretanja**, **Irlanda**, **Skocia**, **Uelsi** dhe ishulli **Man**.

Dega e **gjuhëve baltike** është afër gjuhëve sllave dhe përbëhet nga: **letonishtja** dhe **lituanishtja**.

**Gjuhë të veçanta** indo-evropiane në Evropë janë: gjuha **shqipe** dhe **greqishtja**.

**GRUPI URAL-ALTAIK** Këto gjuhë u sollën nga popujt që emigruan nga Azia në të kaluarën. Këto janë: **gjuhët turke** dhe **uro-finlandeze** (hungarisht, finlandisht, estonisht dhe laponisht).



	Gjermane		Kelte		Greke
	Romane		Baltike		Shqiptare
	Sllovene		Jo indo-evropiane		

Harta e gjuhëve në Evropë

**GJUHËT E VEÇANTA** Gjuhët e veçanta në Evropë, të cilat nuk i përkasin asnjë familjeje botërore, është gjuha **baske** që përdoret në veri të Spanjës dhe në jug-perëndim të Francës (Gjiri i Biskajit).


### PËTKATËSIA FETARE

Diversiteti fetar në Evropë përbëhet kryesisht nga: **krishterimi**, si fe me shumicën e besimtarëve, dhe **islami**, i cili është më pak i përfaqësuar.

**FEJA KRISHTERE** Ka numrin më të madh të besimtarëve në Evropë. Në vitin 1054 u nda në dy kisha: **Perëndimore - romake katolike** dhe **Lindore - kisha ortodokse**.


**Kisha katolike** me seli në Vatikan është më e përfaqësuar në **Itali, Francë, Spanjë, Portugali, Kroaci, Slloveni, Poloni, Republikën Çeke, Hungari** dhe në vende të tjera.

**Kisha ortodokse** ka më së shumti besimtarë në: **Rusi, Bjellorusi, Ukrainë, Rumani, Serbi, Bullgari, Greqi, Maqedoninë e Veriut** dhe në vendet e tjera.



Shpërndarja e feve në Evropë

Grafiku 3: Përkatësia fetare në Evropë



**Protestantizmi** është mësim fetar, që në shekullin XVI-të u nda nga Kisha Katolike Romake si fe e veçantë. Sot protestantët jetojnë në **Britani të Madhe, Gjermani, Suedi, Norvegji, Danimarkë** dhe vende të tjera.

**ISLAMI** Islami në Evropë u përhap në shekullin VIII-të. Sot është më e pranishme në Gadishullin Ballkanik dhe daton para dhe nga koha e Perandorisë Osmane. Ai është më i pranishëm në: **Shqipëri, Bosnjë e Hercegovinë, Kosovë, (Maqedoninë e Veriut, 33.3% (2002))** dhe pjesën evropiane të Turqisë.

Mozaiku fetar i kontinentit të vjetër në numër të vogël plotësohet nga anëtarët e feve të tjera: **judaizmi, budizmi** etj.



#### Xhamia e larme në Tetovë

Në bregun e djathtë të lumit Shkumbin në qytetin e Tetovës në shekullin XV-të u ndërtua

xhamia me tyrbe. Xhamia është e rëndësishme për pikturat e saj të brendshme dhe të jashtme. Ana jugore është veçanërisht piktoreske, e cila mund të shihet nga rruga kryesore që të çon në Gostivar. Në përbërjen e këtij ambienti, gjendet hamami i ruajtur, i cili sot është galeri arti, si dhe konakët që paraqesin një tërësi interesante urbane. Me punët e konservimit-restaurimit, pamja dhe bukuria e dikurshme i janë rikthyer.





#### **Për njohuri të thelluara:**

- Në Gadishullin Ballkanik në kohët e lashta, shumë popuj të zhdukur ose të asimiluar kanë përdorur gjuhë antike indo-evropiane të njohura në shkencë si gjuhët paleo-ballkanike. Të tilla ishin gjuhët e: ilirëve, maqedonasve antikë, trakasve, pajonëve, dakëve e të tjerë.
- Në kundërshtim me besimtarët (teistët), në shumë vende evropiane qytetarë të caktuar e deklarojnë veten si ateistë. Ata nuk e pranojnë ekzistencën e një hyjnie dhe nuk festojnë festa fetare. Një përqindje më e lartë e ateistëve në Evropë u deklaruan në: Francë, Estoni, Holandë, Republikën Çeke, Belgjikë dhe Gjermani.



#### **Për të kontrolluar njohuritë e fituara:**

- Cilat gjuhë i përkasin grupit të gjuhës gjermane?
- Cilat fe janë të përfaqësuar në Evropën Perëndimore dhe atë Veriore?
- Bazuar në analizën e hartës së besimeve fetare të Evropës, lidhi termat përkatës nga të dy palët:
 

a) Franca	myslimanë
b) Suedia	ortodoksë
c) Rumania	katolikë
d) Kosova	protestantë
- E vërtetë ose e gabuar? (Shëno përgjigjen e saktë me simbolin: ✓ ose ✗)
 

a) Gjuha ruse është në grupin e gjuhëve sllave	b) Italishtja është në grupin e gjuhëve gjermane
c) Hungarezët janë kryesisht katolikë	d) Portugezët janë kryesisht ortodoksë

Google



#### **Detyra me aplikimin e TIK-ut:**

- Kërko dhe zbulo se cilat gjuhë evropiane janë më të përhapura në kontinentet e tjera. - Cilat janë ato vende?
- Bëje një kërkim në internet, se në cilat vende jo-evropiane fetë janë më të pranura në Evropë?

# KULTURA, TRADITA DHE ZAKONET E POPULLSISË NË EVROPË



## Diskutim interaktiv hyrës:

- Rikujtohu dhe përgjigju se çfarë nënkuptoni me kulturë?
- Përshkruaj disa nga zakonet në mjedisin tuaj më të afërt!
- Çfarë vallëzimesh dhe vallesh njeh dhe di t'i luash?

Evropa është djepi i kulturës botërore. Përfitimet më të mëdha që i ka lënë Evropa në trashëgiminë botërore janë: **shkrimi latin** dhe **cirilik**, kryesisht **gjuhët botërore**, shfaqja e **filozofisë**, zhvillimi i **shkencës** dhe **artit** etj.

**KULTURA ANTIKE** Kontinenti evropian është djepi i shumë civilizimeve dhe kulturave antike. Ato datojnë shumë shekuj përpara erës së re. Midis tyre, dallohen kultura e **ilirëve**, **grekëve** dhe **romakëve** të lashtë.

**Kultura mikenase** është kultura e parë shumë e zhvilluar në tokën evropiane. Mbetjet e ndërtesave nga ajo kohë na tregojnë për këtë kulturë. Një nga ato ndërte-



Porta e Luanit në Mikenë



Renditja e alfabetit si trashëgimi kulturore më e vlefshme e Evropës

sa është **Porta e Luanit** në Akropolin mikenas. Artikuj të ndryshëm, si armë, bizhuteri ari dhe argjendi, vazo, pllaka me shkronja të lashta u gjetën nga ajo kulturë, në qytetet e vjetra. Nga ajo periudhë vijnë dy poemat epike të famshme, **Iliada** dhe **Odiseja**, të shkruara nga poeti **Homer**. Greqia e lashtë është vendi i parë në histori ku u shfaqën **veprat teatrale**. Këto janë **tragjeditë** dhe **komeditë**.

Legjenda:

- Latin
- Cirilik
- Cirilik dhe latin
- Alfabeti grek

**Kultura romake** u zhvillua nën ndikimin e kulturës antike greke. Ne e dimë arkitekturën, skulpturën dhe pikturën romake bazuar në mbetjet e tyre. Këto janë: **rrugë, ura, sisteme ujësjellës, banja ose terma publike, harqe triumfale** etj. Shumica e mbetjeve ruhen në Romë. Aty gjendet **Koloseumi** - cirku i madh që mund të mbajë 50.000 spektatorë. Në të u zhvilluan luftime gladiatorësh. Të gjitha vendet e tyre si rrugë, sheshe, ura, romakët i kanë zbukuruar me buste dhe skulptura. Në kohën Romake u hodhën themelet e të **drejtës** dhe **legjislacionit** të sotëm.



Koloseumi në Romë

**KULTURA E ERËS SË RE DHE MODERNE** Kapitull i veçantë në zhvillimin e mjedisit kulturor të Evropës është fillimi i erës së re, pas zbulimeve të mëdha gjeografike. Zbulimi i territoreve, popujve dhe kulturave të reja, zgjimi i shkencave dhe arteve, revolucioni industrial dhe rilindja kombëtare e popujve do të sjellin ndryshime të mëdha: sociale, ekonomike dhe kulturore në kontinentin e vjetër. Kështu, në themelet antike të Evropës, fitimet e reja do të bëhen në një sintezë të gjerë, të njohur gjerësisht si **kulturë perëndimore**, e cila do të pushtojë horizontet e reja në Tokë.

**Tabela 1:** Një pjesë e trashëgimisë botërore (kulturore) të Evropës

Shpikje	Shkencëtarë	Shkrimtarë	Filozofë	Kompozitorë	Artistë
makine me avull	Teslla	Aligieri	Sokrati	Mocarti	Da Vinçi
makinë	Nobël	Shekspiri	Platoni	Bahu	Mikelanxhelo
teleskop	Njuton	Dostojevski	Aristoteli	Handeli	Rembranti
kinema	Ajnshtajni	Pushkini	Ruso	Verdi	Dali
makinë	Lomonosovi	Tolstoi	Lajbnici	Betoveni	Pikaso
televizor	Mendeleevi	Hygo	Hegeli	Vagneri	Repin
dinamit	Galileo	Balzaku	Marks	Puçini	Velasquezi

**TRADITAT DHE ZAKONET** Evropa sot përballlet me sfida të mëdha kulturore. Nga njëra anë, ekziston **trashëgimi e madhe kulturore**, kurse nga ana tjetër, tendencat moderne që çojnë në pranimin e vlerave të reja. Tradita si “kujtesë kolektive” në kuptimin sociologjik ushqen vlerat e së kaluarës, të cilat ngadalë çojnë në përparimin e shoqërisë. Pranimi i vlerave moderne, globale, nga ana tjetër, mund të sjellë rrezikun e **humbjes së identitetit kulturor** të popujve. Zgjidhja ka të bëjë me kultivimin universal të vlerave morale dhe fetare që garantojnë dimensionin human të njeriut modern, kurse çrrenjosja e vlerave tradicionale që „vulosin” të kaluarën dhe çojnë në paragjykitje, shovinizëm, përçarje dhe diskriminim.

Sot në Evropë kultivohen shumë **tradita** dhe **zakone**. **Kremtimi** i shumë festave katolike, ortodokse, ose të besimit islam është tradicional. Traditë e rëndësishme midis popujve evropianë është organizimi i festivaleve



Pashkët në një kishë ortodokse



**Dasma e Galicnikut**

dhe garave të ndryshme në këndim, karnavale të ndryshme, ngjarje sportive etj. Popujt e Evropës kultivojnë zakone të ndryshme. Ata i referohen mënyrës së: kremtimit të festave, organizimit të dasmave, lindjes së fëmijëve, ceremonive të varrimit etj. Edhe pse ka dallime në zakonet, disa prej tyre janë karakteristike për shumë popuj. Për shembull, zakoni i besimtarëve ortodoksë që ngjyrosin vezë gjatë festës së Pashkëve dhe vizitojnë tempuj, manastire dhe katedrale nga të krishterët në të gjithë Evropën. Zakoni gjatë festës së besimtarëve islam të

Bajramit, kur familjet më të pasura ndihmojnë më të varfrit, ka një dimension të veçantë njerëzor. Ekzistojnë zakone të ndryshme në kombet evropiane kur martohen, të tilla si: martesë, shkëmbimi i unazave të fejesës, ceremonia e martesës etj. Krenaria e popujve në të gjithë Evropën është gjithashtu ruajtja e: këngëve tradicionale, valleve dhe lojërave popullore, kostumet, zanatet e të ngjashme.



**Për njohuri të thelluara:**

- Shumica e zakoneve në Evropë i kanë rrënjët në kohërat e lashta. Disa simbolizojnë një ngjarje, kurse disa bazohen në paragjykimet pa ndonjë shpjegim logjik ose shkencor të veçantë. Për shembull, maturantët në Norvegji veshin rroba shumëngjyrëshe. Në Spanjë, para Pashkëve organizohen procesione ndëshkuese për të falur gabimet. Të Premten e Madhe në Angli është zakoni të konsumoni pasta me rrush. Në të njëjtën festë në Itali është zakoni të organizohen procesione që heshtin gjatë ceremonisë. Gjatë Pashkëve në Poloni, zakoni i lotimit të besimtarëve është i njohur.
- Disa valle dhe lojëra tradicionale në Evropë janë ngritur në nivelin e një simboli dhe marke tregtare të kulturës së vendit pritës. Të tilla janë për shembull: Vallja e rëndë në vendin tonë, vallja e Uzhicës në Serbi, vallja Çardash në Hungari, Polka në Republikën Çeke, valsi i Vjenës etj. Disa prej tyre janë nën mbrojtjen e UNESCO-s!



**Për të kontrolluar njohuritë e fituara:**

- Nga cila periudhë dhe popull rrjedhin alfabetet e sotme në Evropë?
- Cilat kultura kanë dhënë themel të fortë për pasurinë kulturore të Evropës së sotme?
- Si është tradita e festimit të festave të mëdha fetare në Evropë si: Pashkët dhe Bajrami?



**Detyra me aplikimin e TIK-ut:**

- Kërko dhe bëj album me fotografi të veshjeve popullore të disa kombeve evropiane! Analizoi ndryshimet!
- Përcilli video-materialet nga vallet dhe lojërat popullore të disa popujve jashtë Ballkanit! A ka ngjashmëri dhe dallime me ato të zonës sonë?

# VENDBANIMET NË EVROPË



## Diskutim interaktiv hyrës:

- Rikujtohu dhe renditi disa karakteristika themelore të vendbanimeve!
- Cilat janë ndryshimet themelore midis qytetit dhe fshatit?
- A njeh qytete të vjetra, antike evropiane?

Vendbanimet janë vende specifike të rregulluara në hapësirën gjeografike në mënyrë që të ketë rrjedhë të qetë të aktiviteteve të jetës njerëzore, të cilat në thelb përkufizohen në: strehim, punë dhe rekreacion. Sipas llojit, vendbanimet ndahen në **urbane** dhe  **rurale**.

**VENBANIMET URBANE** Qytetet janë vendbanime më të mëdha me popullsi jo bujqësore, e cila aktivizohet kryesisht në: **industri, trafik, tregti, shëndetësi, arsim, kulturë** dhe aktivitete të tjera. Qytetet ndryshojnë nga fshatrat për nga madhësia, numri i popullsisë, mënyra e jetesës, pamja etj.


**ZHVILLIMI HISTORIK** Qytetet më të vjetra në Evropë datojnë që nga lashtësia. Ato përjetuan prosperitet të madh dhe madhështi imponuese arkitektonike në kohërat antike. Më të vjetër janë disa qytete të Evropës Jugore: **Athina, Teba, Delfi, Pllovdivi, Lisbona, Roma, Zara** etj. Në mesjetë, gjatë epokës feudale, u ndërtuan qytete më të vogla - kështjella, por me revolucionin industrial në kohën e re dhe marrëdhëniet e vendosura kapitaliste, ndodhi procesi i urbanizimit të përsheptuar, kur u shfaqën qytete të modernizuara industriale në Evropë.

**QYTETET SIPAS MADHËSISË** Madhësia e një qyteti varet nga popullsia. Në shumë vende të Evropës, numri i banorëve për të marrë statusin e qytetit është i ndryshëm. Kjo është arsyeja pse është pranuar një zgjidhje kompromisi, e cila respektohet në shumë vende. Sipas tij, **qytetet e vogla** janë ato me më pak se 10 mijë banorë. Këto qytete janë qendrat drejt të cilave gravitojnë fshatrat përreth. **Qytetet e mesme** kanë nga 10 deri në 100 mijë banorë. Ato janë qendra të zonave më të mëdha dhe ndikojnë në mjedisin e tyre më të gjerë. **Qytetet e mëdha** janë ato me mbi 100 mijë banorë dhe ato mbulojnë një zonë shumë të madhe. Qytetet e vogla gjithashtu gravitojnë drejt tyre. Qytetet me mbi një milionë banorë janë **qytete me miliona banorë**. **Roma** ishte qyteti i parë me miliona banorë në Evropë në antikitet. Në Evropë sot ka më shumë qytete me miliona banorë. Më të madha prej tyre janë: **Moska** në Rusi dhe **Londra** në Britaninë e Madhe. Për sa i përket madhësisë, qytete me miliona banorë janë: **Shën Petersburgu** në Rusi,

**Tabela 2:** Qytetet më të mëdha në Evropë

Qyteti	Popullsia	Shteti
Moska	11.980.000	Rusia
Londra	8.310.000	Britania e Madhe
Shën Petersburgu	5.130.000	Rusia
Berlini	3.520.000	Gjermania
Madridi	3.205.000	Spanja
Athina	3.070.000	Greqia
Kievi	2.848.000	Ukraina
Roma	2.778.000	Italia
Parisi	2.203.000	Franca
Minsku	1.920.000	Bjellorusia

**Grafiku 4:** Qytetet më të mëdha në Evropë



**Berlini** në Gjermani, **Madridi** në Spanjë, **Roma** në Itali, **Kievi** në Ukrainë, **Parisi** në Francë e të tjerë, duke mos llogaritur **Stambollin**, i cili i përket dy kontinenteve. Shumica e qyteteve me miliona banorë në Evropë janë të vendosura në **Rusi, Gjermani** dhe **Ukrainë**.



Parisi



Parisi është kryeqyteti i Francës, por gjithashtu përfaqëson: qendrën administrative, politike, ekonomike, kulturore dhe arsimore-shkencore të këtij vendi. Qyteti shtrihet në brigjet e lumit Sena në veri të Francës, në rajonin Il-de-France. rajon i Parisit. Me një numër vjetor prej mbi 45 milionë turistë, Parisi është qyteti më i vizituar në botë.



■ rajone turistike



■ rajoneve industriale

**Rajone urbane turistike dhe industriale më të dendura në Evropë.**

**FIZIONIMIA DHE FUNKSIONI** Fizionomia ose pamja e qytetit diktohet nga: relievi, koha e ndërtimit dhe qasja urbano-malore. Kështu, në Evropë ka qytete ose mbetjet e tyre nga epoka të ndryshme që mund të kategorizohen sipas fizionomisë si: **mesdhetarë**, me rrugë të ngushta, të shtruara dhe shtëpi prej guri (Malaga, Murcia, Budva); **të fortifikuar mesjetarë**, me mure dhe kështjella të larta (San Marino, Dubrovniku, Talini, Jorku); **turke-orientale**, me ndërtesa të ulëta, veranda, rrugë të ngushta dhe bezisten (çarshitë në Sarajevë, Shkup, Manastir) dhe gjithsesi, **qytete moderne** me zgjidhje komplekse infrastrukture. Qytetet zakonisht konsiderohen vendbanime multifunkionale, por disa prej tyre mund të mbizotërojnë nga një ose dy aktivitete, sipas të cilave do të marrin funksionin: **industrial** (Maçesteri, Torino), **turistik** (Venediku, Kana), **tregtar** (Hamburgu, Marseji), **transporti** (Frankfurti, Roterdami), **administrativ** (Brukseli, Gjeneva) etj.

**VENDBANIMET RURALE** Fshatrat, ndryshe nga qytetet, janë vendbanime më të vogla ku njerëzit janë të angazhuar kryesisht në aktivitete bujqësore. Sipas pozicionit të tyre, ekzistojnë: **fshatra malorë, kodrinorë, fshorë dhe bregdetarë.**


**Fshatrat malorë** janë vendbanime të vogla me ndërtesa kompakte. Fshatrat kodrinorë përbëhen nga disa lagje që janë larg njëra-tjetrës. Ata merren me blegtori dhe pylltari. Disa nga fshatrat malorë të Alpeve në shekullin e kaluar janë shndërruar në qendra turistike: **Shamoni, Obersdorf, Davos, Aros, Kicbil** etj.

**Fshatrat rrafshinorë** janë më të mëdhenj dhe mund të kenë infrastrukturë të ndryshme (rrugë, sisteme ujësjellësi), dhe shtëpitë janë ndërtuar në disa kate.

Sipas fizionomisë, ekzistojnë fshatra të tipit **të dendur** dhe **të rrallë**. Ata kryejnë një funksion

bujqësor-blegtoral për nevojat e qyteteve. Në **Ultësirën e Evropës Lindore, Perëndimore, Panoni, Lombardi dhe Villahi** në Evropë, ka fshatra të mëdhenj me mbi 10 mijë banorë. Ata janë të urbanizuar dhe duken si qytete të vogla. Në Angli dhe Holandë nuk mund të flitet më për fshatra në kuptimin e vërtetë, për shkak të harmonisë së tyre fizionomike dhe funksionale me qytetet.

**Fshatrat bregdetarë** kryejnë funksionin e **peshkimit** (Gadishulli Skandinav) dhe **turizmit** (Greqi, Portugali, Kroaci, Itali). Në pjesët më veriore të Evropës ka fshatra shtëpitë e të cilëve janë ndërtuar nga **akulli**. Këto shtëpi quhen **iglo**. Në jug të tyre ka fshatra që janë ndërtuar kryesisht nga druri. Këta fshatra janë



Fshat malor

të vendosur në zonën e tajgave të rajoneve veriore të: Rusisë, Norvegjisë, Suedisë, Finlandës etj. Në zonat kodrinore dhe malore të pazhvilluara të Evropës Jugore dhe Lindore, edhe pse në zhdukje, hasen ende gjurmë të tipit të fshatrave **turko-orientalë**. Ndërtesat janë prej tullave argjilore, ballkonet janë prej druri dhe furnizohen me ujë nga pusi ose shatërvani publik.

**Për njohuri të thelluara:**

- Konurbacioni është procesi i zgjerimit hapësinor dhe bashkimi i dy ose më shumë qyteteve fqinje në një aglomerat të gjerë urban të quajtur megalopolis. Megalopoliset janë krijuar në rajonet e zhvilluara industriale të Anglisë deri në Italinë Veriperëndimore dhe në bregdetin e zhvilluar turistik Azur të Detit Mesdhe.
- Qytetet e përjetuan ngritjen e tyre të parë shkëlqyese në kohën romake. Disa nga qytetet kishin cilësi urbane të lakmueshme për kushtet e sotme (shatërvanët e qytetit, rrugët e shtrura, banjat publike, tavernat, teatrot), rregulli i ligjit, ekonomia e zhvilluar, etj. Më vonë, qytetet mesjetare, në frymën e kohës, përfaqësojnë një anë të prapambetur dhe të errët të historisë njerëzore. Pas fortesave markante ishin: sëmundjet infektive, higjiena e dobët, uria, shkatërrimi i mjedisit, paganizmi, izolimi ekonomik, etj.

**Për të kontrolluar njohuritë e fituara:**

- Cilët janë qytetet më të mëdha në Evropë?
- Ku ishin ndërtuar dhe cilat ishin qytetet më të vjetra në Evropë?
- Ku janë fshatrat më të urbanizuar?
- Cila mund të jetë rëndësia e fshatit për ekonominë lokale ose shtetërore?

Google

**Detyra me aplikimin e TIK-ut:**

- Bëj një poster ose album (Power Point) me fotografi të llojeve të ndryshme të lagjeve urbane dhe rurale, të njohura në Evropë. Prezanto dhe nënvizo disa veçori për secilin lloj individual!
- Bëj kërkim në Google dhe zbulo se cilat metropole evropiane kanë instaluar për herë të parë hekurudhën nëntokësore – metronë në transportin publik!

# NDARJA RAJONALE DHE POLITIKE E EVROPËS



## Diskutim interaktiv hyrës:

- Çfarë kupton nën konceptin rajon?
- Pse shtetet thuhet se janë krijime politike?
- Si mund të jetë sistemi shtetëror?



Ndarja rajonale e Evropës

- Evropa Lindore
- Evropa Veriore
- Evropa Perëndimore
- Evropa Jugore
- Evropa Qendrore

Sipas ndarjes rajonale Evropa është e ndarë në këto rajone gjeografike: **Evropa Jugore, Perëndimore, Veriore, Qendrore dhe Lindore.**

**EVROPA JUGORE** kryesisht është rajon malor. Ajo përfshin rajonin evropian të Detit Mesdhe me tre gadishuj të mëdhenj: **Gadishullin Apenin, Ballkanik dhe Pirinej**, si dhe ishujt dhe grupet arkipelagje. Hapësirën e saj kryesisht e përfshijnë malet e vjetra të mëdha dhe vargmalet e reja. Nga aspekti klimatik, Evropa Jugore është nën ndikim të Mesdheut. Në Evropën Jugore me numër më të madh janë popujt e grupeve **romane** dhe **sllave**.

**Gadishulli Ballkanik** në pikëpamje politike-territoriale është i ndarë në shumë shtete: **Serbia** me kryeqytet Beogradi, **Mali i Zi** (Podgorica), **Bullgaria** (Sofja), **Shqipëria** (Tirana), **Greqia** (Athina), **Maqedonia e Veriut** (Shkupi), **Slovenia** (Lubjana), **Bosnja e Hercegovina** (Sarajeva), **Kroacia** (Zagrebi) dhe **Kosova** (Prishtina).

Në **Gadishullin Apenin** gjenden: **Italia** me kryeqytetin e saj Roma, **Vatikani** (Vatikani) dhe **San Marino** (San Marino).

Në **Gadishullin Pirinej** gjenden: **Spanja** me kryeqytet Madridi, **Portugali** (Lisbona) dhe **Andorra** (Andorra la Vela).

Sipas rregullimit shtetëror, vendet e këtij rajoni kryesisht janë **republika**, përveç Vatikanit (**monarki zgjedhore**), Andorës (**principatë**), Spanjës (**monarki**) dhe Bosnjës dhe Hercegovinës – **republikë federale**.

**EVROPA PERËNDIMORE** përfshin pjesën perëndimore të kontinentit, e hapur gjerë kah Oqeani Atlantik dhe detet e tij bregdetare. Relievi është përfaqësuar me ultësira dhe male të vjetra të mëdha. Klima është atlantike me reshje të mëdha shiu. Evropa Perëndimore është një nga rajonet më të dendura të populluara të kontinentit. Në këtë rajon me numër më të madh janë popujt e **grupeve gjermane** dhe **romane**. Shtetet e këtij rajoni janë vende bujqësore dhe industriale shumë të zhvilluara. Këto janë: **Franca** me kryeqytetin Paris, **Monako** (Monako), **Britania e Madhe** (Londra), **Irlanda** (Dublini), **Belgjika** (Brukseli), **Holanda** (Amsterdami) dhe **Luksemburgu** (Luksemburgu). Sipas rregullimit shtetëror, vendet e rajonit janë **monarki kushtetuese**, përveç Monakos **principatë**.



**EVROPA VERIORE** është rajon që përfshin pjesën më veriore të këtij kontinenti: Gadishullin Skandinav, Kola, Kanin, Jiland (Jutland), ishujt e Arktikut dhe të Islandës. Relievi i këtij rajoni është kryesisht me male dhe ultësira. Karakteristikë e këtij rajoni janë fjordet dhe fushat, si dhe liqenet e shumtë akullnajorë. Në këtë rajon kushtet klimatike janë më të pafavorshme, veçanërisht në zonat ku mbizotëron klima subpolare. Popullsia që banon në Evropën Veriore i takon kryesisht grupit gjerman të popujve që, sa i përket ekonomisë dhe nivelit kulturor janë ndër popujt më të zhvilluar dhe më të përparuar në Evropë. Në këtë rajon gjenden shtetet: **Norvegjia** me kryeqytetin e saj Oslo, Suedia (Stokholmi), **Finlanda** (Helsinki), **Danimarka** (Kopenhaga) dhe **Islanda** (Reikjavik). Sipas rendit shtetëror, vendet në rajon janë: monarki kushtetuese dhe republika (Islanda, Irlanda, Finlanda).

**EVROPA QENDRORE** si rajon përfshin zonën e Evropës Qendrore, midis Alpeve dhe Karpateve, duke përfshirë: zonat e Alpeve, Danubin dhe Baltikun. Relievi në të është i ndryshëm. Ai përbëhet nga vargmale të vjetra dhe të reja malore, si dhe ultësira të mëdha dhe pjellore. Klima është kontinentale dhe e butë-kontinentale. Lumenjtë që rrjedhin përmes këtij rajoni janë veçanërisht të rëndësishëm për përdorimin e tyre ekonomik (për trafik, ujitje, hidrocentrale, etj.). Ky rajon është i banuar nga banorë të grupeve të ndryshme të popujve, më i shumti prej tyre janë sllavët dhe gjermanët. Rajoni politiko-territorial është i ndarë në shtetet: **Gjermania** me kryeqytetin Berlini, **Polonia** (Varshava), **Republika Çeke** (Praga), **Slovacia** (Bratislava), **Zvicra** (Berna), **Austria** (Vjena), **Lihtenshtajni** (Vaduz), **Hungaria** (Budapesti) dhe **Rumania** (Bukureshti). Sipas rregullimit shtetëror, vendet e rajonit janë: republika, republika federale (Gjermania, Austria, Zvicra) dhe Lihtenshtajni si një monarki.

**EVROPA LINDORE** përfshin zonën e Ultësirës së Evropës Lindore dhe shtrihet në lindje në malin Ural, lumin Ural dhe Detin Kaspik. Evropa Lindore ka klimë kryesisht kontinentale. Lumenjtë që rrjedhin përmes këtij rajoni janë: të gjatë, të ngadaltë, të rrjedhshëm dhe të lundrueshëm. Uji i tyre përdoret për ujitje dhe për të fituar energji elektrike. Popullsia që banon në këtë rajon i përket grupit **sllav** të popujve. Harta politiko-territoriale përbëhet nga vendet: **Rusia** me kryeqytet Moskë, **Bjellorusia** (Minsku), **Ukraina** (Kievi), **Estonia** (Talini), **Letonia** (Riga), **Lituania** (Vilniusi) dhe **Moldavia** (Kishinau). Të gjitha kanë rregullim **republikan**, përveç Rusisë - **republikë federale**.



**Për njohuri të thelluara:**

- Në krye të monarkive kushtetuese - mbretërive në Evropë, ka mbret. Autoriteti i mbretit është i kufizuar nga kushtetuta. Disa monarki drejtohen nga princi - principatë. Në shtetet republikane nuk ka fuqi trashëgimore, përkatësisht zgjidhen dega ekzekutive dhe kreu i shtetit.



**Për të kontrolluar njohuritë e fituara:**

- Ku shtrihet rajoni perëndimor i Evropës?
- Cilat vende gjenden në rajonin verior?
- Cilat janë rregullimet shtetërore të vendeve në rajonin jugor?
- Lidhi vendet me rajonet në të cilat ato bëjnë pjesë:

- |              |                    |
|--------------|--------------------|
| a) Zvicra    | Evropa Jugore      |
| b) Holanda   | Evropa Veriore     |
| c) Serbia    | Evropa Lindore     |
| d) Danimarka | Evropa Perëndimore |
| e) Ukraina   | Evropa Qendrore    |



**Detyra me aplikimin e TIK-ut:**

- Me ndihmën e disa paketave softuerike (Microsoft Excel) bëje një tabelë me të dhëna për përkatësinë rajonale dhe organizimin shtetëror të vendeve evropiane!

*Konceptet kryesore:*

- *Vija bregdetare;*
- *Gadishujt;*
- *Ishujt;*
- *Grupet ishullore;*
- *Kurora malore;*
- *Myshqet;*
- *Kufijtë shtetërorë;*
- *Rregullimi shtetëror;*
- *Rodopet;*
- *Musalla;*
- *Republika;*
- *Liqeni i Shkodrës;*
- *Religjioni*

**Peizazh nga Deti Mesdhe**



# TEMA III: VEÇORITË GJEOGRAFIKE TË EVROPËS JUGORE

VEÇORITË GJEOGRAFIKE TË EVROPËS JUGORE.....	52
GADISHULLI BALLKANIK .....	54
BULLGARIA.....	54
GREQIA .....	57
SERBIA.....	59
SHQIPËRIA DHE KOSOVA .....	61
KROACIA DHE SLLOVENIA .....	64
MALI I ZI DHE BOSNJA E HERCEGOVINA .....	68
GADISHULLI APENIN.....	71
ITALIA, SAN MARINO DHE VATIKANI.....	71
GADISHULLI PIRINEJ .....	74
SPANJA, PORTUGALIA DHE ANDORA .....	74
DEGRADIMI, NDOTJA DHE MBROJTJA E MJEDISIT TË EVROPËS JUGORE .....	78

# VEÇORITË GJEOGRAFIKE TË EVROPËS JUGORE



## Diskutim interaktiv hyrës:

- Rikujtohu dhe përgjigju cilët gadishuj ndodhen në bregdetin jugor të Evropës?
- Cilat janë kulturat antike të Evropës?
- Ku shtrihen Dinaret?



**Tabela 1:**

Shtetet dhe kryeqytetet e gadishujve të Evropës Jugore

Gadishulli Ballkanik	Kryeqyteti
1. Shqipëria	Tirana
2. Bullgaria	Sofja
3. Bosnja e Hercegovina	Sarajeva
4. Greqia	Athina
5. Maqedonia e Veriut	Shkupi
6. Serbia	Beogradi
7. Sllovenia	Lubjana
8. Kroacia	Zagrebi
9. Mali i Zi	Podgorica
10. Kosova	Prishtina
Gadishulli Apenin	Kryeqyteti
1. Italia	Roma
2. Vatikani	Vatikani
3. San Marino	San Marino
Gadishulli Pirenej	Kryeqyteti
1. Spanja	Madridi
2. Portugalia	Lisbona
3. Andora	Andora la Vela

**POZITA GJEOGRAFIKE.** Evropa Jugore i përfshin **Gadishullin Apenin, Ballkanik** dhe **Pirinej**. Këta gadishuj kanë depërtuar thellë në ujërat e Detit Mesdhe dhe u afruan me Azinë dhe Afrikën. Nga Azia janë larg më pak se 3 km në ngushticat: **Bosfor** dhe **Dardanele**, kurse nga Afrika, 14 km te **Ngushtica e Gjibraltarit**. Për shkak të kësaj, Evropa Jugore ka pozitë gjeografike shumë të volitshme. Ajo paraqet “urë” që lidh rajonet e Evropës me vendet e Azisë dhe Afrikës. Pozita e volitshme gjeografike është për shkak të shumicës së deteve, të cilat e rrethojnë këtë rajon nga tri anë. Më i rëndësishëm prej tyre është **Deti Mesdhe** me detet e tij bregdetare. **Oqeani Atlantik** ka një rëndësi të madhe për pozitën gjeografike të Evropës Jugore. Ai e lidh këtë rajon përmes rrugëve ujore me oqeanet dhe kontinentet e tjera.

**PËRTHYERJA BREGDETARE** Përthyerja bregdetare e rajonit të Evropës Jugore, përveç tre gadishujve të mëdhenj, përbëhet edhe nga gadishuj të tjerë më të vegjël, ishujt dhe gjiret e Detit Mesdhe. Për shkak të copëzimit të madh, ky rajon ka një **vijë bregdetare** shumë të gjatë. Në grupin e gadishujve më të vegjël përfshihen: **Peloponezi, Istria, Kalabria** etj. Ishujt më të mëdhenj në rajon janë: **Sicilia, Sardenja, Korsika, Kreta** etj.

**RELIEVI** Relievi në Evropën Jugore përbëhet kryesisht nga malet dhe ultësirat. Më të përhapurit janë vargmalet: **Apeninet, Pirinejet** dhe **Dinaret**. Nga ultësirat më të mëdha janë: **Andaluzia, Aragoni, Lombardia** dhe një pjesë e **Ultësirës së Panonisë**. **Malet vullkanike** me disa vullkane aktive gjithashtu janë të pranishme në relievin malor të rajonit.

**KLIMA DHE HIDROGRAFIA** Klima në Evropën Jugore është **mesdhetare**, me vera të nxehta dhe të thata dhe dimra të butë dhe të lagësht. Në vendet më të larta klima varion nga mesatarja-kontinentale në atë malore. Lumenjtë janë të shkurtër dhe të shpejtë, kurse nga liqenet më shpesh hasen ato: tektonike, karstike dhe akullnajore.

**BOTA BIMORE** Bota e bimëve në Evropën Jugore përfaqësohet kryesisht nga shkurre mesdhetare të gjelbra dhe specie druri, të cilat janë të qëndrueshme ndaj thatësisë dhe temperaturave të larta, të njohura me emrin e përbashkët - **makie**.

**POPULLSIA DHE EKONOMIA** Popullsia në Evropën Jugore i përket: grupeve etnike **sllave, romane** dhe **të veçanta (autoktone)**. Përkatësia fetare është kryesisht: **katolike, ortodokse** dhe **islame**. Aktivitetet më të zhvilluara ekonomike në rajon janë: **bujqësia, industria** dhe **turizmi**.

**NDARJA POLITIKE-TERRITORIALE** Rajoni i Evropës Jugore përfshin 17 shtete. Ato zënë 13% të sipërfaqes së Evropës dhe 22% të popullsisë së këtij kontinenti. Dhjetë nga shtetet janë të vendosura në Gadishullin Ballkanik, kurse nga tre shtete ka në: Gadishullin Apenin dhe Pirinej. Në Detin Mesdhe gjendet shteti ishullor i Maltës me kryeqytetin **La Valeta**.



**Për njohuri të thelluara:**

- Shtetet e para në Evropë u shfaqën në rajonin jugor që para erës së re. Shumica e tyre u rritën: Iliria, Greqia, Maqedonia dhe Roma. Popujt e tyre i kishin borxh njerëzimit: shkencë, art dhe ndërtim.
- Popullsia në rajonin e Evropës Jugore përballet me probleme të shumta demografike (emigracion), sociale (hendek të thellë midis të pasurve dhe të varfërve), ekonomike (papunësia dhe standardi i ulët) dhe me probleme mjedisore.
- Qëllimi strategjik i popujve të Evropës Jugore është që të bashkohen në një shoqëri pa kufij ku duhet të respektohen veçoritë individuale kulturore të popujve, duke kapërcyer dhe lënë në të kaluarën konfliktet e shumta ushtarake ndëretnike dhe ndëretare.



**Për të kontrolluar njohuritë e fituara:**

- Si janë karakteristikat relievo të Evropës Jugore?
- Si është klima në Evropën Jugore?
- Cilët popuj dhe religjione janë të përfaqësuara në vendet e rajonit jugor të Evropës?
- Lidhi shtetet me kryeqytetet e tyre:

a) Sllovenia	Roma
b) Portugalia	Podgorica
c) Mali i Zi	Lubjana
d) Italia	Lisbona



**Detyra me aplikimin e TIK-ut:**

- Bëj vëzhgim në distancë (Google Earth) dhe kërko për përmbajtje të botuara për vullkanet dhe fushat më të mëdha karstike në Evropën Jugore! Përshkruaji përshtypjet e klasës!
- Kërko dhe zbulo cilat janë tre kryeqytetet më të mëdha në Evropën Jugore?

# GADISHULLI BALLKANIK



## BULLGARIA

<b>Emri</b>	Bullgaria
<b>Kryeqyteti</b>	Sofja
<b>Sipërfaqja (km<sup>2</sup>)</b>	110.910
<b>Numri i banorëve</b>	7.177.000
<b>Rregullimi</b>	republikë
<b>Gjuha zyrtare</b>	bullgarishtja



### Diskutim interaktiv hyrës:

- Monumentet dhe vlerat kombëtare: Zllatni Pesoci, Rila, Pirin, Pllodiv... - Cilat janë paranjohuritë e tua?

**VEÇORITË NATYRORE** Bullgaria përfshin pjesën lindore të Gadishullit Ballkanik. Kufizohet me Rumaninë në veri, Greqinë dhe Turqinë në jug, dhe Serbinë dhe Republikën e Maqedonisë së Veriut në perëndim. Në lindje, ka dalje në Detin e Zi. Brenda këtyre kufijve, Bullgaria zë një sipërfaqe prej 110.910 km<sup>2</sup> dhe në atë hapësirë jetojnë mbi 7 milionë banorë.

Bullgaria ka **pozitë të volitshme gjeografike**, sepse ka dalje në Detin e Zi, kurse prej atje lidhet me shtetet e tjera të botës. Pozitën e volitshme të Bullgarisë e bën lumi Danub, i cili si lumë i lun-drueshëm e lidh atë me të gjitha vendet e Danubit. Rrugë të konsiderueshme tokësore kalojnë

nëpër Bullgari, duke e lidhur atë me Evropën Perëndimore dhe Veriore dhe vendet e Lindjes së Mesme. Përthyerja bregdetare e Detit të Zi nuk është e madhe.

Në Bullgari pjesa më e madhe e relievit është **malor**. Në të hasen malet e reja dhe të vjetra të mëdha. Malet e reja kalojnë nëpër pjesën qendrore të Bullgarisë - **Ballkan** dhe ngrihen në brigjet e Detit të Zi. Masivet e vjetra malore, nga ana tjetër, mbushin hapësirën në Bullgarinë Jugperëndimore. Këto janë **Rodopet**. Në perëndim të Rodopeve ngrihen malet e larta **Pirin** dhe **Rila** me majën **Musalla** (2925 m). Toka e ultësirës në Bullgari përfaqësohet nga dy ultësira: **Rrafshina e Danubit të Poshtëm**, në veri të Maleve të Ballkanit dhe **Ultësira e Trakisë**, në pellgun e lumit Maricë.

Llojet klimatike të pranishme në Bullgari janë: **klima bregdetare, e butë-kontinentale** dhe **malore**. Klima bregdetare përfshinë bregdetin e Detit të Zi.

Klima kontinentale e butë mbulon pjesën më të madhe të Bullgarisë, kurse klima malore, malet e larta. Lumenjtë nga Bullgaria i përkasin dy pellgjeve ujëmbledhëse. Më i madh është pellgu ujëmbledhës i Detit të Zi në të cilin të gjitha ujërat nga Bullgaria drejtohen nga lumi **Danub**. Lumenjtë **Struma, Mesta** dhe **Marica** derdhen në pellgun ujëmbledhës të Detit Egje.



Musalla



Musalla është maja më e lartë në Gadishullin Ballkanik. Ndodhet në malin Rila, afër qendrës dimërore Borovec dhe 80 km larg Sofjes. Sipas disa shkrimeve, emri i saj rrjedh nga "Mus Allah", ose "vendi i lutjes", "kulmi i lutjes". Temperatura mesatare vjetore është -2,9 °C, minimumi absolut -31,2 °C, kurse maksimumi absolut 18,7 °C. Maja Musalla është e mbuluar me dëborë mesatarisht 254 ditë në vit. Mbizotërojnë erërat veriperëndimore. Rreth 200 m më ulët është "Liqeni i Akullit" në lartësi mbidetare prej 2.709 m.




Nesebar




Nesebar është qytet në Detin e Zi, qendra administrative e komunës së Nesebarit. Është një nga qytetet më të vjetra në Evropë. Është qytet port me 22.311 banorë, me turizëm detar të zhvilluar dhe një numër të madh hotelesh. Qyteti është i lidhur drejtpërdrejt me qendrën e dytë më të madhe turistike në Detin e Zi – Soçev Breg. Nesebari është nën mbrojtjen e UNESCO-s me rritetet e tij kulturore, historike dhe natyrore. Qyteti antik ndodhet në një gadishull. Sot, vetëm një pjesë e vogël e qytetit është e vendosur në gadishull.

Në ekonomi më shumë marrin pjesë: **shërbimet, industria dhe bujqësia**. Qendrat kryesore industriale janë: **Plovdiv, Stara Zagora, Pleven** etj. Nga kulturat bujqësore më shumë kultivohen: **duhani, pambuku, rrushi, gruri, orizi** etj. Bullgaria gjithashtu është kultivues i njohur i **trëndafilave** nga të cilët bëhet vaj special. Industria në këtë vend është në zhvillim. Turizmi në këtë vend po bëhet një industri gjithnjë më e rëndësishme. Zona turistike në Bullgari është bregdeti i Detit të Zi, kurse qendër e rëndësishme turistike është qyteti **Varna**. Qendra të rëndësishme turistike për dimër dhe qendra malore janë **Bansko** dhe **Borovec**. Në tregtinë e jashtme, Bullgaria eksporton produkte bujqësore, veçanërisht perime të hershme dhe importon mallra industriale.



Sofja

**Grafiku 1:** Përfaqësimi i aktiviteteve ekonomike në Bullgari në përqindje



■ Aktivitetet e shërbimit  
■ Industria  
■ Bujqësia

### NDARJA RAJONALE

Sipas karakteristikave natyrore, demografike dhe ekonomike, Bullgaria mund të ndahet në 5 rajone edhe atë: i Danubit, Ballkanit, Lugina e Sofjes me pellgun e Maricës, Bregdeti i Detit të Zi dhe Rodopet. Në mënyrë administrative, vendi është i ndarë në 28 provinca, respektivisht qarqe.

#### Për njohuri të thelluara:

- Rila është mali më i lartë në Bullgari dhe në Ballkan me majën Musalla (2925). Pasuria e: pyllit, kafshëve të egra, burimeve dhe liqeneve akullnajore ishin arsyeja për ta shpallur malin park kombëtar. Kushtet e ambientit dhe numri i madh i ditëve me dëborë në Rila, mundësojnë zhvillimin turizmit dimror dhe llojeve të tjera të turizmit.
- Vlerat e njohura dhe tërheqëse për vizitë në Bullgari:

Objekte natyrore	Vende turistike	Monumente kulturore-historike	Qytetet
Deti i Zi	Albena	Manastiri Rila	Sofja
Rila	Sozopol	Manastiri Rozhenski	Varna
Pirin	Nesebar	Kalaja Asen	Burgasi
Rodopet	Bansko	Bansko	Stara Zagora

#### Për të kontrolluar njohuritë e fituara:

- Cilat janë karakteristikat klimatike të Bullgarisë?
- Cilët lumenj të Bullgarisë i përkasin pellgut të Egjeut?
- Cilat aktivitete ekonomike zhvillohen në Bullgari?

#### Detyra me aplikimin e TIK-ut:

- Kërko dhe mëso më shumë rreth rëndësisë turistike në: Rila, Pirin dhe Malet Rodope në Bullgari!
- Ndiqe vijën bregdetare të Detit të Zi në Bullgari (Google Map) dhe bëje një listë të destinacioneve kryesore turistike verore!





# GREQIA



## Diskutim interaktiv hyrës:

- Monumentet dhe vlerat kombëtare: Olimp, Athinë, Spartë, Tebë, Kretë... - Cilat janë paranjohuritë e tua?



**VEÇORITË NATYRORE** Greqia përfshin pjesën më jugore të Gadishullit Ballkanik. Është vend **ishullor** dhe **gadishullor**. Kufizohet me Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe Bullgarinë në veri, Turqinë në lindje dhe Shqipërinë në perëndim. Nga perëndimi, Greqia ka dalje në ujërat e Detit Jon, nga jugu në ujërat e Detit Mesdhe dhe nga lindja, ujërat e Detit Egje.

Greqia ka **pozitë të volitshme gjeografike**, pasi kufizohet nga tri anë me dete që e lidhin atë me vendet e tjera bregdetare.

**Vija bregdetare** e Greqisë është ndër më të gjatat në Evropë, me mbi 13.000 km vijë bregdetare dhe mbi 1400 ishuj. Ka shumë: **gadishuj, gjire, kanale**, si dhe grupe të ishujve - **arkipelagë**. Nga gadishujt më të njohur janë: **Halkidiki, Atika** dhe **Peloponezi**, i cili u shndërrua në një ishull nga **Kanali i Korinthit**. Nga gjiret më të njohur janë: gjiri i **Selanikut, Korinthit, Orfanit** e të tjerë. Nga ishujt më të njohur janë: **Kreta, Korfuzi, Eubea (ose Evia), Tasos** e të tjerë, kurse nga grupet e ishujve - **Kiklada** dhe **Sporade**. Këto grupe ishujsh gjenden në Detin Egje. Sipas karakteristikave natyrore, Greqia është vend ballkanik, gadishullor, bregdetar dhe ishullor.

**Relievi** në Greqi është kryesisht malor. Kurora kryesore malore përbëhet nga **Gramosi** dhe **Pindi** në Greqinë Veriore, pastaj **Parnasi** në Greqinë qendrore dhe **Tajgat** në Peloponez. Mali më i lartë në Greqi është **Olimpi** (2917m). Malet në Greqi janë të varfra me pyje, kurse vetëm disa prej tyre kanë kullota malore. E tillë është zona e **Epirit** në Greqinë Perëndimore. Ultësirat mbulojnë 20% të relievit të Greqisë. Ato janë me sipërfaqe të vogla dhe ndodhen në Greqinë gadishullore. Ultësirat janë të vendosura në Greqinë Veriore, ato janë: ultësira e **Selanikut** dhe ultësira e **Serezit**. Nëpër këto ultësira janë rrjedhat e poshtme të lumenjve **Vardar, Strumë** dhe **Bistricë**. Përveç tyre, në jug të Olimpiti është edhe **Thesalia**, ajo është një nga ultësirat më pjellore në Greqi.

Hapësira më e madhe e territorit të Greqisë ka **klimë mesdhetare**, në male – klimë **malore**, kurse në Greqinë Veriore, **klimë të ndryshueshme mesdhetare**. Lumenjtë më të njohur që rrjedhin nëpër Greqi janë: **Vardari, Struma, Marica, Mesta, Bistrica** etj.

## POPULLSIA DHE EKONOMIA

Shumica e popullsisë në këtë vend janë **grekë** (95%), të cilët identifikohen si të krishterë ortodoksë.

<b>Emri</b>	Greqia
<b>Kryeqyteti</b>	Athina
<b>Sipërfaqja (km<sup>2</sup>)</b>	131.957
<b>Numri i banorëve</b>	10.950.000
<b>Rregullimi</b>	republikë
<b>Gjuha zyrtare</b>	greqishtja



Plazhi Kukunaris në ishullin Skiatos


Ekonomia mbështetet në: **turizëm, peshkim, tregti** dhe **bujqësi**. Nga kulturat bujqësore në ultësira kryesisht rritet gruri dhe elbi, kurse nga ato industriale: pambuku, luledielli, duhani etj. Në Greqinë ishullore rriten shumica e frutave jugorë (ullinj, limonë, portokaj, mandarina, fiq, rrush, etj.). Industria është në zhvillim. Industritë më të zhvilluara janë industria e ushqimit dhe e lëkurës.

Turizmi është industri shumë e rëndësishme në Greqi. Klima e ngrohtë dhe plazhet e gjata me rërë tërheqin shumë turistë nga Evropa Qendrore dhe Veriore. Në tregtinë e jashtme, Greqia eksporton fruta jugorë, kurse importon: makineri, xehe, naftë etj.

### NDARJA RAJONALE

Sipas ndarjes rajonale Greqia ndahet në: **Greqia Veriore, Greqia Qendrore, Peloponezi** dhe **Greqia Ishullore**.

**Grafiku 2:** Përfaqësimi i aktiviteteve ekonomike në Greqi në përqindje



Athina

### Për njohuri të thelluara:

- Kanali i Korinthit (6.3 km) afër qytetit të Korinthit u hap në vitin 1893 për komunikim më të shpejtë midis detit Egje dhe Jon. Kështu, gadishulli i Peloponezit është prerë si ishull nga pjesa tjetër e Greqisë.
- Santorini është ishull i vogël (73 km<sup>2</sup>) në Detin Egje si mbetje e një vullkani të madh që ishte aktiv në epokën e vjetër.
- Vlerat e njohura dhe tërheqëse për vizitë në Greqi:



Objekte natyrore	Vende turistike	Monumente kulturore-historike	Qytetet
Olimpi	Kavalla	Delfi	Athina
Halkidiki	Kalitea	Partenoni	Selanku
Peloponezi	Hanioti	Akropolisi	Patra
Kreta	Leptokaria	Meteori	Volos
Tempi	Parga	Mikena	Larisa



### Për të kontrolluar njohuritë e fituara:

- Cila është rëndësia e Detit Mesdhe për Greqinë?
- Cilët lumenj grekë derdhen në Detin Egje?
- Cilat kultura kultivohen në Greqi?



### Detyra me aplikimin e TIK-ut:

- Kërko në softuer dhe zbulo cilët janë pesë ishujt më të mëdhenj në Greqi?
- Ndiqe vijën bregdetare të gadishullit Halkidiki në Greqi (Google Map) dhe bëje një listë të destinacioneve kryesore turistike verore!



# SERBIA



## Diskutim interaktiv hyrës:

- Monumentet dhe vlerat kombëtare: Zllatibori, Kalemegdani, Beogradi, Shumadia... - Cilat janë paranjohuritë e tua?



**VEÇORITË NATYRORE** Serbia përfshin pjesën qendrore të Gadishullit Ballkanik. Kufizohet në veri me: Hungarinë, në lindje me: Rumaninë dhe Bullgarinë, në jug me: Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe me Republikën e Kosovës, në perëndim me: Republikën e Kroacisë, Republikën e Bosnjës Hercegovinës dhe me Malin e Zi. Brenda këtyre kufijve ajo zë një sipërfaqe prej 77.474 km<sup>2</sup>. Serbia nuk ka dalje në det. Sidoqoftë, ajo ka pozitë të volitshme gjeografike. **Lugina e Moravës** kalon nëpër territorin e saj, që lidhet në jug me **Luginën e Vardarit**, kurse në lindje me **Luginën e Nishavës -Maricës**. Komunikime të rëndësishme rrugore dhe hekurudhore me rëndësi ndërkombëtare zhvillohen përgjatë këtyre luginave. Lumi Danub, nga ana tjetër, e lidh Serbinë me të gjitha vendet e Danubit, si rrugë e lundrueshme.

**Relievi** në Serbi është i llojlojshëm. Ai përbëhet nga katër tërësi natyrore: **male, ultësira, rrafshnalt, lugina dhe fusha**. Në pjesën perëndimore të Serbisë shtrihen vargmalet e reja nga rajoni malor Dinarik, mes tyre më të njohura janë: **Zllatibori, Koritniku** etj. Në pjesën qendrore dhe jugperëndimore të Serbisë shtrihen malet e viseve malore të Rodopeve. Këto janë masive malore të vjetra që nuk kanë një drejtim specifik të shtrirjes. Më të njohur prej tyre janë: **Kopaoniku, Çemeri, Besna Kobila** etj. Në pjesën lindore ka male nga rajoni Karpat-Balkanik. Këto janë male të lidhur mes vete, të pasura me kullota, pyje dhe xehe. Më të njohur mes tyre janë: **Stara Pllanina, Miroç, Deli Jovan** etj. Ultësira më e njohur në Serbi është **Ultësira e Panonisë**. Ajo shtrihet në veri të lumenjve Danub dhe Sava dhe është hambar i Serbisë. Nga rrafshnaltat më të njohura janë: **Peshter** dhe **Stari Vllah**, kurse nga luginat, e **Nishit** dhe e **Leskovcit**.

**Klima** në Serbi është kryesisht e butë-kontinentale. Përveç kësaj, ekzistojnë edhe lloje të tjera klimatike. **Lumenjtë** në Serbi u përkasin dy pellgjeve detare: pellgut të **Detit të Zi** dhe **Detit Egje**. Më i madhi prej tyre është pellgu i Detit të Zi. Të gjitha ujërat në të barten nga lumi Danub. Ky lumë rrjedh nëpër Serbi në një gjatësi prej 588 km dhe është lumi më i rëndësishëm për trafikun lumor, për ujitje dhe hidrocentrale. Në Grykën e Gjerdapit, fuqia e lumit Danub përdoret për të prodhuar energji elektrike. Në Serbi, Lumit Danub i bashkohen degët e tij: **Sava, Tisa, Tamishi, Morava e Madhe, Timoku** etj.

**POPULLSIA DHE EKONOMIA** Përveç serbëve, në përbërjen etnike të Serbisë marrin pjesë: hungarezët, rumunët, malazezët, bullgarët, kroatët, rusët, shqiptarët, maqedonasit e të tjerë.

<b>Emri</b>	Serbia
<b>Kryeqyteti</b>	Beogradi
<b>Sipërfaqja (km<sup>2</sup>)</b>	77.474
<b>Numri i banorëve</b>	7.200.000
<b>Rregullimi</b>	republikë
<b>Gjuha zyrtare</b>	serbishtja



Zllatibori

Nga burimet e energjisë Serbia ka: **qymyr guri, qymyr kafe, linjit, hidrocentrale** dhe burime më të vogla të **naftës**. Nga mineralet ka **bakër** (Bor dhe Majdanpek) etj. Serbia është vend bujqësor. Bujqësia është më e zhvilluar në Ultësirën e Panonisë, Luginën e Moravës dhe në Shumadi. Nga drithërat kultivohen kryesisht: **gruri** dhe **misri**, kurse nga kulturat bujqësore industriale: **luledielli, panxharsheqeri, panxhari i vajit, liri, pambuku** etj. Industria në Serbi vazhdon të zhvillohet. Nga degët industriale, **industria ushqimore** në Vojvodinë është më e zhvilluar (Zrenjanin, Suboticë, Kikindë, etj.). **Industria e makinerive** zhvillohet në: Nish, Krushevc, Smederevska Palankë, Beograd, Zemun dhe Novi Sad. **Industria e automobila-ve** është zhvilluar në Kragujevc dhe Priboj në lumin Lim, kurse **industria e tekstitit**: në Leskovc, Vranjë etj. Qendrat e **industriisë petrokimike** janë: Novi Sadi dhe Paņeva, kurse të **industriisë kimike**: Shabac, Bor etj.




Beogradi

Turizmi është degë e rëndësishme e ekonomisë serbe. Më i zhvilluar është turizmi malor në: **Zlatibor** dhe **Kopaonik** dhe turizmi i banjave: **Banja** e **Nishit, Vërnicit, Vranjës** etj.

**NDARJA RAJONALE** Serbia ndahet në 6 rajone: **Vojvodina, Rajoni i Beogradit, Serbia Perëndimore, Shumadia, Serbia Jugore** dhe **Serbia Lindore**.

**Grafiku 3:** Përfaqësimi i aktiviteteve ekonomike në Serbi



**Për njohuri të thelluara:**

- Liqeni i Vllasinës është njëri prej rezervuarëve artificialë më të bukur në Serbi. Ndodhet në 1280 metra mbi nivelin e detit, i rrethuar nga livadhe lulesh, pyje pishe dhe bredhi. Në ujërat e liqenit ka një fenomen të rrallë natyror në botë - ishujt që notojnë. Ata janë ishuj torfe të formuar nga toka dhe bimë nënujore, mbi të cilat kanë mbirë bimë. Gjatë erës ishujt e ndryshojnë pozicionin. Ato mbrohen me ligj si "monument natyror".

Objekte natyrore	Vende turistike	Monumente kulturore-historike	Qytetet
Kopaoniku	Zlatibori	Rasi i vjetër	Beogradi
Kanioni Uvac	Banja e Vranjës	Golubci	Novi Sadi
Varoshi i Djallit	Soko Banja	Përmendorja Avala	Nishi
Gryka e Gjerdapit	Prolom Banja	Lepenski Vir	Sombori
Tara	Vlasina	Petrovaradin	Kraguevci



**Për të kontrolluar njohuritë e fituara:**

- Pse Serbia ka pozitë të volitshme gjeografike, edhe pse nuk ka dalje në det?
- Cilat degë më të mëdha i pranon lumi Danub në Serbi?
- Renditi tërësitë relievoe në Serbi.



**Detyra me aplikimin e TIK-ut:**


- Kërko dhe zbulo me ndihmën e teknologjisë kompjuterike, cilat janë qendrat rajonale qytetare dhe në të cilat vendbanime serbe jeton popullsia maqedonase?

# SHQIPËRIA DHE KOSOVA



## SHQIPËRIA

Emri	Shqipëria
Kryeqyteti	Tirana
Sipërfaqja (km <sup>2</sup> )	28.748
Numri i banorëve	3.000.000
Rregullimi	republikë
Gjuha zyrtare	shqipja



### Diskutim interaktiv hyrës:

- Monumentet dhe vlerat kombëtare: Durrësi, Shkodra, Skënderbeu, Prishtina... – Cilat janë njohuritë tuaja të mëparshme?

**VEÇORITË NATYRORE** Shqipëria ndodhet në pjesën perëndimore të Gadishullit Ballkanik. Kufiri tokësor i këtij vendi është me: Malin e Zi, Kosovën, Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe Greqinë. Në perëndim ka dalje në Detin Adriatik. Brenda këtyre kufijve, Shqipëria zë një sipërfaqe prej 28.748 km<sup>2</sup>.

**Relievi** në Shqipëri është kryesisht malor. Në këtë pikëpamje, Shqipëria mund të ndahet në dy pjesë, përkatësisht: **pjesa bregdetare** në perëndim, kryesisht pjesa e ulët dhe me moçale dhe **pjesa malore** e lartë, në lindje. Malet në Shqipëri u përkasin grupeve malore Dinarike dhe të Sharrit. Më të njohura prej tyre janë malet: **Bjeshkët e Nemuna, Pashtriku, Korabi, Deshati, Jablanica** etj.


**Klima** në Shqipëri është mesdhetare në pjesën bregdetare dhe në zonën malore ndjehet klima e butë-kontinentale dhe ajo malore.

**Lumenjtë** derdhen në Detin Adriatik. Më të njohur prej tyre janë: **Drini, Buna, Vjosa, Shkumbini** dhe **Semani**.



Tirana

**Grafiku 4:** Struktura fetare e popullsisë



**POPULLSIA DHE EKONOMIA** Popullsia në këtë vend përbëhet nga shqiptarët (95%) të cilët janë popull i veçantë indo-evropian me: përkatësi fetare islame, ortodokse dhe katolike. Në Shqipëri jetojnë edhe grekë, si dhe maqedonas në zonën e Prespës së Vogël dhe Gollo Bërdë. Kryeqyteti i vendit është Tirana. Nga burimet minerale, Shqipëria ka depozita të: mineralit të kromit, boksitit, bakrit, mineralit të hekurit dhe naftë.

**Bujqësia** është aktiviteti kryesor ekonomik në Shqipëri. Më tepër kultivohen: drithëra, ullinj, portokaj, rrush dhe duhan. Industria vazhdon të zhvillohet, ndërsa nga degët industriale më të zhvilluara janë e: tekstilit, ushqimeve dhe e drurit. Në dekadën e fundit progres më të madh ka bërë turizmi.

**NDARJA RAJONALE** Në aspektin rajonal vendi është i ndarë në dy rajone: ultësira bregdetare dhe lugjina-malore. Administrativisht është e ndarë në 12 rrethe.



## KOSOVA

<b>Emri</b>	Kosova
<b>Kryeqyteti</b>	Prishtina
<b>Sipërfaqja (km<sup>2</sup>)</b>	10.908
<b>Numri i banorëve</b>	1.733.872
<b>Rregullimi</b>	republikë
<b>Gjuha zyrtare</b>	shqipja/serbishtja



**VEÇORITË NATYRORE** Kosova është shteti më i ri i krijuar në Gadishullin Ballkanik në vitin 2008. Kufizohet me Republikën e Serbisë në veri dhe në lindje, Malin e Zi dhe Shqipërinë në perëndim, dhe me Republikën e Maqedonisë së Veriut në jug. Brenda këtyre kufijve, Kosova zë një sipërfaqe prej 10.908 km<sup>2</sup> dhe në atë hapësirë sot jetojnë mbi 1,7 milionë banorë. Kryeqyteti i vendit është **Prishtina**.

**Relievi** në Kosovë përbëhet nga **toka malore** dhe **e rrafshët**. Toka e rrafshët ndodhet në pjesën lindore dhe perëndimore të republikës. Këto janë **Fushë Kosova** në lindje dhe **Rrafshi i**

Prizreni është qytet në shpatet veriore të Malit Sharr, afër kufirit me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Është qendra e komunës me të njëjtin emër dhe rrethi i Prizrenit. Në kohën bizantine, Prizreni ka qenë vend i rëndësishëm rajonal dhe në atë kohë u ndërtuan kështjellat në të: Dërvengrad dhe Vishegrad, i njohur si Qyteti i Epërm i Prizrenit. Në të ishte selia e Peshkopatës Bizantine. Emri i vjetër i Prizrenit para erës sonë ka qenë Prizdrina apo Therranda.




Prizreni

**Dukagjinit** në perëndim. Kosova është e rrethuar nga një numër i madh malesh. Më të njohura prej tyre janë: **Kopaoniku** në pjesën veri-lindore të saj, **Mali Sharr** dhe **Mali i Zi i Shkupit** në jug, kurse **Bjeshkët e Nemuna** dhe **Pashtriku** në perëndim.

**Lumenjtë** në Kosovë u përkasin tre pellgjeve detare: pellgut të Detit Egje, Detit Adriatik dhe Detit të Zi. Lumi **Lepec** i përket pellgut të Detit Egje, lumi Drini i Bardhë pellgut të Detit Adriatik, kurse pellgut të Detit të Zi, lumenjtë **Ibër** dhe **Morava e Binaçës**.

**POPULLSIA DHE EKONOMIA** Pjesa më e madhe e popullsisë së Kosovës janë shqiptarë (92 %), pastaj serbë (6%) e të tjerë (2%). Kosova është vend kryesisht bujqësor. Nga kulturat bujqësore më tepër kultivohen: drithëra, kultura kopshtare, rrushi, etj. Nga pasuria minerale e Kosovës ka më shumë **miniera qymyri** (e pesta në botë sa i përket rezervave të lignitit), pastaj xehet **e plumbit** dhe **zinkut** e të tjera. Industritë më të përfaqësuara në Kosovë janë: metalike, e drurit, tekstilit e të tjera.

**Grafiku 5:** Rezervat më të mëdha të qymyrit-lignitit në botë (në miliarda tonë)



**NDARJA RAJONALE** Në aspektin rajonal, Kosova është e ndarë në dy rajone, **Fushë Kosova** dhe **Rrafshi i Dukagjinit**, ndërsa në aspektin administrativ, vendi është i ndarë në 7 rrethe me gjithsej 38 komuna.



**Për njohuri të thelluara:**

- Kanioni i lumit Mirusha në Kosovë është monument unik natyror. Gjerësia është 3 deri në 6 metra, kurse lartësia e anëve të luginës deri në 200 metra. Atraktiviteti konsiston në: ujëvara, ujërat e shpejtë dhe pellgjet që janë rregulluar në shkallë. Kanioni ka një potencial të madh turistik.
- Vlerat e njohura dhe tërheqëse për vizitë në Shqipëri dhe Kosovë:

Objekte natyrore	Vende turistike	Monumente kulturore-historike	Qytetet
Liçeni i Shkodrës (Shqipëri)	Durrës (Shqipëri)	Krujë (Shqipëri)	Tiranë (Shqipëri)
Gryka e Drinit (Shqipëri)	Vlorë (Shqipëri)	Gjirokastër (Shqipëri)	Butrint (Shqipëri)
Kanioni i Rugovës (Kosovë)	Sarandë (Shqipëri)	Berat (Shqipëri)	Elbasan (Shqipëri)
Mali Sharr (Kosovë)	Brezovicë (Kosovë)	Deçan (Kosovë)	Prizren (Kosovë)
Kanioni Mirusha (Kosovë)	Prizren (Kosovë)	Qyteti i vjetër i Prizrenit	Prishtinë (Kosovë)



**Për të kontrolluar njohuritë e fituara:**

- Cila është rëndësia e Detit Adriatik për Shqipërinë?
- Cilët lumenj rrjedhin përmes Shqipërisë dhe Kosovës?
- Cilat aktivitete ekonomike zhvillohen në Shqipëri dhe Kosovë?



**Detyra me aplikimin e TIK-ut:**

- Kërko në softuer dhe zbuloi cilat janë qytete bregdetare në Shqipëri dhe cilat janë parqet kombëtare në Kosovë?
- Hulumto lidhjen ekonomike midis Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut!

# KROACIA DHE SLLOVENIA



## KROACIA

Emri	Kroacia
Kryeqyteti	Zagrebi
Sipërfaqja (km <sup>2</sup> )	56.578
Numri i banorëve	4.200.000
Rregullimi	republikë
Gjuha zyrtare	kroatishtja



### Diskutim interaktiv hyrës:

- Monumentet dhe vlerat kombëtare: Trigllavi, Postojna, Brioni, Dubrovniku...  
- Cilat janë paranjohuritë e tua?

**VEÇORITË NATYRORE** Kroacia shtrihet në formën e një harku të madh midis: Hungarisë, Sllovenisë, Bosnjë e Hercegovinës dhe Serbisë.

Në jugperëndim, Kroacia ka dalje në **Detin Adriatik**. Brenda këtyre kufijve ajo zë një sipërfaqe prej 56.578 km<sup>2</sup>. Republika e Kroacisë është: vend ballkanik, mesdhetar dhe vend i Evropës Jugore. Pozita gjeografike e Kroacisë është e volitshme. Dalja e saj në Detin Adriatik i mundëson të lidhet me botën në rrugë ujore. Gjatësia e bregdetit të Adriatikut në Kroaci është mbi 700 km. Përthyerja bregdetare e Detit Adriatik në këtë vend është e ndarë në shumë: ishuj, gadishuj, gjire, kanale etj. Më të njohur nga gadishujt janë **Istra** dhe **Peleshac**, kurse nga gjiret **Gjiri i Kumerit**, ku shtrihen ishujt: **Kërk**, **Cres** etj. Në jug të tyre, ishujt më të mëdhenj kroat janë: **Braç**, **Hvar**, **Korçula**, **Mljet**, **Vis** etj.

**Relievi** në Kroaci është i ndarë në ultësira, në gjysmën veriore ku shtrihen hapësira të **Ultësirës së Panonisë** me zonat **Sllavonia** dhe **Baranja** dhe malet në pjesën jugperëndimore dhe bregdetare. Këto janë: **Kapella e Madhe dhe e Vogël**, **Velebiti**, **Dinara** etj.

**Klima** në bregdet është mesdhetare. Në male është malore, kurse në Ultësirën e Panonisë është e mesme kontinentale.



Dubrovniku

Tabela 2:

Parqet kombëtare në Kroaci

PARQET KOMBËTARE	
Brioni	Paklenica
Kornati	Liqenet e Plitvicës
Kërka	Risnjaku
Mleti	



**Lumenjtë** në Kroaci u përkasin dy pellgjeve detare. Këto janë, pellgu e Detit të Zi dhe e Adriatikut. Lumenjtë **Danubi, Sava, Drava** e të tjerë i përkasin pellgut të Detit të Zi. Lumenjtë: **Cetina, Kërka** e të tjerët i përkasin pellgut të Adriatikut.

**POPULLSIA DHE EKONOMIA** Kroacia është e banuar nga më shumë se 4 milionë banorë. Popullsinë e përbëjnë kroatët (90 %), serbët (5%), sllovenët, italianët e të tjerë. Shumica e popullsisë në Kroaci është katolike.

**Ekonomia** e Kroacisë varet shumë nga **tregtia** (38%), **turizmi** (22%) dhe **industria** (20%). Vendet më të vizituara turistike janë: Dubrovniku, Spliti, Zara, Poreçi, Opatia, Pulla, Liqenet e Plitvicës, ishujt Hvar, Cres, Kërk, etj. Degët më të zhvilluara të industrisë janë: industria e tekstilit, ushqimore, petrokimia dhe ndërtimi i anijeve. Bujqësia përbën 7% të ekonomisë kroate. Kulturat bujqësore më të kultivuara janë: drithërat dhe hardhitë e rrushit.

**NDARJA RAJONALE** Në aspektin rajonal vendi është i ndarë në tre rajone: **bregdetar**, **malor** dhe i **ultësirave**. Vendi është i ndarë administrativisht në 20 njësi territoriale - qarqe.



Ujëvarat e Kërkës



Zara



## SLLOVENIA

<b>Emri</b>	Sllovenia
<b>Kryeqyteti</b>	Lubjana
<b>Sipërfaqja (km<sup>2</sup>)</b>	20.273
<b>Numri i banorëve</b>	2.070.000
<b>Rregullimi</b>	republikë
<b>Gjuha zyrtare</b>	sllovenishtja



**VEÇORITË NATYRORE** Sllovenia kufizohet me Austrinë në veri, Hungarinë në lindje, Kroacinë në jug, Italinë në perëndim dhe Detin Adriatik. Brenda këtyre kufijve ajo zë një sipërfaqe prej 20.273 km<sup>2</sup>. Sllovenia ka pozitë të volitshme gjeografike. Është vend **ballkanik**, **mesdhetar** dhe **alpin**. Pozita e favorshme e këtij vendi është për shkak të daljes në Detin Adriatik, i cili është me rëndësi të veçantë për këtë vend.

**Relievi** në Slloveni është kryesisht malor. Në pjesën e saj veriperëndimore shtrihen kurorat lindore të **Alpeve**. Prej tyre ndahen kurorat malore të **Alpeve Karavanke** dhe të **Julisë** me majën më të lartë - **Triglav** (2864). Në pjesën lindore të Sllovenisë gjenden malet e ulëta: **Kozjak, Pohorje** dhe **Gorica**



Trigllavi



Pirani



Shpella e Postojnës

**Slovene**, kurse në perëndim: **Tërnovski Gozd, Nanos** dhe **Snezhnik**. Fushëgropat e gjera shtrihen midis maleve. Më të njohura prej tyre janë: fushëgropat e **Lubjanës, Mariborit, Celjes** etj.


Në Slloveni, katër tipa klimatikë janë karakteristikë: **mesatare-bregdetare, kontinentale, e mesme -kontinentale** dhe **malore**.

**Lumenjtë** në Slloveni u përkasin dy pëllgjeve: **pellgut të Detit të Zi** dhe **pellgut Adriatik**. Lumenjtë **Sava, Drava** dhe **Mura** derdhen në pellgun e Detit të Zi, kurse **Soça** në Detin Adriatik. Këta lumenj kanë fuqi hidroenergjetike të konsiderueshme dhe mbi to janë ndërtuar disa hidrocentrale. Në Slloveni, e veçanërisht në rrëzë të Trigllavit, gjenden liqenet akullnajore: **Liqeni i Bledit** dhe **Bohinjit**, të cilat me ambientin dhe bukurinë e tyre tërheqin shumë turistë.

### POPULLSIA DHE EKONOMIA


Popullsinë e Sllovenisë e përbëjnë kryesisht sllovenët (83%), pastaj italianët, kroatët, serbët, maqedonasit e të tjerë. Feja katolike është feja më e përfaqësuar. Sllovenia është vendi më i zhvilluar në Ballkan, kurse sipas rritjes vjetore ekonomike është ndër të parat në Evropë. Nga degët industriale që marrin pjesë me 25% në ekonominë e shtetit, më të zhvilluara janë: **industria metalike** (Lubjanë), **automobilistike** (Maribor), **elektrike** (Kranj dhe Velenje), **kimike** (Novo Mesto), **tekstile** (Murska Sobota), e **drurit** dhe **ushqimit**. Vëmendje e madhe i është

Shpella e Postojnës - sistem shpellash karstike, e gjatë 20,5 km, afër qytetit të Postojnës. Është sistemi i dytë më i madh në Slloveni dhe njëri nga vendet më të vizituara në vend. Shpella u krijua nga lumi Pivka. Në vitin 1872 në shpellë është vendosur hekurudhë vizitorësh për të parë brendësinë e shpellës. Në fillim, treni i vogël shtyhej nga vetë udhëzuesit, por në fillim të shekullit të 20-të, shtyrja u zëvendësua nga një lokomotivë gazi. Në vitin 1884 ndriçimi elektrik është instaluar në shpellë, i pari në vend, madje edhe para Lubjanës.



kushtuar bujqësisë dhe blegtorisë në Slloveni, përkundër faktit se bujqësia ka një pjesë të vogël në ekonomi (3%). **Turizmi** zë një vend të rëndësishëm në ekonominë e këtij vendi. Ai është më i zhvilluar në bregdetin e Adriatikut (**Portorozh, Piran, Kopër**, etj.), Pastaj në Alpet (**Planica** dhe **Kranjska Gora**), në Liqenin e Bledit dhe Bohinjit. Shumë turistë tërhiqen gjithashtu nga shpellat nëntokësore. Më e njohur prej tyre është **Shpella e Postojnës**, e cila është një nga më të bukurat në Evropë. Sllovenia eksporton mallra industriale dhe importon produkte bujqësore, vaj dhe xehe.

**Grafiku 6:** Përfaqësimi i aktiviteteve ekonomike në Slloveni



**NDARJA RAJONALE** Regjionalisht, Sllovenia është e ndarë në katër rajone: **alpine, dinarike, ultësinore** dhe **bregdetare**. Në mënyrë administrative, që nga koha e Monarkisë së Habsburgut ajo është ndarë në 8 rajone.



**Për njohuri të thelluara:**

- Liqeni Vrana në ishullin e Cresit në Kroaci është liqeni më transparent në Ballkan (24 metra), përpara Liqenit të Ohrit me 21,5 metra. Në të njëjtën kohë është **kriptodepresion**, respektivisht fundi i tij shtrihet 60 metra nën nivelin e detit, ndërsa sipërfaqja e liqenit është mbi nivelin e detit.
- Shpella e Postojnës në Slloveni është e gjatë mbi 20 km, ndërsa u formua nga lumi Pivka i cili është lumë nëntokësor. Është rregulluar për vizitë turistike në gjatësi prej 5 km. Përveç stolive spektakulare të shpellës, shpella është zbukuruar me kuriozitet të veçantë - peshkun njeri.
- Vlera të njohura dhe tërheqëse për të vizituar Kroacinë dhe Slloveninë:

Objekte natyrore	Vende turistike	Monumentet kulturore-historike	Qytete
Liqenet e Plitvicës	Dubrovniku	Pallati i Dioklecianit	Zagreb
Hvar	Shibeniku	Dubrovniku i vjetër	Rovinj
Mlet	Poreçi	Arena e Pullës	Pullë
Liqeni Vransko	Spliti	Katedralja e Shibenikut	Zarë
Trigllav (Slloveni)	Koperi (Slloveni)	Sheshi, Piran (Slloveni)	Lubjanë (Slloveni)
Liqeni i Bledit (Slloveni)	Rogla (Slloveni)	Kalaja Predjama (Slloveni)	Maribor (Slloveni)
Shpella e Postojnës (Slloveni)	Bledi (Slloveni)	Kalaja e Kostanjevicës (Slloveni)	Celje (Slloveni)

**Për të kontrolluar njohuritë e fituara:**

- Si është rëndësia e Detit Adriatik për Kroacinë dhe Slloveninë?
- Cilat janë destinacionet turistike më të vizituara dhe më të rëndësishme në Kroaci dhe Slloveni?
- Cilat industri zhvillohen në Kroaci dhe Slloveni?



**Detyra me aplikimin e TIK-ut:**

- Me ndihmën e softuerit (Google Map) mëso dhe bëj një listë të ishujve më të mëdhenj dhe të qyteteve bregdetare në Kroaci!
- Hulumto dhe bëj mini-projekt për ndonjë nga parqet kombëtare në Kroaci ose Shpellën e Postojnës në Slloveni!

# MALI I ZI DHE BOSNJA E HERCEGOVINA



## MALI I ZI

Emri	Mali i Zi
Kryeqyteti	Podgorica
Sipërfaqja (km <sup>2</sup> )	13.812
Numri i banorëve	622.000
Rregullimi	republikë
Gjuha zyrtare	malazeze



### Diskutim interaktiv hyrës:

- Monumentet dhe vlerat kombëtare: Lovqen, Durmitor, Budva, Bash-çarshia... - Cilat janë paranjohuritë e tua?

**VEÇORITË NATYRORE** Mali i Zi, si shtet ballkanik, kufizohet me Serbinë në veri, Kosovën dhe Shqipërinë në lindje, kurse Bosnjë e Hercegovinën dhe Kroacinë në perëndim. Me kufirin e vet jugor, Mali i Zi ka dalje në Detin Adriatik. Mali i Zi ka pozitë të volitshme gjeografike, sepse ka dalje në det. Është i lidhur me pjesën e brendshme të Gadishullit Ballkanik me disa autostrada dhe me hekurudhën Beograd-Tivar.

Sa i përket **relievit** në Mal të Zi ka tri tërësi natyrore karakteristike. Këto janë: **bregdeti malazez, malet karstike dhe fushat, dhe peizazhi i maleve të larta**. Bregdeti përfshin brezin e ngushtë nga lumi **Buna** në lindje deri në **Krivoshie** dhe **Boka e Kotorit** në perëndim. Në veri të bregdetit të Malit të Zi, deri në lumin Zeta, shtrihet një-sia e dytë natyrore. Këto janë malet dhe fushat **karstike** (gëlqerore). Malet dhe hapësira e tërë në këtë tërësi janë: të zhveshur, pa ujë dhe shkëmbore. Fushat më të njohura karstike janë: e **Nikshiqit, Grahovës** dhe e Cetinës. Tërësi e tretë natyrore është peizazhi i maleve të larta. Të gjitha malet në këtë tërësi janë më të larta se 2.000 metra dhe në të kaluarën ato kanë qenë të mbuluara me akullnaja: **Durmitori, Sinjaevina, Bjelasica, Komovi, Prokletie** (Bjeshkët e Nemuna) etj.

Ekzistojnë tre **lloje klimatike** në Malin e Zi: **klima mesdhetare** (në bregdet), **klima e ndryshueshme mesdhetare** (përgjatë luginave të lumenjve) dhe **klima malore**.

**Lumenjtë** në Mal të Zi u përkasin dy pellgjeve detare. Këto janë pellgjet ujëmbledhëse të Adriatikut dhe Detit të Zi. Lumi **Buna** derdhet në Detin Adriatik, i cili rrjedh nga Liqeni i Shkodrës. Lumenjtë **Piva, Tara, Limi** e të tjerë i përkasin pellgut të Detit të Zi. Këta lumenj kanë forcë të konsiderueshme hidroenergjetike sepse janë të shpejtë



Durmitori është mal masiv dhe park kombëtar në veriperëndim të Malit të Zi. Masivi kufizohet me Kanionin

Tara në veri, Kanionin Piva në perëndim dhe Kanionin Komarnica në jug. Në lindje shtrihet rrafshnalta Jezerska Povrsh, në një lartësi prej 1.500 m. Ka 48 maja mbi 2.000 m. Më i larti është Bobotov Kuk, me 2.522 m. Ka 18 liqene akullnajore të quajtura "sy malesh" përgjatë masivit dhe rrafshnaltës Jezerska Povrsh. Më i madhi prej tyre është Liqeni i Zi, i ndarë në Liqenin e Madh dhe të Vogël.

dhe kanë lugina kanionesh. Përveç **Liqenit të Shkodrës**, si liqeni më i madh karstik, ekzistojnë liqene akullnajore në Mal të Zi. Më të njohura në mesin e tyre janë: **Liqeni i Zi** në Durmitor, **Liqeni i Biogradit** në Bjellasicë dhe **Liqeni i Plavës** nën Bjeshkët e Nemuna.


**POPULLSIA DHE EKONOMIA** Mali i Zi është vend me popullsi të paktë. Popullsia përbëhet nga: malazezët, serbët, boshnjakët, myslimanët, shqiptarët etj. Gjuha zyrtare është **malazeze**, por një pjesë e madhe e popullsisë deklaruan se përdorin **serbishten**. Shumica i përket fesë **ortodokse**. Qendra kryesore politike dhe kulturore është **Podgorica**. Në ekonomi, kontribut më të madh ka **sektori i shërbimeve** (73%), **industria** (17%) dhe **bujqësia**. Qendrat industriale për industrinë e drurit dhe metaleve janë: Nikshiqi, Podgorica, Cetina dhe Berana. Turizmi është industria më e rëndësishme në Mal të Zi. Vizitohet çdo vit nga rreth një milionë turistë në brigjet malazeze në: **Herceg Novi, Sutomore, Tivat, Budvë, Shën Stefan, Ulqin** etj.

**NDARJA RAJONALE** Vendi është i ndarë në zonën **bregdetare** dhe **malore**, kurse në aspektin administrativ është i ndarë në 21 komuna.

**Tabela 3:**  
Parqet kombëtare në Mal të Zi

PARQET KOMBËTARE	
Durmitori	Liqeni i Shkodrës
Biogradska Gora	Bjeshkët e Nemuna
Lovqen	

**Grafiku 7:** Përbërja etnike e popullatës në Mal të Zi (%)



## BOSNJA E HERCEGOVINA

<b>Emri</b>	Bosnja e Hercegovina
<b>Kryeqyteti</b>	Sarajeva
<b>Sipërfaqja (km<sup>2</sup>)</b>	51.197
<b>Numri i banorëve</b>	350.3000 (3.503 000)
<b>Rregullimi</b>	republikë federale
<b>Gjuha zyrtare</b>	boshnjakishtja, serbishtja, kroatishtja

**VEÇORITË NATYRORE** Bosnja e Hercegovina zë pjesën jugperëndimore të Gadishullit Ballkanik. Kufizohet me Serbinë dhe Malin e Zi në lindje dhe Kroacinë në veri dhe perëndim. Vetëm një pjesë e vogël e territorit të Bosnjës e Hercegovinës ka dalje në Detin Adriatik. Në kuadër të këtyre kufijve, Bosnja e Hercegovina mbulon një sipërfaqe prej 51.197 km<sup>2</sup> dhe mbi 3,5 milionë banorë. Bosnja e Hercegovina ka pozitë të volitshme gjeografike, pasi ka dalje në Detin Adriatik. Kjo i hap rrugën kah vende të tjera detare.

**Relievi** në Bosnjë e Hercegovinë është kryesisht **malor**. Hapësira më e madhe e territorit të saj përbëhet nga malet që i përkasin grupit malor Dinarik. Malet e mesme dhe të larta shtrihen në pjesën jugperëndimore: **Çvërsnica, Prenj, Bjelashnica, Zelengora, Lelija, Dinara, Cincar, Golia, Vitorog, Gërmeç** etj. Ka male të ulëta në veri. Toka ultësimore në Bosnjë e



Sarajeva

Hercegovinë është e vendosur në pjesën veriore të kësaj republike, në luginën e lumit Sava me degët e saj jugore. Specifike për relievin e këtij vendi janë fushat karstike: **Gllamoçit, Duvanjs, Livanjit** etj.


**Klima** në Bosnjë e Hercegovinë është kryesisht e **butë-kontinentale** dhe në luginën e lumit Neretvë ndjehet ndikimi i klimës mesdhetare. Klima malore është e pranishme në malet më të larta.

**Lumenjtë** në Bosnjë e Hercegovinë u përkasin dy pellgjeve detare: **Detit të Zi** dhe **Adriatikut**. Në pellgun e Detit të Zi, të gjithë ujërat nga Bosnjë e Hercegovina mblidhen nga lumi Sava. Degët më të mëdha të këtij lumi janë: **Una, Vërbasi, Bosnja dhe Drina**. Lumi **Neretva** i përket zonës pellgore të Adriatikut.

**POPULLSIA DHE EKONOMIA** Në Bosnjë e Hercegovinë jetojnë disa popuj. Më të shumtë janë: boshnjakët, serbët, kroatët etj. Përbërja fetare e banorëve është: **myslimanë, ortodoksë dhe katolikë**.

Ekonomia në Bosnjë e Hercegovinë mbetet prapa shumicës së vendeve evropiane. Potenciali qëndron në burimet minerale të: **hekurit, qymyrit, boksitit dhe kripës**. Nga degët industriale në Bosnjë e Hercegovinë janë zhvilluar: ajo metalike, mekanike, kimike dhe elektrike. Qendrat industriale janë: **Zenica, Banja Luka, Tuzlla, Sarajeva** etj.

**Grafiku 8:** Përbërja etnike e BeH



**NDARJA RAJONALE.** Me Marrëveshjen e Paqes në Dejton të vitit 1995, Bosnja e Hercegovina është ndarë në tri pjesë: **Federata e BeH**, e populluar nga boshnjakët dhe kroatët, **Republika Serbe** e populluar nga serbët dhe Rrethi i pavarur **Bërçko**.

**Për njohuri të thelluara:**

- Gjiri i Boka Kotorit është margaritar në brigjet e Malit të Zi. Gjatësia e vijës bregdetare është 33 km, midis maleve Orjen dhe Lovqen. Atraktiviteti i gjirit plotësohet nga flora dhe vendbanimet turistike: Kotor, Risan, Perast dhe Tivat.
- Parku kombëtar Sutjeska në BeH njihet gjithashtu si Parku i "Heroizmit dhe fitores". Bukuria e parkut shprehet nga pylli i pashkelur Peruçica dhe ujëvara Skakavac.
- Vlera të dalluara dhe tërheqëse për t'u vizituar Mal i Zi dhe BeH:



Objekte natyrore	Vende turistike	Monumentet kulturore-historike	Qytete
Boka e Kotorit	Budvë	Mauzoleumi i Lovqenit	Podgoricë
Liqeni i Biogradit	Shën Stefani	Manastiri Ostrog	Cetinje
Durmitori	Herceg Novi	Star Grad, Kotor	Nikshiq
Sutjeska (BeH)	Neum (BeH)	Most, Vishegrad, (BeH)	Sarajevë (BeH)
Jajce, ujëvarat (BeH)	Jahorina (BeH)	Mostar (BeH)	Mostar (BeH)
Kozara (BeH)	Travnik (BeH)	Ostrozhaç, kështjellë (BeH)	Banja Lukë (BeH)

**Për të kontrolluar njohuritë e fituara:**

- Cilat janë malet më të larta në Mal të Zi dhe BeH?
- Cilat liqene akullnajorë ndodhen në Mal të Zi?
- Cilat fusha karstike janë në BeH?
- Cila është përbërja etnike e BeH-së?

**Detyra me aplikimin e TIK-ut:**

- Me ndihmën e softuerit (Google Map) mëso dhe bëje një listë të 10 qyteteve më të mëdha në BeH dhe 10 vendeve turistike bregdetare në Mal të Zi!

# GADISHULLI APENIN



## Diskutim interaktiv hyrës:

- Monumentet dhe vlerat kombëtare: Ulkonja romake, Azuret, Papa... - Cilat janë paranjohuritë e tua?



# ITALIA, SAN MARINO DHE VATIKANI



## ITALIA

Emri	Italia
Kryeqyteti	Roma
Sipërfaqja (km <sup>2</sup> )	30.1340
Numri i banorëve	60.500.000
Rregullimi	republikë
Gjuha zyrtare	italishtja

**VEÇORITË NATYRORE** Italia ndodhet në Gadishullin Apenin dhe ka pozitë të volitshme gjeografike. Në tri anë ajo është e rrethuar nga ujërat e deteve **Adriatik, Deti Jon, Deti Mesdhe, Ligur** dhe **Tirren**. Në veri në pjesën e Alpeve kufizohet me shtetet: Austrinë dhe Zvicrën, në perëndim me Francën, dhe në lindje me Slloveninë. Italia ka në përbërje dy ishujt e mëdhenj: **Sicilinë** dhe **Sardenjën**.

**Relievi** në Itali kryesisht është **malor**. Alpet janë në pjesën veriore, kurse **Apeninet** shtrihen përgjatë gjithë gadishullit, në një gjatësi prej mbi 1000 km. Rrafshi i **Lombardisë** ndodhet në pjesën veri-perëndimore.

**Klima** në Itali kryesisht është **mesdhetare**, dhe në Alpe ajo **malore**.

**Lumenjtë** në Itali janë të shkurtër dhe derdhen në detin Adriatik dhe në detin Tirren. Më të njohur prej tyre janë lumi **Po** dhe **Tibri**. Nga liqenet më të mëdha janë: **Komo, Garda** dhe **Maxhore**.

**POPULLSIA DHE EKONOMIA** Popullsia në këtë vend përbëhet nga italianët (91%), francezët, shqiptarët (arbëreshët), austriakët, sllovenët e të tjerë. Gjuha zyrtare është **italishtja**, kurse shumica e popullsisë është katolike (75%). Italia është vend industrial dhe agrar shumë i zhvilluar. Është anëtar i tetë vendeve më të zhvilluara në botë (**G8**). Bujqësia është më e zhvilluar në fushat e Lombardisë. Italia është lider botëror në prodhimin e: rrushit dhe verës, ullinjve, mollëve, portokajve, limonëve,



Harta topografike e Italisë



Toskana

dardhave dhe pjeshkave. Industritë më të zhvilluara janë: **industria automobilistike, kimike, mekanike, petrokimike, e ndërtimit të anijeve dhe industria elektrike.** Turizmi zë 10% të ekonomisë. Klima e vulltshme, monumentet e shumta kulturore dhe historike, si dhe gjatësia e bregdetit (mbi 6.600 km), e bëjnë atë tërheqës për turistët. Qytetet më tërheqëse turistike janë: **Roma, Venediku, Milano, Firenca dhe Piza.** Tërheqja turistike e këtij vendi është rritur nga vullkanet e gjalla: **Vesuvi, Etna, Vullkano dhe Stromboli,** për shkak të të cilëve vijnë një numër i madh turistësh. Turizmi malor zhvillohet në Alpe, veçanërisht në liqenet akullnajore.

**NDARJA RAJONALE** Italia është e ndarë në 20 rajone, pesë prej të cilave kanë status autonom.

**Tabela 4:** Pesë qytetet më të mëdha italiane


Qyteti	Rajoni
1. Roma	Lacio
2. Milano	Lombardia
3. Napoli	Kampanja
4. Torino	Piemonti
5. Palermo	Sicilia



Roma

**Tabela 5:** Industria e automobilave në Itali

MARKAT E AUTOMOBILAVE		
Alfa Romeo	Fiat	Lançia
Maserati	Ferrari	Lamborghini



## SAN MARINO

<b>Emri</b>	San Marino
<b>Kryeqyteti</b>	San Marino
<b>Sipërfaqja (km<sup>2</sup>)</b>	61,2
<b>Numri i banorëve</b>	33.300
<b>Rregullimi</b>	republikë
<b>Gjuha zyrtare</b>	italishtja

gjitha anët me nga një fqinj. Ky vend mbulon hapësirën e pjesës kodrinore-malore të malit Monte Titano. San Marino zë një sipërfaqe prej 61.2 km<sup>2</sup> dhe sot rreth 33 mijë banorë jetojnë në atë zonë. Kryeqyteti i shtetit është San Marino. San Marino ka **klime mesdhetare.** Karakterizohet me vera të nxehta dhe dimra të lagësht e të butë.



San Marino

### VEÇORITË NATYRORE

Shteti i San Marinos ndodhet në pjesën lindore të gadishullit Apenin. Është **enklavë,** respektivisht vend i rrethuar nga të

### POPULLSIA DHE EKONOMIA


Popullsia e vendit përbëhet nga: san-marinët 85% dhe itali-anët 15%, me mbizotërimin e fesë katolike. Sipas rregullimit të saj shtetëror, San Marino është republikë. Aktivitetet më fitimprurëse janë: qarkullimi bankar, prodhimi i verës dhe i djathit. Sidoqoftë, industria më e rëndësishme në San Marino është turizmi, nga i cili realizohen të ardhurat më të larta në vend. Vizitohet çdo vit nga mbi 2 milionë turistë. Territori i shtetit ndahet në 8 komuna.





# VATIKANI

<b>Emri</b>	Vatikani
<b>Kryeqyteti</b>	Vatikani
<b>Sipërfaqja (km<sup>2</sup>)</b>	0,44
<b>Numri i banorëve</b>	1.000
<b>Rregullimi</b>	monarki elektorale
<b>Gjuha zyrtare</b>	italishtja, latinishtja



Vatikani

Vatikani është shteti më i vogël me një sipërfaqe prej 44 hektarësh dhe popullsi të përhershme prej 1.000 banorësh. Ndodhet në kryeqytetin e Italisë - Romë, në bregun e djathtë të lumit Tibër. Vatikani është qendra fetare dhe selia e Kishës Katolike Romane. Të ardhurat më të mëdha në vend janë realizuar nga shitja e pullave postare dhe suvenireve, si dhe nga vizitat e një numri të madh të turistëve për objektet kulturore të këtij vendi, siç janë: bazilikat, kapelat, muzetë etj.

### **Për njohuri të thelluara:**

- Roma është një nga qytetet më të vjetra evropiane, e themeluar në vitin 753 para erës së re. Është simbol i kulturës romake dhe evropiane. Shumica e monumenteve kulturore, nga të cilat Koloseu dhe Forumi, e ngritën atë në vendin e tretë në Evropë.
- Mali Vezuv ndodhet përgjatë Gjirit të Napolit në Itali. Shpesh ka shkakuar dëme të mëdha materiale dhe viktima njerëzore gjatë historisë. Hiri vullkanik nga shpërthimet e mëparshme të Vezuvit është gjetur në Ballkan, madje edhe në vendin tonë. Tre shpërthime u regjistruan në shekullin XX-të: në vitet 1906, 1929 dhe 1944.
- Vlerat e njohura dhe tërheqëse për ta vizituar Italinë dhe San Marinon:



Objekte natyrore	Vende turistike	Monumentet kulturore-historike	Qytete
Liçeni Garda	Romë	Koloseum	Milano
Liçeni Komo	Venedik	Forum Romak	Torino
Dolomitet	Firencë	Pompeja	Bari
Ishulli Kapri	San Remo	Herkulaneum	Triestë
Monte Titano (S. Marino)	San Marino	Guaita (S. Marino)	Dogana (S. Marino)

### **Për të kontrolluar njohuritë e fituara:**

- Me cilët dete kufizohet Italia?
- Cilat liçene akullnajorë gjenden në Itali?
- Me cilën degë të industrisë kryeson Italia në botë?
- Çfarë lloj sistemi shtetëror ka Vatikani?

Google



### **Detyra me aplikimin e TIK-ut:**

- Përdor mjetin softuer dhe zbulo se cila është gjatësia dhe gjerësia më e madhe e territorit të shtetit italian!
- Kërko dhe bëj mini-projekt për rajonet italiane me qendrat e tyre rajonale të qytetit dhe aktivitetet themelore për të cilat njihen (ushtrimi është i përshtatshëm për punë në çifte)!

# GADISHULLI PIRINEJ



## SPANJA, PORTUGALIA DHE ANDORA



### Diskutim interaktiv hyrës:

- Monumentet dhe vlerat kombëtare: Korida, Ibiza, Barcelona... - Cilat janë paranjohuritë e tua?



## SPANJA,

Emri	Spanja
Kryeqyteti	Madridi
Sipërfaqja (km <sup>2</sup> )	505.990
Numri i banorëve	46.773.000
Rregullimi	monarki
Gjuha zyrtare	spanjishtja

Atlantik, kurse në jug dhe në lindje me Detin Mesdhe. Brenda këtyre kufijve, Spanja zë një sipërfaqe prej 505.990 km<sup>2</sup> dhe mbi 46 milionë banorë që jetojnë në atë territor. Spanja ka pozitë gjeografike shumë të volitshme. Përmes Oqeanit Atlantik lidhet me të gjithë oqeanet e tjerë në botë. Përveç kësaj, është më afër kontinentit të Afrikës, për vetëm 14 km te **Ngushtica e Gjibraltarit**.

**VEÇORITË NATYRORE** Spanja është vendi më i madh në Gadishullin Pirinej. Ajo ka kufi tokësor vetëm me Francën në veri dhe me Portugalinë në perëndim. Kufizohet në veri dhe perëndim me ujërat e Oqeanit



Kadiz – Andaluzia

Kadizi, qytet i lavdishëm i Andaluzisë, është më i vjetri dhe një nga më të bukurit në Gadishullin Pirinej. Ndërtesat në pjesën e vjetër të qytetit janë të ruajtura, kanë fasada të bukura dhe janë me një histori shumë të gjatë. Kadizi thuhet se është një nga qytetet më të vjetra në Evropë, e në çdo rast më i vjetër në Gadishullin Pirinej. Është më shumë se tre mijë vjet i vjetër. Ky port i rëndësishëm me një popullsi prej 157.000 është vendosur në Andaluzi, në bregdetin e Atlantikut.



Spanjës i takojnë **Ishujt Baleare** në Mesdhe dhe **Ishujt Kanare** në Oqeanin Atlantik.

**Relievi** në Spanjë është kryesisht malor. Malet më të njohura janë: **Pirinejet, Malet Iberike dhe Kantabrike, Sierra Morena, Sierra Nevada** etj. Në Spanjë ka edhe ul-tësira. Ato mbulojnë rreth 10% të territorit të saj. Më të njohurat janë **Andaluzia dhe Aragonia**.

**Klima** në Spanjë është: **atlantike, mesdhetare, e mesme -kontinentale dhe malore**. Në pjesët jugore, temperaturat maksimale arrijnë deri në 48 °C.

**Lumenjtë** më të gjatë në Spanjë janë **Duro, Tezho, Minjo, Guadiana** dhe **Guadalkivir**, të cilët derdhen në Oqeanin Atlantik dhe **Ebro**, i cili derdhet në Detin Mesdhe.


**POPULLSIA DHE EKONOMIA** Popullsia në këtë vend përbëhet nga spanjollët (87%) e të tjerë (13%). Rreth 67% e qytetarëve në Spanjë i përkasin fesë Katolike Romane. Gjuha zyrtare është **spanjishtja**, por ende në përdorim është: **katalonishtja, baskishtja dhe galishtja**. Spanja është udhëheqëse botërore në prodhimin e: vajit të ullirit, verës, orizit, bajameve dhe agrumeve. Spanja është vendi i pestë më i industrializuar në Evropë. Më të zhvilluarat janë: **industria mekanike, ndërtimi i anijeve, kimike dhe e tekstilit**. Turizmi është degë shumë e rëndësishme që merr pjesë me 11% në ekonomi. Spanja është vendi i dytë më i vizituar në botë me mbi 80 milionë turistë në vit.

**NDARJA RAJONALE** Në Spanjë ka 4 rajone: rajoni atlantik, mesdhetar, qendror dhe pirinej. Në aspektin administrativ, shteti është i ndarë në 17 rrethe autonome dhe dy qytete me status autonom.



Madridi

**Grafiku 9:** Ekonomia në Spanjë



**Tabela 6:** Gjashtë rajone autonome më të mëdha në Spanjë

Rajoni	Qendra e qytetit
Kastile dhe Leon	Valjadolid
Andaluzia	Sevila
Kastilia La Mança	Toledo
Aragonia	Saragosa
Estramadura	Merida
Katalonia	Barcelona



Barcelona



## PORTUGALIA

**VEÇORITË NATYRORE** Portugalia kufizohet me Spanjën në veri dhe në lindje, kurse në perëndim dhe jug me Oqeanin Atlantik. Brenda këtyre kufijve ajo zë një sipërfaqe prej 92.212 km<sup>2</sup> dhe në atë hapësirë jetojnë mbi 10 milionë banorë. Portugalia ka pozitë të volitshme gjeografike, sepse ka dalje në Oqeanin Atlantik, i cili e lidh atë me lidhje ujore me shumë vende bregdetare në botë. Portugalia gjithashtu përfshin ishujt **Madeira** dhe **Azoret** në Oqeanin Atlantik.

**Relievi** në Portugali, përgjatë Oqeanit Atlantik është kryesisht ultësinor, kurse drejt kufirit me Spanjën është reliev malor. Lumenjtë **Minjo**, **Duro**, **Tezho** dhe **Guadiana** rrjedhin përmes Portugalisë. Ata derdhen në Oqeanin Atlantik.

Ekzistojnë dy lloje të tipeve **klimatike** në Portugali, edhe atë: klima **atlantike** në veri dhe **mesdhetare** në jug.

**POPULLSIA DHE EKONOMIA** Popullsia në këtë vend është kryesisht portugeze, me 99%, kurse sipas besimit, katolikët romanë janë 97% e popullsisë. Kryeqyteti i këtij shteti është **Lisbona**. Kulturat bujqësore më të kultivuara në këtë vend janë: misri, elbi, hardhia e rrushit, limonat, ullinjë, portokajtë, etj. Portugalia është eksportuesi i pestë më i madh i verës në botë. Nga pasuria minerale ka: **kallaj**, **volfram** dhe **uranium**, kurse në energjetikë përdor energji nga valët e detit dhe rrezet e diellit. Nga degët industriale janë zhvilluar: ndërtimi i anijeve, industria e tekstit dhe ajo ushqimore. Turizmi është aktivitet i rëndësishëm në Portugali. Ajo i përket grupit të 20 vendeve më të vizituara në botë.

**NDARJA RAJONALE** Rajonalisht shteti është ndarë në tri pjesë: pjesa **veriore**, **jugore** dhe **ishullore**. Në aspektin administrativ, Portugalia është e ndarë në 5 krahina kontinentale dhe 2 ishuj.



Lisbona



<b>Emri</b>	Portugalia
<b>Kryeqyteti</b>	Lisbona
<b>Sipërfaqja (km<sup>2</sup>)</b>	92.212
<b>Numri i banorëve</b>	10.290.000
<b>Rregullimi</b>	republikë
<b>Gjuha zyrtare</b>	portugalishtja

**Tabela 7:** Pesë qytetet më të mëdha në Portugal

Qyteti	
1. Lisbona	4. Aveiro
2. Porto	5. Faro
3. Braga	




## ANDORA

Andora është shteti më i vogël në Gadishullin Pirinej. Kufizohet vetëm me Francën dhe Spanjën. Ndodhet lartë në malet Pirineje dhe ka një sipërfaqe prej 467 km<sup>2</sup>. Sot, mbi 77 mijë banorë jetojnë në atë territor. Klima është malore dhe kontinentale. Kryeqytet i shtetit është **Andora la Vela**, gjithashtu është kryeqyteti me lartësi më të madhe mbidetare në Evropë (1023 metra).

<b>Emri</b>	Andora
<b>Kryeqyteti</b>	Andora la Vela
<b>Sipërfaqja (km<sup>2</sup>)</b>	467,6
<b>Numri i banorëve</b>	77.300
<b>Rregullimi</b>	principatë
<b>Gjuha zyrtare</b>	katalonishtja

Popullsia është me origjinë katalonase dhe e flet gjuhën katalanase, kurse feja është katolike. Turizmi është aktiviteti kryesor që merr pjesë me 80% të të ardhurave të realizuara. Çdo vit, Andorra vizitohet nga mbi 10 milionë turistë. Në sektorin bankar, Andorra njihet si një "parajsë taksash" për shkak të lehtësimeve të taksave për shtetasit e huaj.



Andorra la Vella

**Për njohuri të thelluara:**

- Ole, ole... - është klithja e stuhishme në arenat spanjolle ku në lartësinë e një sporti kombëtar luhen luftërat tradicionale me dema, të quajtura "korida". Koridat gjithashtu janë atraksione turistike për vizitorët e huaj që kanë mundësinë të shikojnë drejtpërdrejt një përleshje midis një toreadorit dhe një demit të tërbuar.



Objekte natyrore	Vende turistike	Monumentet kulturore-historike	Qytete
Kosta Brava	Madrid	Alhambra, Granada	Kadiz
Kosta del Sol	Barcelona	Alcazar, Sevilla	Toledo
Ishujt Baleare	Majorka	Pallati Mbretëror, Madrid	Salamanka
Tenerife	Malaga	Xhamia e Madhe, Kordoba	Valencia
Malet Kantabrike	San Sebastian	Muzeu Del Prado	Sevilje
Portimao (Por.)	Madeira (Por.)	Manastiri Heronimo (Por.)	Lisbonë (Por.)
Furnas (Por.)	Lagos (Por.)	Batalha (Por.)	Porto (Por.)

**Për të kontrolluar njohuritë e fituara:**

- Cilat shtete janë të vendosura në Gadishullin Pirinej?
- Përdore hartën për të gjetur lumenjtë e Spanjës që rrjedhin në Oqeanin Atlantik!
- Në çfarë mbështetet ekonomia në Andorë?



**Detyra me aplikimin e TIK-ut:**

- Përdore mjetin softuerik dhe zbulo se cilët janë ishujt dhe qytetet më të vizituara në Spanjë!
- Mate gjatësinë e bregdetit të Portugalisë në vijë të drejtë nga pika më veriore në atë më jugore!?

# RREZIKIMI, NDOTJA DHE MBROJTJA E MJEDISIT TË EVROPËS JUGORE



## Diskutim interaktiv hyrës:

- Rikujtohu dhe përgjigju cilat gazra lëshohen nga automjetet?
- Pse është i rëndësishëm ozoni ( $O_3$ )?
- Çfarë di për grimcat PM 10?

Faktorët natyrorë dhe veçanërisht antropogjenë janë shkak i përkeqësimit të cilësisë së pjesëve themelore të mjedisit në Evropën Jugore. Proceset e degradimit sulmojnë pa mëshirë: **ajrin, ujin, tokën dhe jetën e gjallë.**

**AJRI** Ndotja e ajrit është një nga format më të rënda të degradimit të mjedisit me një kërcënim të drejtpërdrejtë për mbijetesën e botës organike. Atmosfera në Evropën Jugore përballë me disa burime të ndotjes së ajrit, të cilat mund të jenë me origjinë natyrore ose antropogjene. Burimet antropogjene të ndotjes së ajrit janë shumë më të shumta dhe efektive në atë kuptim dhe sulmojnë vazhdimisht ajrin e pastër përmes ndotjes mekanike ose kimike. Burimet më me ndikim në këtë grup janë: **industria, trafiku, energjia** dhe **familjet**. Ndotësit më të zakonshëm janë: **monoksidi i karbonit, dioksidi i sulfurit, dioksidi i azotit, ozoni, grimcat e pezulluara deri në 10 mikrometër në madhësi**



Indeksi i ajrit të ndotur në Evropën Jugore (min. 13 - max. 98)

**Tabela 8:** Qytetet me ajrin më të ndotur në rajonin jugor dhe në përgjithësi në kontinentin e Evropës (2018)

Qyteti	Shteti	Indeksi i ndotjes
1. Tetova	Maqedonia e Veriut	97
2. Shkupi	Maqedonia e Veriut	83
3. Napoli	Italia	83
4. Tirana	Shqipëria	79
5. Torino	Italia	74
6. Sarajeva	BeH	71
7. Barcelona	Spanja	70
8. Roma	Italia	67
9. Selaniku	Greqia	64
10. Milano	Italia	63



Shkupi

(PM 10), grimcat e pezulluara deri në 2.5 mikrometër në madhësi (PM 2.5), metalet e rënda etj. Sipas raporteve të Organizatës Botërore të Shëndetit (OBSH), rajoni i Evropës Jugore ka cilësinë më të ulët të ajrit në kontinentin e vjetër, veçanërisht mjediset urbane të Gadishullit Ballkanik. Në dhjetë qytetet më të ndotura të Evropës Jugore, madje 5 janë të vendosur në Ballkan. Arsyet kryesore janë: **teknologjia industriale e vjetëruar, përdorimi i lëndës djegëse prej druri dhe fosileve për ngrohje në dimër, qarkullim i automjeteve të vjetruara** në trafik, pyllëzimi i dobët, mosrespektimi i rregulloreve urbane, etj.




Industria është një nga ndotësit më të mëdhenj

**UJI** Uji i ndotur rrezikon jetën e njeriut dhe mbijetesën e botës bimore dhe shtazore. Këto ujëra kanë ndikim shumë negativ në mjedis. Ndotja e ujit në Evropën Jugore vjen nga një larmi burimesh. Ujërat më shpesh dhe më së shumti ndoten përmes ujërave të zeza të shkarkuara nga qytetet e mëdha, respektivisht nga: minierat, fabrikat, trafiku, mbeburinat e ngurta që hidhen në shtretërit e lumenjve etj. Burimi më i zakonshëm i **ndotësve organik** janë ujërat e zeza nga: **ekonomitë shtëpiake, fermat blegtorale, industria dhe bujqësia. Metalet toksike** janë produktet më të zakonshme nga: **minierat, objektet metalurgjike dhe industria e metaleve.** Rajoni i Evropës Jugore ka lumenj të rrezikuar seriozisht për shkak të numrit të ulët të **stacioneve të pastrimit**, kështu që ujërat e zeza të qytetit të përfundojnë të patrajtura në to. Më të rrezikuara janë ujërat e: Ballkanit, Italisë Jugore, Portugalisë dhe Andaluzisë në Spanjë. Lumi **Sarno** në Itali konsiderohet si lumi më i ndotur në Evropën Jugore me substanca toksike me origjinë industriale.



Lumë i ndotur

**Grafiku 10.** Sipërfaqja e mbrojtur nën “parkun kombëtar” në territoret shtetërore të Evropës Jugore (%)



Sa i përket zonës bregdetare, rajoni i Evropës Jugore krenohet me ujërat më të pastra të detit në nivelin evropian, kurse këtu dallohen brigjet e Greqisë dhe Spanjës, të cilat e shfrytëzojnë këtë moment në maksimum për qëllime turizmi.

**TOKA** Toka e punueshme është një burim natyror dhe i kufizuar i përdorur për prodhimin e ushqimit. Mbrojtja e tokës bujqësore është urgjente nëse marrim parasysh uljen e shpejtë të sipërfaqeve dhe degradimin e tyre, kurse regjenerimi i tyre kërkon mijëra vjet. Degradimi i tokës në Evropën Jugore ndodh për shkak të: erozionit dhe pyllëzimit të dobët, zgjerimit të vendbanimeve dhe ndërtesave tregtare, asgjësimit të mbeturinave të ngurta komunale dhe industriale, bujqësisë intensive etj.



Deponitë e egra

**BOTA ORGANIKE** Pasuria e botës bimore dhe shtazore në Evropën Jugore është nën kërcënim të vazhdueshëm. Disa nga speciet janë zhdukur, kurse shumë prej specieve janë në prag të **zhdukjes**. Kërcënimi më i madh për mbijetesën e botës së gjallë janë: përhapja e vendbanimeve, industria, shpyllëzimi i paplanifikuar, mbingarkesa, ndotja etj. Për të ruajtur diversitetin biologjik, disa habitate të llojeve bimore dhe shtazore që karakterizohen me vlera të veçanta, me ligj janë kthyer në zona të mbrojtura me aktivitete të kufizuara njerëzore. Zonat e mbrojtura janë në formën e kategorive: **parqe kombëtare,**

**Tabela 9:** Lista e gjitarëve më të rrezikuar, para zhdukjes në Evropën Jugore

1. Rrëqebulli Iberik
2. Foka mesdhetare
3. Kuna evropiane
4. Lakuriqi i natës me dhëmbë të gjatë
5. Lakuriqi i natës nga Azori
6. Lakuriqi i natës me veshje të gjata
7. Tvori



Ngordhja e peshkut të lumit



**rezervate strikte natyrore, monumente të natyrës, vise me raritete të veçanta natyrore** e të ngjashme.

Për të kapërcyer problemet në nivelin rajonal, nevojiten plane komplekse veprimi dhe masa për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit, të cilat duhet të përfshijnë të gjithë sektorët e tij.



Edhe shpendët pësojnë

**Tabela 10:** Masat më urgjente për mbrojtjen e mjedisit në Evropën Jugore

Sektori	Masat
Ajri	Mospërdorimi i drurit si burim energjie; Zëvendësimi i qymyrit dhe karburantit me gaz, si burim energjie në termocentralet; Rritja e energjisë elektrike e prodhuar përmes mullinjve të erës dhe energjisë diellore; Instalimi i filtrave më të sofistikuar në oxhaqet e fabrikave dhe katalizatorëve në automobila...
Uji	Ndërtimi i stacioneve të pastrimit (kolektorëve) sipas standardeve botërore për pranimin e ujërave të zeza të qytetit përpara se të hidhen në lumë ose liqen; Trajtimi i ujërave të zeza në kolektorë përmes: filtrimit, kullimit, sedimentimit dhe neutralizimit të substancave të dëmshme; Ndërtimi i sistemeve kolektore për asgjësimin dhe trajtimi i ujërave të zeza nga objektet industriale sipas standardeve të paracaktuara...
Toka	Zvogëlimi i sipërfaqeve të zhveshura përmes pyllëzimit; Përdorimi i qëndrueshëm i fondit pyjor përmes prerjeve të planifikuara; Riciklimi i rritur i mbeturinave të paketimit, të paktën 70%...




**Për njohuri të thelluara:**

- Sipas Organizatës Botërore të Shëndetit (OBSH), rajoni më i ndotur në Evropë është Gadishulli Ballkanik. Këtu është e shpeshtë dukuria e qyteteve me shumë ndotje me përqendrim të lartë të grimcave të pezulluara (PM 10) edhe atë në: Shkup, Manastir, Tetovë (Maqedoni e Veriut), Plevle (Mali i Zi), Tuzëll (BeH), Valevë, Nish (Serbi), Pllովdiv (Bullgari) etj. Mbi 35.000 vdekje në vit në Ballkan janë shkaktuar nga ajri i ndotur.



**Për të kontrolluar njohuritë e fituara:**

- Si është ndikimi i energjisë, industrisë dhe trafikut në mjedis në Evropën Jugore?
- Çfarë masash duhet të ndërmerren për të parandaluar ndotjen e lumenjve në Evropën Jugore?



**Detyra me aplikimin e TIK-ut:**

- Kërko në internet për të zbuluar se cilët janë lumenjtë më të ndotur në Evropën Jugore dhe me cilët ndotës janë më shpesh të ndotur! Cili është ndikimi i tyre te njerëzit dhe bota ujore?

A photograph of Edinburgh Castle, a large stone fortress built on a rocky cliffside. The castle features several towers and battlements. The foreground is filled with lush green trees and a grassy slope. The sky is overcast with grey clouds. A semi-transparent white box with rounded corners is overlaid on the upper part of the image, containing text.

*Konceptet kryesore:*

- *Kriptodepresioni;*
- *Estuarët;*
- *Pendë ose digë;*
- *Kanalet;*
- *Platformat e naftës;*
- *Pasuritë natyrore;*
- *Destinacionet turistike.*

**Kështjella e Edinburgut është fortesë mbi qytetin e Edinburgut në Skoci. Arkeologët kanë zbuluar prani njerëzore në shkëmb që nga epoka e hekurit, por kështjella është ndërtuar në shekullin XII-të.**

# TEMA IV: VEÇORITË GJEOGRAFIKE TË EVROPËS PERËNDIMORE

BRITANIA E MADHE DHE REPUBLIKA E IRLANDËS.....	84
FRANCA .....	87
BENELUKSI.....	89



# EVROPA PERËNDIMORE



## Diskutim interaktiv hyrës:

- Monumentet dhe vlerat kombëtare: Stounhenxh, Big Ben, Ishulli i Gjelbër... - Cilat janë paranjohuritë e tua?
- Si ndryshoi Evropa Perëndimore pas Kolombos?



## BRITANIA E MADHE DHE REPUBLIKA E IRLANDËS



## BRITANIA E MADHE

Emri	Britania e Madhe
Kryeqyteti	Londra
Sipërfaqja (km <sup>2</sup> )	243.610
Numri i banorëve	66.020.000
Rregullimi	monarki
Gjuha zyrtare	anglishtja

**VEÇORITË NATYRORE** Britania e Madhe ka shtrirje në ishullin e **Britanisë së Madhe**, në pjesën veriore të ishullit të **Irlandës** dhe në ishujt më të vegjël përreth: **Hebridet, Orkine, Shetland, Norman** etj. Nga kontinenti i Evropës atë e ndan kanali **La Mansh**, 33 km i gjerë. Pozita gjeografike e Britanisë së Madhe është e volitshme. Ajo është e vendosur në kryqëzimin e rrugëve detare më të rëndësishme të Evropës për në Amerikë.

**Relievi**, Britania e Madhe ndahet në tërësi **malore** dhe **ultësinore**. Skocia, Uelsi dhe Irlanda Veriore janë kryesisht kodrinore dhe malore, kurse Anglia është ultësinore. Më të njohura janë Malet Kambrike, Malet Penine dhe Malet Grampiane me majën më të lartë, **Ben Nevis** (1343). Ultësirat më të mëdha janë ultësirat **Angleze** dhe **Skoceze**.

**Klima** në Britaninë e Madhe është **atlantike**, me vera të freskëta dhe me shi, kurse dimrat të butë dhe me mjegull.

**Lumenjtë** më të njohur në Britaninë e Madhe janë **Tamiz, Hamber, Severn** dhe **Klajd**. Ata janë të shkurtër, por plot me ujë dhe të lundrueshëm. Derdhjet e tyre gjatë baticës shndërrohen në gjire të thella



Londra

- **estaure.** Gjatë baticës, niveli i këtyre lumenjve rritet, duke lejuar që anijet të depërtojnë më thellë në kontinent. I tillë është rasti me lumin Tamiz. Gjatë baticës, Londra është qytet port, megjithëse është 62 km larg detit. **Fjordet** gjithashtu janë të pranishëm në bregdetin perëndimor. Liqenet janë me origjinë akullnajore.

**POPULLSIA DHE EKONOMIA** Britania e Madhe është e banuar nga rreth 66 milionë banorë. Popullsia përbëhet nga: **anglezë, skocezë, uelsanë, irlandezë** dhe emigrantë nga vende të tjera. Përveç anglishtes, janë ende në përdorim gjuhët uelsane, skoceze dhe irlandeze. Zona më e dendur me popullsi është midis Londrës, Lidsit dhe Liverpulit. Popullsia më së shumti u përket kishave protestante: anglikane, skoceze, baptiste etj.


Britania e Madhe është vendi i pestë më i zhvilluar në botë. Është i pasur me qymyr si **burim i energjisë**, kurse nga xehet është i pasur me **hekur**, gjë që i mundësoi që shumë herët të ngritet si një vend industrial. Që nga viti 1975, Britania e Madhe është prodhuese botërore e naftës dhe gazit, të cilat u zbluan nën Detin e Veriut. Ato shfrytëzohen përmes **platformave të naftës**. Në bujqësi më së shumti kultivohet: gruri, panxhar sheqeri, patatet, elbi, por gjithashtu mban fondin e: bagëtisë, deleve dhe derrave në nivel të miliona krerëve. Britania e Madhe është djepi i industrisë. Ajo ka më të zhvilluar industrinë: mekanike, tekstile, kimike dhe degë të tjera. Britania është fuqia e tretë më e madhe industriale në Evropë, me 20% të të ardhurave në ekonomi të përfituara nga industria.

**Turizmi** sjell 4% të të ardhurave vjetore. Kryeqyteti, **Londra**, është më i vizituar në Evropë, me 16 milionë turistë në vit.

**NDARJA RAJONALE** Emri zyrtar i vendit është "Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore" ose shkurt vetëm Britania e Madhe. Ndahet në 4 shtete: Angli, Skoci, Uels dhe Irlandë Veriore.

**Tabela 1:** Dhjetë kompani industriale më të fuqishme në Britani të Madhe (me emër origjinal).

Kompania	Dega
Unilever	ushqimore
Rio Tinto	metalike
Glaxo Smith Kline	farmaceutike
Anglo American	metalike
Astra Zeneca	farmaceutike
BAE Systems	mekanike dhe ushtarake
British American Tobacco	e duhanit
Imperial Tobacco	e duhanit
Associated British Foods	ushqimore
Rolls - Royce	automobilistike



## R. E IRLANDËS



**VEÇORITË NATYRORE** Republika e Irlandës është vend ishullor i rrethuar nga të gjitha anët me ujë. Pjesa verilindore, e njohur si Irlanda Veriore, i përket Mbretërisë së Bashkuar së bashku me Britaninë e Madhe. Brenda kufijve të saj Republika e Irlandës zë një sipërfaqe prej 70.273 km<sup>2</sup> dhe sot në këtë territor jetojnë mbi 4.7 milionë banorë. Kryeqyteti i vendit është Dublini. Klima në

<b>Emri</b>	Irlanda
<b>Kryeqyteti</b>	Dublina
<b>Sipërfaqja (km<sup>2</sup>)</b>	70.273
<b>Numri i banorëve</b>	4.784.000
<b>Rregullimi</b>	republikë
<b>Gjuha zyrtare</b>	irlandishtja, anglishtja

Republikën e Irlandës është oqeanike. Dimrat janë të butë dhe verat janë të freskëta. Irlanda ka disa lumenj, por të gjithë ata kanë rrjedhë të shkurtër. Më i madhi dhe më i gjati nga këta është lumi Shanon (370 km).

**POPULLSIA DHE EKONOMIA** Popullsinë e këtij shteti e përbëjnë kryesisht irlandezët. Pjesa më e madhe e irlandezëve, mbi 14 milionë, janë emigrantë në SHBA dhe Kanada. Anglishtja dhe irlandishtja janë gjuhët kryesore të popullsisë, e cila është kryesisht e besimit katolik. Nga kulturat bujqësore në Republikën e Irlandës, kultivohen kryesisht: elb, grurë, patate dhe panxhar sheqeri. Blegtoria është një nga industritë më të rëndësishme, veçanërisht gjedhet dhe dhentë, ku kushtet klimatike dhe biogjeografike lejojnë kullotje të hapur të tuface gjatë gjithë vitit. Nga burimet minerale Irlanda ka minerale të pasura me zink. Në Irlandë janë të zhvilluara disa degë të industrisë. Më të njohurat prej tyre janë: ushqimore, tekstile, metalike, kimike etj.

**NDARJA RAJONALE** Aspektin administrativ, Republika e Irlandës është e ndarë në 31 qarqe komunale - distrikte.



Dublin

**Tabela 2:** Pesë qytetet më të mëdha në Republikën e Irlandës

Qytetet
1. Dublin
2. Kork
3. Golvej
4. Limerik
5. Voterford

**Për njohuri të thelluara:**

- Londra është qyteti më i madh në Mbretërinë e Bashkuar dhe në Evropën Perëndimore. Londra u formua në brigjet e lumit Tamiz, nga romakët në fillim të erës së re. Edhe pse larg Detit të Veriut, përmes estuarit të Tamizit, Londra është qytet port. Aeroporti Heathrow në Londër është porti ajror më i ngarkuar në Evropë. Qyteti ka mjaft objekte natyrore, kulturore dhe arkitekturore. Hekurudha nëntokësore e Londrës u ndërtua në vitin 1863. Londra ka qenë nikoqir tri herë i Lojërave Olimpikë (1908, 1948 dhe 2012).
- Vlera të njohura dhe tërheqëse për vizitë në Britaninë e Madhe dhe Republikën e Irlandës:

Objekte natyrore	Vende turistike	Monumentet kulturore-historike	Qytete
Lejk Distrikt	Londër	Stounhenxh	Londër
Kanioni Çedar	Edinburg	Kulla e Londrës	Birmingem
Shpella e Fingalit	Glazgov	Banjat romake	Mançester
Liqeni Lohnes	Belfast	Muzeu britanik	Liverpul
Ura e Gjelbër, Uels	Jork	Pallati i Bukingemit	Brajton
Pik Distrikt	Bristol	Galeria kombëtare	Kardif
Kilarni (R. e Irlandës)	Dublin (R. e Irlandës)	Oborri, Kilkeni (R. e Irlandës)	Limerik (R. e Irlandës)

**Për të kontrolluar njohuritë e fituara:**

- Si është klima në Britaninë e Madhe dhe në Republikën e Irlandës?
- Çfarë pasurie minerale ka në Britaninë e Madhe?
- Cili aktivitet ekonomik është sinonim i Britanisë së Madhe dhe pse?

**Detyra me aplikimin e TIK-ut:**

- Hulumto me mbikëqyrje satelitore ose numëruar, cilat janë qytetet më të mëdha në Mbretërinë e Bashkuar dhe mëso se cilat janë portet më të mëdha në Britani të Madhe!
- Hulumto dhe bëj një mini-projekt me album dhe informacione themelore për monumentet e qytetit të Londrës!



Google





# FRANCA



### Diskutim interaktiv hyrës:

- Monumentet dhe vlerat kombëtare: Gjelat galë, shampanjë, qyteti i dritës... - Cilat janë paranjohuritë e tua?
- Si ndryshoi Evropa Perëndimore pas Kolombos?



**VEÇORITË NATYRORE** Franca zë pjesën e skajshme perëndimore të Evropës. Kufijtë natyrorë të Francës janë: **Pirinejet**, drejt Spanjës, **Alpet**, drejt Italisë dhe Zvicrës dhe lumit **Reni** drejt Gjermanisë. Vetëm kufiri verior është i hapur drejt Belgjikës. Në perëndim Franca shtrihet gjerësisht në Oqeanin Atlantik, kurse në jug në Mesdhe. Brenda këtyre kufijve ajo zë një sipërfaqe prej 543.965 km<sup>2</sup>. Përveç pjesës kontinentale, Franca ka edhe territore jashtë shtetit.

Franca ka **pozitë të volitshme gjeografike**. Ajo është: vend atlantik, mesdhetar dhe alpin. Dalja në Oqeanin Atlantik e lidh atë me vendet e Mesdheut, përmes Alpeve përsëri lidhet me vendet alpine. Bregdeti atlantik i Francës është më pak i përthyer. Gadishujt më të njohur janë: **Normandia** dhe **Bretanja**, kurse nga gjiret është **Gjiri i Biskajit**. Më i njohur në Detin Mesdhe është **Gjiri i Lionit**, kurse nga ishujt, **Korzika**.

**Relievi** i Francës përbëhet nga male dhe ultësira. Më të njohur nga malet e vjetra janë: **Ardenet**, **Vogezet** dhe **Masivet Qendrore**, kurse nga malet e reja, **Alpet** dhe **Pirinejet**. Në Alpe ndodhet maja më të lartë në Evropë, **Mon Blan** (4810). Ultësira e Francës shtrihet në veri-perëndim.

**Klima** është **atlantike**, me dimra të butë dhe me shi dhe vera të freskëta. Franca Jugore është e ekspozuar ndaj ndikimit të Detit Mesdhe dhe ka **klimë mesdhetare**. Franca Lindore dhe malet më të larta kanë **klimë kontinentale** dhe **malore**.


**Lumenjtë** në Francë u përkasin dy pellgjeve ujëmbledhëse. Në Oqeanin Atlantik derdhen: **Sena**, **Loara** dhe **Garona**. Të gjithë këta lumenj janë të lundrueshëm. Në grykëderdhje ata ndërtojnë estuare dhe janë të ndërlidhur me kanale të lundrueshme. Në Detin Mesdhe derdhet **Rona**, e cila formon **deltë** gjatë hyrjes.

**POPULLSIA DHE EKONOMIA** Rreth 67 milionë njerëz jetojnë në Francë. Shumica e popullsisë është franceze, 51% e të cilëve janë katolikë. Përveç këtyre, ka edhe **bretanjezë**, **flamandë** dhe disa miliona emigrantë evropianë dhe afrikanë.

<b>Emri</b>	Franca
<b>Kryeqyteti</b>	Parisi
<b>Sipërfaqja (km<sup>2</sup>)</b>	543.965
<b>Numri i banorëve</b>	67.120.000
<b>Rregullimi</b>	republikë
<b>Gjuha zyrtare</b>	frëngjishtja



Harta topografike e Francës



Përveç frëngjishtes, **bretonishtja**, nga grupi i gjuhëve kelte, përdoret si gjuhë zyrtare.

Nga **pasuria minerale**, Franca është e pasur me: **xehero-re hekuri, qymyri dhe boksiti**. Është një nga prodhuesit më të mëdhenj të energjisë elektrike në Evropë, kryesisht nga termocentralet bërthamore.

**Bujqësia** është moderne, megjithëse sjell vetëm 4% të të ardhurave vjetore. Prej kulturave bujqësore më shumë prodhohet: grurë, elb, rrush dhe panxhar sheqeri. Franca është prodhuesi dhe eksportuesi i dytë më i madh i verës në botë dhe në mesin e 15 vendet të para në botë për nga fondi i bagëtisë.

Nga **degët industriale** në Francë janë të zhvilluara: **industria mekanike, metalike, kimike, tekstile, ushqimore** e të tjera. Franca është lider botëror në prodhimin e: **automobilave** (Peugeot, Citroen, Renault), **avionëve** (Airbus), **gomave** (Michelin), **anijeve, automjeteve hekurudhore, parfumeve dhe tekstilit**.

**Turizmi** sjell 10% të të ardhurave të përgjithshme për ekonominë. Ai është i zhvilluar në bregdetin e Mesdheut dhe në Alpe. Me 83 milionë turistë në vit, Franca është vendi më i vizituar në botë. Qendrat më të njohura turistike janë: Parisi, Nice, Kana, Grenobël, Shamoni etj.

**NDARJA RAJONALE** Që nga viti 2016, Franca është ndarë në 18 rajone. Trembëdhjetë prej tyre janë kontinentale, përfshirë ishullin e Korzikës, kurse pesë janë tejoqeanike.

**Tabela 3:** Destinacionet më atraktive turistike në Francë

Verore	Dimërore	Të banjave
Nica	Grenobël	Vetel
Kana	Shamoni	Vishi
Biaric	Albertvil	Evian
Sen Trope	Val d' Isere	Argeles Gazost
Marsejë	Morzin	Kursheval

#### Për njohuri të thelluara:

- Kulla e Ajfelit me gjatësi 324 metra është shenje dhe simbol kombëtar i prestigjit arkitektonik në Paris dhe Francë. Paraqet strukturë çeliku e projektuar nga Aleksandar Ajfel. Është ndërtuar në vitin 1889 për të shënuar 100-vjetorin e Revolucionit Francez, deri tani është atraksioni më tërheqës turistik në Francë, e vizituar nga më tepër se 6 milionë turistë në vit.
- Shampanja si një emër i përgjithshëm për verërat me gaz erdhi nga rajoni i verërave në Shampanj në Francë, ku prodhohen lloje të verës me cilësi të lartë.
- Vlerat e njohura dhe tërheqëse për ta vizituar Francën:

Objekte natyrore	Vende turistike	Monumentet kulturore-historike	Qytete
Alpet	Parisi	Kulla e Ajfelit	Marsejë
Bregu Azur	Nica	Pallati i Versajës	Strasburg
Bregu i Argjendhtë	San Trope	Porta triumfale	Lioni
Masivi qendror	Kana	Katedralja e Notre Damit	Tuluz
Pirineje	Shamoni	Muzeu i Luvrit	Bordo

#### Për të kontrolluar njohuritë e fituara:

- Si është pozita dhe në cilat dete ka dalje Franca?
- Cilat kultura bujqësore kultivohen në Francë?
- Cilët degë industriale janë të zhvilluara në Francë?

#### Detyra me aplikimin e TIK-ut:

- Duke përdorur teknologjinë kompjuterike (Google Earth), mate gjatësinë e estaureve më të thella në lumenjtë kryesorë në Francë!
- Vëzhgoje nga larg bregdetin e Oqeanit Atlantik dhe Detit Mesdhe të Francës dhe bëj një listë me 10 vendpushimet më të mëdha!
- Bëj album për prezantim (Power Point) me fotografi dhe të dhëna themelore për monumentet më të rëndësishme të Parisit (detyra është e përshtatshme për punë në çifte ose grupe)!



# BENELUKSI (BELGJIKA, HOLANDA DHE LUKSEMBURGU)



## Diskutim interaktiv hyrës:

- Monumentet dhe vlerat kombëtare: Brukseli, Tulipanët, Toka e Ulët... - Cilat janë paranjohuritë e tua?
- Si ndryshoi Evropa Perëndimore pas Kolombos?



<b>Emri</b>	Belgjika
<b>Kryeqyteti</b>	Brukseli
<b>Sipërfaqja (km<sup>2</sup>)</b>	30.528
<b>Numri i banorëve</b>	11.120.000
<b>Rregullimi</b>	monarki
<b>Gjuha zyrtare</b>	holandishtja, frëngjishtja, gjermanishtja



<b>Emri</b>	Holanda
<b>Kryeqyteti</b>	Amsterdami
<b>Sipërfaqja (km<sup>2</sup>)</b>	41.543
<b>Numri i banorëve</b>	17.283.000
<b>Rregullimi</b>	monarki
<b>Gjuha zyrtare</b>	holandishtja



<b>Emri</b>	Luksemburgu
<b>Kryeqyteti</b>	Luksemburgu
<b>Sipërfaqja (km<sup>2</sup>)</b>	2.586
<b>Numri i banorëve</b>	602.000
<b>Rregullimi</b>	monarki
<b>Gjuha zyrtare</b>	frëngjishtja, gjermanishtja, luksemburgishtja



## VEÇORITË NATYRORE Emri **Beneluks**

është shkurtim i inicialeve të para të vendeve: Belgjikë, Holandë (Nederland) dhe Luksemburg. Vendet e Beneluksit kanë pozitë të volitshme gjeografike, duke dalë në Detin e Veriut (Belgjika dhe Holanda). Ato zënë pjesën më të ulët veriore të ultësirave të Evropës Perëndimore dhe ultësirave të Ardeneve.

**Relievi** është kryesisht **ultësinor**. Vetëm në jug të Belgjikës dhe Luksemburgut relievi është më i lartë, kurse këtu janë degët e ulëta të **Ardeneve**. Ultësitrat në vendet e Beneluksit janë në pjerrësi në veri dhe veriperëndim. Në Holandë relievi është **depression**, pra më i ulët se niveli i detit. Prandaj emri "Holandë", do të thotë **tokë e ulët**, sepse një e treta e territorit është nën nivelin e detit. Madje, rreth 17% e territorit të Holandës është **polder**, respektivisht tokë pjellore e krijuar artificialisht duke mbyllur dhe tharë sipërfaqet e detit ose liqenit. Si masë e mbrojtjes nga përmbytja, holandezët kanë ndërtuar argjinatura (diga) të larta përgjatë bregdetit të Detit të Veriut.

**Klima** në Beneluks është atlantike. Erërat e perëndimit janë konstante dhe sjellin reshje të shpeshta të shiut.

**Lumenjtë** më të njohur që rrjedhin nëpër këto vende janë: **Shelda, Mas (Meza), Rajna** (Reni) e të tjerë. Të gjithë ata janë: plot me ujë, të lundrueshëm dhe të ndërlidhur me kanale të lundrueshme, të cilat shërbejnë për komunikim dhe zbutje të valëve të përmbytjes gjatë niveleve të larta të lumenjve.

**POPULLSIA DHE EKONOMIA** Vendet e Beneluksit janë dendur të populluara. Mesatarja është 320 b/km<sup>2</sup> kurse në Holandë 414 banorë për 1 km<sup>2</sup>. Prej popujve më të shumtë janë **holandezë** (80%) në Holandë. Në Belgjikë janë **flamanët** (58%) dhe **valonët** (31%). Shumica në Luksemburg janë **luksemburgët**. Të gjitha vendet e Beneluksit janë **mbretëri**. Gjuhët në Beneluks i përkasin grupeve të gjuhëve gjermane dhe romane. Në Belgjikë dhe Luksemburg shumica e popullsisë është katolike, ndërsa në Holandë gjysma e popullsisë e deklaroi veten jo fetarë.

**Pasuritë natyrore** të Beneluksit përbëhen kryesisht nga: **qymyrguri** (Belgjikë), **xehero-ret e hekurit** (Luksemburg) dhe **gazi natyror** (Holandë). Rezervat më të mëdha të gazit



Bruksel




Amsterdam



Luksemburg

**Grafiku 3:** Përbërja fetare në Holandë



naturor në Evropë ndodhen në afërsi të qytetit të Holandës, Groningen.

Vendet e Beneluksit janë shumë të zhvilluara sa i përket bujqësisë dhe industrisë. Luksemburgu ka të ardhurat më të larta kombëtare për kokë banori në Evropë. Holanda ka bujqësinë më produktive në botë. Këto vende janë eksportues të produkteve blektorale. Vend të veçantë zë kultivimi i **luleve** në zona të mëdha në Holandë. Ajo është eksportuesi më i madh në botë i luleve dhe eksportuesi i dytë më i madh i frutave të kopshtit: domate, specja, kastraveca e të tjera.

**Degët e industrisë** në Beneluks janë: **metalurgjia, mekanika, tekstile, elektroteknike, ushqimore, ndërtimi i anijeve**, etj. Vendet e Beneluksit kanë rrjet rrugor dhe hekurudhor të zhvilluar mirë, si dhe rrjet të dendur të rrugëve ujore. Në tregtinë e jashtme eksportojnë: makina, trena, pajisje elektrike, produkte të qumështit, perime, birra e të tjera, kurse importojnë lëndë të para për industrinë e tyre si: vaj, pambuk, minerale etj.

**NDARJA RAJONALE** Regjionalisht dhe administrativisht, Belgjika është e ndarë në tre rajone: Flandria, Valonia dhe Brukseli. Flandria dhe Valonia kanë nga pesë provinca. Holanda është e ndarë në 12 provinca kontinentale dhe tre ishuj tejoqeanikë.

**Tabela 4:** Pesë qytetet më të mëdha në Belgjikë dhe Holandë

Belgjikë	Holandë
Antwerpen	Amsterdam
Gent	Rotterdam
Shariroa	Hagë
Liezh	Utreht
Bruksel	Ajndhoven

Rajonet në Belgjikë



**Për njohuri të thelluara:**

- "Tulipanët" është sinonim, i emrit të dytë të holandezëve, për shkak të kopshtarisë dhe eksportit më të zhvilluar të luleve në botë.
- Gjiri Zojder Ze u shkëput nga Deti i Veriut nga një digë në vitin 1932 dhe u shndërrua në liqen me ujë të ëmbël. Më vonë, me masat meliorative, disa pjesë të liqenit u thanë dhe u shndërruan në poldere - sipërfaqe pjellore bujqësore.
- Vlera të njohura dhe tërheqëse për vizitë në Beneluks:

Objekte natyrore	Vende turistike	Monumentet kulturore-historike	Qytete
Ardenet (Belgjikë)	Brizh (Belgjikë)	Atomium, Bruksel	Mons (Belgjikë)
Lumi Shelda (Belgjikë)	Liezh (Belgjikë)	Kambanaria, Brizh	Antwerpen (Belgjikë)
Dini, Texal Park (Holandë)	Vijk an Zee (Holandë)	Pallati mbretëror, Bruksel	Rotterdam (Holandë)
Fruta të luleve (Holandë)	Amsterdam (Holandë)	Muzeu Van Gog (Holandë)	Ajndhoven (Holandë)
Parku Betemburg (Luksemburg)	Luksemburg	Kalaja Vianden (Luksemburg)	Klerovo (Luksemburg)



**Për të kontrolluar njohuritë e fituara:**

- Cila është pozita gjeografike e vendeve të Beneluksit?
- Pse argjinaturat (digat) ndërtohen në brigjet e Holandës?
- Cila është rëndësia e lumenjve dhe kanaleve në Beneluks?



**Detyra me aplikimin e TIK-ut:**

- Hulumto përmes vëzhgimit satelitor (Google Earth) me cilat shtete në Evropë grupi Beneluks është i lidhur me kanale ujore në brendësi!
- Hulumto cili është roli i Belgjikës në Bashkimin Evropian!

*Termet kryesore:*

- *Gadishulli;*
- *Monarki;*
- *Fjorde;*
- *Akullnaja;*
- *Gjuha, kultura;*
- *Vendzbulime të minierave;*
- *Pyje;*
- *Gejzerë;*
- *Potenciali hidroenergjetik;*
- *Energjia;*
- *Dreri.*

**Aurora borealis – dritë polare në Norvegji.  
Fenomen natyror i shkaktuar nga përplasja  
e grimcave të elektrizuara nën ndikimin e  
fushës magnetike të Tokës.**



# TEMA V: VEÇORITË GJEOGRAFIKE TË EVROPËS VERIORE

EVROPA VERIORE .....	94
SUEDIA.....	94
NORVEGJIA DHE FINLANDA .....	97
DANIMARKA DHE ISLANDA .....	100



# EVROPA VERIORE



## SUEDIA

Emri	Suedia
Kryeqyteti	Stokholmi
Sipërfaqja (km <sup>2</sup> )	450.295
Numri i banorëve	10.223.000
Rregullimi	monarki
Gjuha zyrtare	suedishtja



### Diskutim interaktiv hyrës:

- Monumentet dhe vlerat kombëtare: toka e konifereve dhe e çelikut, Volvo, Skania... - Cilat janë paranjohuritë e tua?

**VEÇORITË NATYRORE** Suedia përfshin pjesën lindore dhe më të gjerë të **Gadishullit Skandinav**. Kufizohet me Norvegjinë në perëndim, Finlandën dhe Gjirin e Botnisë në lindje, kurse me Detin Baltik në jug. Brenda këtyre kufijve, Suedia zë një sipërfaqe prej 450,295 km<sup>2</sup>. Prandaj është vendi më i madh skandinav.



Parlamenti në Stokholm

Suedia ka pozitë të volitshme gjeografike, pasi del në detin Baltik, i cili hap rrugën e saj drejt Oqeanit Atlantik. Në jug, Suedia i afrohet Danimarkës dhe shërben si urë tokësore midis dy vendeve. Bregdetet e Suedisë nuk janë shumë të përthyer, por janë të pasur me gjire të vogla dhe ishuj të vegjël. Ishujt më të mëdhenj janë: **Gotland** dhe **Eland** në Detin Baltik.

**Relievi** dallohen malet e larta **Skandinave**, të cilat butësisht dhe gradualisht zbresin në lindje gjatë gjithë rrugës për në **Ultësirën Suedeze**. Ato janë të lakuara drejt Detit Baltik dhe kryqëzohen nga gryka të thella. Malet në Suedi janë të mbuluara me pyje të dendura halore prej pishave dhe bredhit. Pyjet mbulojnë rreth 60% të territorit të përgjithshëm të këtij vendi.



Gurët në Ale, Skania, Suedia Jugore

**Klima** është kontinentale, për shkak të Maleve Skandinave, të cilat e zvogëlojnë ndikimin e Atlantikut nga perëndimi. Vetëm rajonet jugore të Suedisë janë nën ndikimin e Oqeanit Atlantik dhe të Detit Baltik. Kjo është arsyeja pse ato kanë klimë më të ngrohtë dhe më të butë.

**Lumenjtë** janë të shpejtë, të pasur me potencial për hidrocentrale dhe derdhen në Detin Baltik. Vendi ka shumë liqene akullnajorë. Ndër më të mëdhenjtë janë: **Verner, Vetern** dhe **Melarn**.

**POPULLSIA DHE EKONOMIA** Sot në Suedi jetojnë mbi 10 milionë banorë, prej të cilëve deri në 85% në zonat urbane. Popullsia përbëhet kryesisht nga **suedeze** dhe një pakicë e **laponasve, finlandezëve** dhe emigrantë nga trevat e largëta. Rreth 60% e popullsisë i përket kishës protestante suedeze.

Kryeqyteti i shtetit është **Stokholmi**. Qytetet e tjera kryesore janë: **Goteborg, Malme, Kiruna** etj. Përveç **suedishtes**, përdoret edhe gjuha e **laponasve** nga grupi Ugro-finlandez. Suedia renditet në vendin e 16-të në botë sa i përket zhvillimit ekonomik. Për shkak të kushteve të mira ekonomike dhe sociale për jetesë, në dekadat e fundit Suedia ka qenë një vend tërheqës për migrantët nga Evropa dhe Azia.

**Pasuria minerale** përbëhet nga: hekuri, bakri, ari, plumbi, zinku, nikeli, mangani etj. Suedia është më e pasur me **xeherore hekuri** të pastër dhe cilësor. Ajo nxirret kryesisht në minierat afër qytetit Kiruna. Nga burimet e energjisë, rëndësi më të madhe ka potenciali hidroenergjik i lumenjve.

Suedia është vend bujqësor dhe industrial shumë i zhvilluar. Nga kulturat bujqësore, më shumë kultivohen: **gruri, elbi, patatet, tërshëra** dhe **panxhar sheqeri**. Megjithëse sipërfaqet nën këto kultura bujqësore nuk janë të mëdha, rendimentet janë shumë të larta. Suedia ka blegtori mjaft të zhvilluar. Rriten: **gjedhë, shqarrë** dhe **drerë**.

Grafiku 1: Përfaqësuesit e komuniteteve të lindur jashtë Suedisë




Tabela 1: Kompanitë e mëdha industriale në Suedi

Kompania	Dega
Volvo	automobilistike
Erikson	elektronike
Skania	automobilistike
Soni-Erikson	elektronike
Elektroluks	inxhinieri elektrike
IKEA	mobilje dhe dizajn
SKF	mekanike
N & M	tekstile

**Industria** është dega më e rëndësishme në këtë vend. Ajo u zhvillua në bazë të pasurisë minerale. Janë të zhvilluara: **industria metalike, mekanike, kimike, elektroteknike** dhe e **druarit**. Qendrat industriale janë: Stokholmi, Goteborgu, Malme dhe Kiruna. Suedia importon kultura kopshtare dhe fruta jugore, kurse eksporton xehe dhe makineri.

**NDARJA RAJONALE** Suedia dallohet me këto rajone natyrore-gjeografike: **rajoni verior, qendror dhe jugor**, ndërsa nga aspekti administrativ, Suedia është e ndarë në 21 rrethe.



Muret mesjetare në Vizbi, në ishullin Gotland



**Për njohuri të thelluara:**

- Venern është liqeni më i madh akullnajor në Suedi (5546 km<sup>2</sup>). Ai është i gjatë 108 km (si Shkup - Demir Kapi), dhe 40 km i gjerë. Thellësia arrin në 108 metra. Merr ujë nga tridhjetë degë. Liqeni ka rëndësi të madhe trafiku, pasi është i lidhur me Detin Baltik nga një sistem kanalesh.
- Universiteti më i vjetër në Evropën Veriore, i themeluar në vitin 1477, ndodhet në qytetin e Upsala, Suedi.
- Vlerat e njohura dhe tërheqëse për ta vizituar Suedinë:

Objekte natyrore	Vende turistike	Monumentet kulturore-historike	Qytete
Durgarden	Kalmar	Pallati mbretëror	Malme
Parku Abisko	Ape resort	Pallati i Drottingholm	Goteborg
Parku Sarek	Angelsberg	Muzeu Nobel	Upsala
Bregu i lartë	Lund	Muzeu ABA	Linqeping



**Për të kontrolluar njohuritë e fituara:**

- Cilët janë liqenet më të mëdha në Suedi?
- Cilat janë pasuritë natyrore të Suedisë?
- Cilat degë industriale zhvillohen në Suedi?



**Detyra me aplikimin e TIK-ut:**

- Me ndihmën e teknologjisë kompjuterike (Google Earth) gjeji dhe zbuloji emrat e pesë liqeneve më të mëdha në Suedi!
- Kërko dhe mëso se ku jetojnë mërgimtarët nga vendi ynë në Suedi?
- Kërko dhe mëso se si Suedia dhe Danimarka janë të lidhura me rrugë tokësore? - Paraqiti rezultatet në klasë!



# NORVEGJIA DHE FINLANDA



## Diskutim interaktiv hyrës:

- Monumentet dhe vlerat kombëtare: Vikingët, Laponia, fjordet... - Cilat janë paranjohuritë e tua?



## NORVEGJIA

**VEÇORITË NATYRORE** Norvegjia shtrihet në Evropën Veriore, në pjesën veriperëndimore të Gadishullit Skandinav. Kufizohet me Suedinë, Finlandën dhe Rusinë në lindje dhe verilindje, kurse në perëndim me Oqeanin Atlantik. Përveç pjesës gadishullore, Norvegjia ka edhe territore ishujsh. Sipërfaqja e përgjithshme është 385.203 km<sup>2</sup> dhe mbi 5 milionë banorë jetojnë në atë hapësirë. Norvegjia ka një nga **brigjet më të përthyera** në Evropë (20.000 km). Ajo përbëhet nga një numër gjiresh të ngushta - **fjorde** dhe mijëra ishujsh të vegjël larg bregdetit.

Specifikat **relievore** janë pjesët e rrafshuara - **fjeldat** e maleve të vjetra skandinave në brendësi të vendit.

**Klima** në pjesët më veriore është **subpolare**, në pjesët të brendshme **malore**, kurse përgjatë bregdetit që nuk ngrin, ndikimet e Atlantikut ndjehen me rrymën e Golfit.

**Lumenjtë** kanë rënie malore me **potencial të madh hidroenergetik**. Nga malet, përmes fjordeve, lumenjtë derdhen në Oqeanin Atlantik. Përveç kësaj, në Norvegji ka një numër liqenesh akullnajore.


### POPULLSIA DHE EKONOMIA

Popullsia përbëhet kryesisht nga **norvegjezët** (86%), një numër i vogël i **laponëve** dhe emigrantëve nga vendet e tjera (13%). Gjuha zyrtare është **norvegjishtja**. Rreth 70% e popullsisë i përket Kishës protestante norvegjeze.

Norvegjia është një nga vendet më të zhvilluara në botë, me standard të lartë jetese të popullatës. Zhvillimi ekonomik është për shkak të pasurisë së madhe natyrore: **hidrocentraleve, naftës, gazit natyror, hekurit, nikelit, titaniumit** dhe **xehëve** të tjera metalike. Madje 98% e energjisë elektrike vjen nga **hidrocentralet**. Kjo



Emri	Norvegjia
Kryeqyteti	Oslo
Sipërfaqja (km <sup>2</sup> )	385.203 (385.639)
Numri i banorëve	5.323.000
Rregullimi	monarki
Gjuha zyrtare	norvegjishtja



Fjordi

**Tabela 2:** Qytetet më të mëdha në Norvegji

Qyteti	Popullsia
Oslo	1.000.000
Bergen	255.000
Stavanger	222.000
Trondheim	183.000
Dramen	117.000



Oslo

ka mundësuar zhvillimin e **elektrometalurgjisë**. Norvegjia sot është eksportuesi i pestë më i madh i naftës në botë, e cila eksploatohet nga **platformat e naftës** në Detin e Veriut me rreth 3.500 puse. Aktiviteti tradicional është peshkimi. Norvegjia është eksportuesi i dytë më i madh i peshkut në botë.

**NDARJA RAJONALE** Norvegjia ka tre rajone natyrore-gjeografike: **bregdetin e Atlantikut**, **masivin skandinav** dhe **rajonin juglindor**. Sipas rregullimit administrativ ndahet në 18 rrethe.



## FINLANDA

**VEÇORITË NATYRORE** Finlanda ndodhet në **Gadishullin Finlandez**. Në jug dhe perëndim përmes **Gjirit Botnik** dhe **Gjirit të Finlandës** del në Detin Baltik.

**Relievi** i këtij vendi është kryesisht **ultësinor**, me një mesatare prej 400 metrash mbi nivelin e detit. Vetëm nga pjesa veriore arrijnë degët e Maleve Skandinave. Kjo është zona e **Finlandës së Lartë**. Në jug të saj shtrihet **Rajoni i Liqeneve**. I gjithë territori i kësaj zone është nën liqene dhe pyje.

**Klima** është kontinentale dhe subpolare. Dimrat janë të gjatë, të ashpër dhe të ftohtë. Dëbora zgjat nga nëntori deri në maj. Verat janë të shkurtra dhe të ftohta, me temperaturë mesatare prej 10 °C.

**Vendi i liqeneve** me mbi 60 mijë liqene, të cilat zënë 10% të territorit të shtetit. Liqenet janë të ndërlydhur me ishuj dhe kanale. Liqenet më të mëdha janë **Sajma** dhe **Inari**.


**POPULLSIA DHE EKONOMIA** Popullsia në shtet përbëhet nga: **finlandezët** (93%), **rusët**, **estonezët**, **suedezët** e të tjerë. Përveç finlandishtes, **suedishtja** dhe **laponishtja** përdoren si pjesë e grupit ugro-finlandez. Rreth 70% e popullsisë janë protestantë, anëtarë të Kishës luteriane ungjillore



<b>Emri</b>	Finlanda
<b>Kryeqyteti</b>	Helsinki
<b>Sipërfaqja (km<sup>2</sup>)</b>	338.424
<b>Numri i banorëve</b>	5.515.000
<b>Rregullimi</b>	republikë
<b>Gjuha zyrtare</b>	finlandishtja, suedishtja



Vendi i 1000 liqeneve



finlandeze. Sipas zhvillimit ekonomik dhe standardeve të jetesës, finlandezët janë në nivelin francez dhe gjerman.

**Pyjet** janë burimi më i madh natyror i Finlandës. Ato përfshijnë 77% të territorit të saj. Tajga finlandeze është e pasur me pisha, bre-dh, dëllinja dhe halorë të tjerë. Finlanda gjithashtu ka xehe: **bakri, hekuri, zinku, volframi, ari** etj.

Finlanda është vend industrial-bujqësor. Degët kryesore të industrisë janë: e **drurit, e ndërtimit të anijeve, e tekstilit** dhe **elektronika**. Finlanda eksporton: dru, letër, elektronikë dhe importon: drithëra dhe fruta jugore.

**NDARJA RAJONALE** Rajonet natyrore të Finlandës janë: **rajoni i Laponisë, liqeneve dhe bregdetare**. Administrativisht shteti është i ndarë në 19 rajone.

**Tabela 3:** Kompanitë e njohura industriale në Finlandë

Kompania	Dega
Nokia	elektronike
Nokian	pneumatike
Finlandia	ushqimore
Baltik Jahts	ndërtim anijesh
Neste	petrokimike



Helsinki

**Për njohuri të thelluara:**

- Ishujt Lofot në Detin Norvegjez janë territoret më të mëdha të peshkimit në Norvegji. Qindra anije-fabrika janë të stacionuara në rrethinë për të përpunuar peshkun e kapur, kryesisht bakalar.
- Në kepin Nordkap në Norvegji, dielli nuk perëndon nga mesi i majit deri në fund të korrikut.
- Finlanda njihet si vendi me sistemin arsimor më efikas në Evropë.
- Vlerat e njohura dhe tërheqëse për t'u vizituar në Norvegji dhe Finlandë:


Objekte natyrore	Vende turistike	Monumentet kulturore-historike	Qytete
Parku Saltfjel	Lilehamer	Kisha Hedal	Oslo
Nordkap	Stavanger	Kisha Urnes	Kristiansand
Ishujt Lofot	Karasjok	Pallati mbretëror	Tromze
Fjord Geranger	Alta	Katedralja Oslo	Narvik
Parku Lemenjoki (Fin.)	Fshati i Baba Dimrit (Fin.)	Katedralja Helsinki (Fin.)	Turku (Finlandë)
Ishujt Alande (Finlandë)	Porvo (Finlandë)	Katedralja Uspenski (Fin.)	Tampere (Finlandë)

**Për të kontrolluar njohuritë e fituara:**

- Çfarë burimesh natyrore kanë Norvegjia dhe Finlanda?
- Çfarë lloj industrie kanë të zhvilluar norvegjezët dhe finlandezët?
- Çfarë malli eksportojnë Norvegjia dhe Finlanda?

**Detyra me aplikimin e TIK-ut:**

- Vëzhgoji fjordet e Norvegjisë! - Sa është gjatësia e fjardeve më të thella midis tyre?
- Kërko dhe mëso më shumë rreth paraqitjes së "Aurora borealis" në Laponi! - Hap diskutim dhe jep shpjegim në orë!



# DANIMARKA DHE ISLANDA



## Diskutim interaktiv hyrës:

- Monumentet dhe vlerat kombëtare: Legoland, Hans K. Andersen, Laki... - Cilat janë paranjohuritë e tua?



## DANIMARKA

**VEÇORITË NATYRORE** Danimarka është vend gadishullor dhe ishullor. Shtrihet në gadishullin **Jiland** dhe në 500 ishuj. Më të mëdhenjtë prej tyre janë: **Zeland**, **Leland** dhe **Fin**. Danimarka zë një sipërfaqe prej 42.933 km<sup>2</sup> dhe në atë sipërfaqe jetojnë mbi 5 milionë banorë. Përveç pjesën kontinentale, Danimarka ka edhe territore të ndara - (Grenland dhe Ishujt Faroe).

Danimarka ka pozitë të volitshme gjeografike. Ajo paraqet "urë" midis Gadishullit Skandinav dhe Evropës Qendrore. Përveç kësaj, ngushticat **Skagerak** dhe **Kategat** janë "derë e hapur" midis Baltikut dhe Detit të Veriut.


Danimarka është vend **ultësinor**. Ajo është nga vendet më të rrafshëta në Evropë. Pika më e lartë është 173 metra mbi nivelin e detit.

**Klima** në Danimarkë është **atlantike**. Dimrat janë të butë, të lagësht dhe me mjegull dhe verat janë mesatarisht të ngrohta.

**Pasuritë ujore** përbëhen nga lumenj të shkurtër, me rrjedhë të plotë dhe disa liqene të vegjël akullnajorë.

**POPULLSIA DHE EKO-NOMIA** Popullsia përbëhet nga **danezët** (87%). Ata i përkasin grupit gjerman të

<b>Emri</b>	Danimarka
<b>Kryeqyteti</b>	Kopenhaga
<b>Sipërfaqja (km<sup>2</sup>)</b>	42.933
<b>Numri i banorëve</b>	5.806.000
<b>Rregullimi</b>	monarki
<b>Gjuha zyrtare</b>	danishtja




Ura Eresund është urë e kombinuar rrugore hekurudhore me dy korsi dhe rrugë me katër korsi që e pret ngushticën Eresund. Ura në të vërtetë është kombinim i një ure dhe një tunel që i lidh qytetet: Kopenhagë në Danimarkë dhe Malme në Suedi. Ura është një nga më të gjatat në botë.



popujve. Përveç tyre, ka gjermanë dhe emigrantë nga Azia dhe Ballkani. Gjuha zyrtare është **danishtja**, nga grupi gjerman, por në territore të ndara përdoren gjuha faroishte dhe grenlandishte. Rreth 75% e popullsisë i përket Kishës daneze protestante. Sipas rregullimit të saj shoqëror, Danimarka është **mbretëri**. Kryeqyteti i vendit është **Kopenhaga**.

Danimarka është vend bujqësor-industrial shumë i zhvilluar me **blegtori të specializuar**. Bujqësia mbështetet në sipërfaqe të mëdha të tokës së punueshme dhe një shkallë të lartë mekanizimi. **Bimët blegtorale** mbillen kryesisht për nevoja të bagëtisë, e cila e çon Danimarkën drejt një prodhuesi kryesor të qumështit dhe produkteve të mishit.

**Grafiku 3:** Bartësit e ekonomisë në Danimarkë



**Industria** sjell 15% të të ardhurave vjetore në ekonomi. Danimarka është e orientuar drejt prodhimit të **produkteve ushqimore**, ndërtimin e: **mullinjeve të erës, makinave, ilaçeve dhe pajisjeve mjekësore**.

**NDARJA RAJONALE**, Danimarka është e ndarë në tërësitë natyrore-gjeografike: **atlantike** dhe **baltike**. Administrativisht është e ndarë në 5 rajone.



**Tabela 4:** Rajonet në Danimarkë

Rajoni	Qyteti më i madh
Kryesor	Kopenhaga
Qendror	Aarhusi
Verior	Aalborgu
Zeland	Roskilde
Jugor	Odenze



Kopenhaga



# ISLANDA

**VEÇORITË NATYRORE** Islanda është shtet ishullor në Oqeanin Atlantik. Ishulli i Islandës është me origjinë vullkanike. Si pasojë e vullkaneve (**Laki, Hekla**, etj.), sot në Islandë ka shumë: **gejzere** dhe **burimet termike**. Islanda gjithashtu ka zona të mëdha nën akull, duke mbuluar rreth 11% të sipërfaqes së vendit. Prandaj e quajnë **tokë akulli** dhe **zjarri**. Për shkak të origjinës vullkanike, toka është shkëmbore dhe me zhavorr, me shumë pak tokë të punueshme (1%). Maja më e lartë ngrihet në 2119 metra.



**Klima** e Islandës është bregdetare. Ka dimra të butë dhe vera të freskëta. Në viset e larta klima kalon në subpolare.

## POPULLSIA DHE EKONOMIA

Vikingët e zbuluan dhe e banuan ishullin e Islandës qysh në vitin 870. Sot popullsia përbëhet nga **islandezët** (86%) dhe emigrantët nga vende të tjera. Gjuha zyrtare është **islandishtja**, si pjesë e grupit gjerman. Rreth 67% e popullsisë janë **protestantë**, anëtarë të Kishës luterane ungjillore islandeze.

**Sektori i energjisë** bazohet në pasurinë **gjeotermale** dhe **hidro-energjetike** nga lumenjtë, pa përdorimin e karburanteve fosile, duke e bërë atë vendin më miqësor ndaj mjedisit në botë, me **indeksin më të ulët të ndotjes**.

<b>Emri</b>	Islanda
<b>Kryeqyteti</b>	Rejkjavik
<b>Sipërfaqja (km<sup>2</sup>)</b>	102.775
<b>Numri i banorëve</b>	357.000
<b>Rregullimi</b>	republikë
<b>Gjuha zyrtare</b>	islandishtja



Detifos, ujëvara më e fuqishme në Evropë, që ndodhet në Islandën Verilindore



Rejkjavik

**Bujqësia**, falë energjisë së rinovueshme nga **gejzerët**, është e orientuar drejt kultivimit të serave të **patateve** dhe **kulturave kopshtare**.

Nga **degët industriale** Islanda është një nga vendet më të zhvilluara industriale. Përpunon peshk të konservuar, si dhe vaj peshku dhe miell. E dyta për nga rëndësia është industria e tekstitit dhe prodhimi i pajisjeve kompjuterike.



Gejzeri

**Ndarja administrative e Islandës**



**NDARJA RAJONALE** Islanda është e ndarë administrativisht në 6 territore përbërëse.

**Për njohuri të thelluara:**

- Në territoret e veçanta dhe autonome daneze përfshihen Ishujt Faroe (1.399 km<sup>2</sup>) dhe ishulli më i madh në botë - Grenlanda (2.175.000 km<sup>2</sup>), i cili në mënyrë natyrore-geografike i përket kontinentit të Amerikës Veriore.
- Gejzeri është fjalë e vjetër islandeze që do të thotë "burim i nxehtë". Gejzerët në mënyrë ritmike e hedhin ujin e nxehtë në currilë deri në 70 metra lartësi. Energjia e tyre termike përdoret në bujqësi dhe ngrohje shtëpiake në Islandë.
- Vlerat e njohura dhe tërheqëse për të vizituar në Danimarkë dhe Islandë:



Objekte natyrore	Vende turistike	Monumentet kulturore-historike	Qytete
Limfjord	Ishulli Anholt	Shtëpia e H.K. Andersenit	Odense
Parku Rold	Parku i drerëve	Pallati mbretëror	Helsingør
Ishuj në Katagat	Viborg	Galeria, Kopenhagë	Kopenhagë
Laguna blu (Islandë)	Parku Tingvellir (Islandë)	Muzeu kombëtar (Islandë)	Reykjavik (Islandë)
Rrethi i artë (Islandë)	Parku Skaftafel (Islandë)	Muzeu Saga (Islandë)	Selfos (Islandë)



**Për të kontrolluar njohuritë e fituara:**

- Cilët janë ishujt më të mëdhenj danezë?
- Si është klima në Danimarkë dhe Islandë?
- Cilën industri e zhvilluan danezët dhe islandezët?



**Detyra me aplikimin e TIK-ut:**

- Kërko dhe mëso se cila është lidhja e trafikut midis vendeve të Evropës Veriore? A ka ndonjë lidhje tokësore midis ndonjërit prej tyre?
- Përdor mjetin e duhur në (Google Map) për të zbuluar distancën e Islandës nga vendet fqinje më të afërta evropiane!

*Konceptet kryesore:*

- *Shteti;*
- *Republika;*
- *Monarkia;*
- *Alpet;*
- *Klima alpine;*
- *Klima kontinentale;*
- *Rrjeti lumor;*
- *Rrjeti i kanalit.*






# TEMA VI: VEÇORITË GJEOGRAFIKE TË EVROPËS QENDRORE

EVROPA QENDRORE .....	106
GJERMANIA.....	106
POLONIA .....	109
ÇEKIA DHE SLLOVAKIA .....	111
ZVICRA DHE AUSTRIA.....	115
HUNGARIA.....	119
RUMANIA .....	121

**Kalaja Hohenvergen u ndërtua në shekullin XI-të. Ndodhet 40 km në jug të Salzburgut afër qytetit Verfen në Austri. Kalaja është e rrethuar nga Alpet Berhtesgaden.**

# EVROPA QENDRORE



## GJERMANIA

<b>Emri</b>	Gjermania
<b>Kryeqyteti</b>	Berlin
<b>Sipërfaqja (km<sup>2</sup>)</b>	357.386
<b>Numri i banorëve</b>	83.000.000
<b>Rregullimi</b>	republikë federale
<b>Gjuha zyrtare</b>	gjermanishtja



### Diskutim interaktiv hyrës:

- Monumentet dhe vlerat kombëtare: Bundestag, Reni, Mercedes... - Cilat janë paranjohuritë e tua?

**VEÇORITË NATYRORE** Republika Federale e Gjermanisë përfshin zonën e Evropës Qendrore, nga **Alpet** në jug deri në **Detin Baltik** dhe **Detin e Veriut** në veri. Kufizohet me Poloninë dhe Çekinë në lindje, me Austrinë dhe Zvicrën në jug, kurse me Francën dhe vendet e Beneluksit në perëndim. Brenda këtyre kufijve, Gjermania zë një sipërfaqe prej 357.386 km<sup>2</sup>. Me këtë sipërfaqe, është **shteti më i madh** në Evropën Qendrore.

Gjermania ka një pozitë të volitshme gjeografike, sepse ka dalje në dy dete: Detin Baltik dhe Detin e Veriut. Nga këto, Deti i Veriut ka një rëndësi më të madhe ekonomike dhe transportuese, pasi ai kurrë nuk ngrin dhe e lidh Gjermaninë me Oqeanin Atlantik. Me gërmimet e **Kanalit Kilit** u shkurtua rruga e ujërave midis Detit të Veriut dhe Detit Baltik. Kjo e përmirësoi më tej pozitën gjeografike të këtij vendi.

**Përthyerja bregdetare** është shumë e fragmentuar. **Bregdeti verior** i Gjermanisë është dukshëm i ulët dhe i fragmentuar nga disa gjire dhe esture në grykëderdhjet e lumenjve. Në afërsi të bregdetit janë **Ishujt Frizianë**.



Shvarevaldi

**Relievi** në Gjermania përbëhet nga tri tërësi natyrore: Gjermania Veriore, Qendrore dhe Jugore. **Gjermania Veriore** përfshin **Ultësirën e Gjermanisë së Veriut**. **Gjermania Qendrore** përfshin malet e vjetra, të rrafshuara: **Harc, Mali Turingia, Ajfel** etj. **Gjermania Jugore** përfshin zonën në jug të lumit **Majna**. Këtu shtrihen malet e larta: **Alpet e Bavarisë** dhe **Rrafshnalta e Bavarisë**. Në perëndim të tyre është **Shfarcvald**, poshtë të cilit rrjedh lumi Danub.




Lumi Reni

**Klima** është nën ndikim mesatar nga Atlantiku në veri dhe perëndim, ndërsa në jug dhe në lindje ajo është **kontinentale** me dimra më të ashpër.

**Lumenjtë** në Gjermani u përkasin tri pellgjeve ujëmbledhëse, edhe atë: **Detit të Veriut, Detit Baltik** dhe **Detit të Zi**. Lumenjtë që derdhen në Detin e Veriut janë: **Reni, Elba (Laba), Odra, Vezër, Ems** etj. Ata janë të lundrueshëm dhe kanë grykëderdhje më të gjerë - **estaure**. Ata janë të lidhura nga kanale lundrimi më të gjatë se 300 km, duke formuar një **rrjet kanalesh lumore** të degëzuar dhe të lundrueshëm. Në Detin e Zi ujërat gjermanë barten nga lumi **Danub**.

**POPULLSIA DHE EKONOMIA** Gjermania ka një popullsi prej 83 milionë banorësh. Shkalla e urbanizimit është e lartë. Konurbacioni më i madh i qyteteve të bashkuara është midis Rurit dhe Renit: **Diseldorf-Këln-Bon-Dortmund-Esen-Duisburg-Bohum**. Popullsia është kryesisht **gjermane** (80%), **emigrantë evropianë** (12%) dhe **imi-grantë jo-evropianë** (8%), kryesisht turq. **Gjermanishtja** është gjuha zyrtare. Rreth 60% e popullsisë i përket Kishës protestante. Qendra kryesore administrative e vendit është **Berlini**.

Grafiku 1: Përbërja etnike në Gjermani



**Industria** është shtylla kryesore e ekonomisë, duke siguruar 30% të të ardhurave vjetore. Zhvillimi industrial në të kaluarën u mundësua nga rezervat e pasura me: **qymyr, mineral hekuri, kripëra kaliumi, uranium**, etj. Në Gjermani të gjitha industritë janë zhvilluar, por industritë udhëheqëse janë: **metalurgjia** (shkrirja e metaleve), **mekanike** (vegla makinerish), **automobilistike, kimike, farmaceutike** dhe **inxhinieri elektrike** dhe **elektronike**. Rajonet industriale janë **Rur** dhe **Sar**. Gjermania është prodhuesi dhe eksportuesi më i madh i automobilave midis vendeve evropiane.

Tabela 1: Firmat më të mëdha industriale dhe brendet e automobilave në Gjermani

Kompania	Dega	Kompanitë e automobilave
Volkswagen (VW)	automobilistike	Volkswagen
Daimler	automobilistike	Audi
BASF	kimike	Porsche
Siemens	elektrike	Opel
BMW	automobilistike	Ford
Bosch	inxhinieri metalike	Mercedes
Bayer	farmaceutike	BMW
Thyssen Krupp	metalike	Smart
Continental	Pneumatike	MAN (kamionë)
Henkel	kimike	Neoplan (autobusë)

**Degët bujqësore** janë shumë të zhvilluara, megjithëse ato sjellin vetëm 1.2% të të ardhurave. Gjermania prodhon: grurë, panxhar sheqeri, patate, qumësht, produkte qumështi dhe mishi.

**Turizmi** në Gjermani po bëhet një industri gjithnjë më e rëndësishme, veçanërisht në Alpet Bavareze. Qendra më e njohur turistike është **Garmish-Partenkirhen**.

Gjermania ka rrjet trafiku mjaft të zhvilluar nga: autostradat, hekurudhat, rrugët ujore, etj. Ajo eksporton: makina, automobila, pajisje shtëpiake, pajisje për mekanikë precize etj, kurse importon produkte bujqësore, vaj, pemë jugore, perime etj.

**NDARJA RAJONALE** Gjermania është federatë e 16 shteteve (republika-ve), të cilat janë të ndara në 439 rrethe.



Garmish-Partenkirchen

**Për njohuri të thelluara:**

- Në qytetin Ulm në Danub, ekziston katedralja gotike me kamberin më të lartë në Evropë dhe në botë (162 metra).
- Kanali i Gjermanisë së Mesme është arteria më e gjatë ujore në brendësi në Gjermani (321 km) e cila me rrugë ujore i lidh vendet nga rajone të ndryshme të Evropës (perëndimore me atë të mesme).
- Në dekadën e fundit, Gjermania ka prodhuar mesatarisht 5,5 milionë automobila në vit.
- Vlerat e njohura dhe tërheqëse për vizitë në Gjermani:

Objekte natyrore	Vende turistike	Monumentet kulturore-historike	Qytete
Alpet	Aahen	Porta e Brandenburgut	Berlin
Liçeni i Bodenit	Obersdorf	Rajhstag, ndërtesa	Hamburg
Pyll i zi	Baden Baden	Nojshvanshtajn, kështjellë	Mynih
Parku Jasmund	Garmish-Partenkirhen	Katedralja, Kolonj	Shtutgart
Mali i Hertzit	Hajdelberg	Katedralja, Berlin	Frankfurt

**Për të kontrolluar njohuritë e fituara:**

- Si është pozita gjeografike e Gjermanisë?
- Cilat janë rajonet industriale në Gjermani?
- Cilat degë industriale zhvillohen në Gjermani?

**Detyra me aplikimin e TIK-ut:**


- Përdore teknologjinë kompjuterike (Google Map) për të gjetur qytetet më të mëdha të porteve në Gjermani në Detin e Veriut dhe Detin Baltik!
- Mëso se si Gjermania është e lidhur me vendet e Evropës Lindore dhe Jugore përmes lidhjeve ujore? Cilat kanale lumore janë më të rëndësishme?
- Bëj mini-projekt (Power Point) me fotografi dhe të dhëna themelore në lidhje me republikat federale të Gjermanisë! (detyra është e përshtatshme për punë në çifte ose grupe).

# POLONIA



## Diskutim interaktiv hyrës:

- Monumentet dhe vlerat kombëtare: Zakopane, Gdanjsk, Varshavë... - Cilat janë paranjohuritë e tua?



**VEÇORITË NATYRORE** Polonia kufizohet në veri me Detin Baltik dhe Rusinë, në lindje me Lituaninë, Bjellorusinë dhe Ukrainën, në jug me Sllovakinë dhe Çekinë, kurse në perëndim me Gjermaninë. Brenda këtyre kufijve ajo zë një sipërfaqe prej 312.696 km<sup>2</sup> dhe në këtë territor jetojnë mbi 38 milionë banorë.

**Popiza gjeografike** është e volitshme, sepse ka dalje në Detin Baltik, i cili e lidh atë me Detin e Veriut dhe Detin e Norvegjisë, e prej andej me Oqeanin Atlantik.

**Relievi** në Poloni kryesisht është ultësinor. Në gjysmën jugore, **Vizioni Polak** dallohet me pikën më të lartë **Lisa Gora** (611 metra). Në rajonet kufitare jugore drejt Çekisë dhe Sllovakisë, toka është malore. Këtu shtrihen **Sudetet** dhe **Karpatet**. Maja më e lartë është e vendosur në një kurorë karpate - **Tatra** (2499).

**Klima** në Poloni është mesatare në perëndim dhe veri, për shkak të ndikimit të Detit Baltik, kurse në lindje dhe jug ajo shndërrohet në **kontinentale** dhe **malore**.

**Lumenjtë** në Poloni janë: të lundrueshëm, të rrjedhshëm dhe i përkasin zonës së pellgut të Baltikut. Ata ngrijnë në dimër. Më të mëdhenjtë janë: **Visla, Varta, Odra** dhe **Bug**. Liqenet janë kryesisht me origjinë akullnajore.

## POPULLSIA DHE EKONOMIA

Popullsia e Polonisë përbëhet nga:


**polakë** (97%), të cilët i përkasin grupit sllav të popujve, pakicës **gjermane, ukrainase, bjelloruse** etj. Feja kryesore është katolike ajo përfshin 87% të popullsisë së përgjithshme. Problemet demografike në Poloni janë shpërndarja jo e barabartë e popullsisë dhe rënia e madhe e popullsisë që ndodhi pas Luftës së Dytë Botërore dhe pas pranimet në Bashkimin Evropian. Kryeqyteti i shtetit është **Varshava**. Përveç tij, qytete më të mëdha janë: **Krakovi, Katovicë, Vroclav** dhe **Logj**. Qytetet- porte janë: **Shçeçin, Gdanjsk** dhe **Gdinja**.

**Bujqësia** zë rreth 4% të të ardhurave. Polonia është prodhuesi kryesor i **patates** dhe **thekrës** në Evropë dhe në botë. Kulturat e tjera të kultivuara janë: panxhari i sheqerit dhe vajit, meli, etj.

**Burimet energjetike** të Polonisë bazohen në: **qymyr** dhe rezerva më të vogla të **naftës** dhe **gazit**. Kohët e fundit, burimet e energjisë së rinovueshme - mullinjtë e erës - janë ndërtuar intensivisht. Në Poloni, industria është shumë më e rëndësishme sesa bujqësia. Nga degët industriale u zhvillua **metalurgjia** (Katovicë dhe Krakov), **industria e makinerive** (Vroclav), **tekstilit** (Logj) etj. Polonia është prodhues

<b>Emri</b>	Polonia
<b>Kryeqyteti</b>	Varshava
<b>Sipërfaqja (km<sup>2</sup>)</b>	312.696
<b>Numri i banorëve</b>	38.440.000
<b>Rregullimi</b>	republikë
<b>Gjuha zyrtare</b>	polonishtja

**Grafiku 2:** Lëvizja e numrit të popullsisë (në miliona, ndërmjet viteve 1900-2010)




i njohur evropian i: automjeteve hekurudhore, autobusëve, pajisjeve ushtarake, makinerive bujqësore dhe të minierave.

**Turizmi** në Poloni është në zhvillim edhe atë në pjesën jugore, ku ndodhen **Sudetet** dhe **Karpatet**. Qendra më e njohur turistike në Poloni është **Zakopane**. Në tregtinë e jashtme, Polonia tregton kryesisht me vendet e Evropës Lindore dhe Perëndimore. Importon: produktet bujqësore, fruta të Evropës Jugore dhe Qendrore, si dhe lëndë të para për industrinë e saj, kurse eksporton: qymyr, makineri dhe pajisje shtëpiake.

**NDARJA RAJONALE** Në Poloni, ekzistojnë 4 rajone gjeografike natyrore: lugina bregdetare, e ulët, lugina subkarpatische dhe rrafshnalta dhe lugina karpate-sudete. Administrativisht ndahet në 16 provinca.

**Tabela 2:** Pesë qytetet më të mëdha në Poloni

Qyteti	Popullsia
Varshavë	1.770.000
Krakov	770.000
Logj	690.000
Vroclav	640.000
Poznanj	538.000



Varshava

**Për njohuri të thelluara:**

- Popullsia dhe ekonomia e Polonisë u prekën rëndë nga Lufta e Dytë Botërore, kur vendi humbi 6 milionë njerëz.
- Në qytetin turistik Frombork, jetoi dhe veproi shkencëtari i madh i Rilindjes Nikolla Kopernik.
- Polonia ka miratuar një plan kombëtar afatgjatë për të shtuar sipërfaqet e pyllëzuara që do të zvogëlojnë ndotjen e ajrit në vend. Ajo përfshin 30% të territorit me: pishë, lis, ah, mëshsteknë dhe specie të tjera.
- Vlerat e njohura dhe tërheqëse për të vizituar Poloninë:

Objekte natyrore	Vende turistike	Monumentet kulturore-historike	Qytete
Mali Tatra	Zakopane	Malbork, kështjellë	Çestohtova
Liqeni Masturian	Frombork	Qyteti i vjetër, Krakov	Poznanj
Parku Slovinski	Varshavë	Qyteti i vjetër, Gdanjsk	Logj
Malet Sudete	Krakov	Qyteti i vjetër, Torun	Vroclav

**Për të kontrolluar njohuritë e fituara:**

- Cilat janë vendet fqinje të Polonisë?
- Përshkruaji karakteristikat e popullsisë në Poloni?
- Çfarë prodhimesh eksporton Polonia?

Google

**Detyra me aplikimin e TIK-ut:**

- Me ndihmën e teknologjisë kompjuterike (Google Earth/Google Map) gjeji dhe zbuloji emrat e pesë liqeneve më të mëdha në Poloni!
- Hulumto më shumë mbi termin kriptodepresion dhe a ka ndonjë liqen të tillë në Poloni? - Paraqiti rezultatet në klasë!

# ÇEKIA DHE SLLOVAKIA



## Diskutim interaktiv hyrës:

- Monumentet dhe vlerat kombëtare: Bohe-mia, Praga, Shkoda... - Cilat janë paranjohuritë e tua?



## ÇEKIA


**VEÇORITË NATYRORE** Çekia është shtet i pavarur, i cili u pavarësua në vitin 1992 me ndarjen e Republikës Çekosllovaqe në dy shtete të reja sovraane: **Çekia** dhe **Sllovakia**. Kufizohet nga Polonia në veri, Sllovakia në lindje, Austria në jug dhe Gjermania në perëndim. Brenda këtyre kufijve, Çekia zë një sipërfaqe prej 78.866 km<sup>2</sup> dhe mbi 10 milionë njerëz jetojnë në atë hapësirë.

**Relievi**, Çekia ndahet në dy tërësi natyrore: **Moravia** në lindje dhe **Rrafshnalta Çeke** në perëndim.

**Moravia** është e rrethuar nga tri anë me male: **Jesenik** në veri, **Karpatet e Bardha** dhe **Javornik** në lindje dhe **Malet Çeke-Moraviane** në perëndim.



**Rrafshnalta Çeke** është e rrethuar nga të gjitha anët me male: në veri me **Sudetet** (Krkoshitet), në jug, **Shumava**, në lindje, **Malet Çeke-Moraviane** dhe në perëndim me **Malet xeherore**. Maja më e lartë është **Sneska** e Sudeteve (1603).

**Klima** në Çeki është **e mesme -kontinentale** dhe **kontinentale**. Malet në kufi të këtij vendi e mbrojnë atë nga depërtimi i klimës së lagësht dhe të ftohtë nga veriu dhe lindja. Karakteri kontinental shihet në ndryshimin e madh ndërmjet minimumit të dimrit (-42.2 °C) dhe maksimumit të verës (40.4 °C) i matur në vend, i cili është mbi 82 gradë.



<b>Emri</b>	Çekia
<b>Kryeqyteti</b>	Praga
<b>Sipërfaqja (km<sup>2</sup>)</b>	78.866
<b>Numri i banorëve</b>	10.610.000
<b>Rregullimi</b>	republikë
<b>Gjuha zyrtare</b>	çekishtja

Llojet e klimës në Çeki



Praga


**Lumenjtë** nga Rrafshnalta Çeke gjatë rrjedhës kryesore, **Labá** me degën **Věltava**, përfundojnë në Detin e Veriut. Lumi **Morava** rrjedh nëpër Moravi, e cila, si një degë e Danubit, përfundon në Detin e Zi.

**POPULLSIA DHE EKONOMIA** Popullsia në Çeki është shumë homogjene, edhe atë: **çekët** (94%), **moravianët** (4%), **slovakët** (1%), **polakët** (0,5%) dhe **gjermanët**. Popullsia çeke është më pak religjioze në Evropë. Rreth 80% e tyre e deklaruan veten si ateistë ose pa përkatësi fetare. Vetëm 10% janë deklaruar si katolikë. Kryeqyteti i shtetit është **Praga**. Ajo është qendra kulturore dhe industriale e Çekisë.

**Tabela 3:** Gjigandët në industrinë e makinerisë çeke

Kompania	Dega
Shkoda	makina, tramvaje
Tatra	kamionë
AVIA	kamionë
Irisbus	autobusë
Aero Vodočodí	avionë
Fluturimi Kuhovice	avionë
Zetor	traktorë
Java	motoçikleta

Karlovi Vari – qendër e njohur banje dhe qytet në Çeki. Ndodhet në lumenjtë Ogzhe dhe Tepla, rreth 130 km në perëndim të Pragës. Është emëruar sipas perandorit të shenjtë romak Karli IV-të i Luksemburgut, i cili e themeloi qytetin në vitin 1370. Është i njohur për burimet e tij të nxehta (13 të mëdha dhe rreth 300 më të vogla, dhe lumit të nxehtë Tepla).



Karlovi Vari

**Pasuritë natyrore** të **pyjeve**, **kullotave** dhe **mineraleve** (qymyri prej guri dhe kafe, hekuri, grafiti, uranumi, ari, argjendi, plumbi, etj.) mundësuan zhvillimin e shpejtë ekonomik, veçanërisht pas pavarësisë.

Nga kulturat bujqësore, më të kultivuara janë: panxhar sheqeri, patatet, gruri, elbi, liri, kërpi etj.

Sot, Çekia furnizon madje 30% të energjisë së saj përmes centraleve bërthamore, me industrinë që udhëheq rrugën me deri në 37% të të ardhurave vjetore. Qendrat kryesore të metalurgjisë, **industrisë mekanike** dhe **kimike** janë: **Kladno, Usti, Bërno, Moravska Ostrava, Pëlzen** (qendra më e madhe e birrës në botë) e të tjera.

**Turizmi** është më i zhvilluar në banjat: Karlovi Vari, Marianske Laznje, Jahimov etj.

**NDARJA RAJONALE** Rajonet natyrore dhe tradicionale të Çekisë janë: **Bohemia, Moravia** dhe **Shlezia**. Në mënyrë administrative, vendi është i ndarë në 13 provinca.



Bërno



Bërno është qyteti i dytë më i madh në Çeki. Ai u themelua në vitin 1243, megjithëse ajo zonë ishte e banuar në shekullin e 5-të. Sot Bërno ka 403.304 banorë dhe është selia e Gjykatës Kushtetuese të Çekisë, Gjykatës Supreme, Gjykatës Supreme Administrative, Prokurorit Publik të Shtetit dhe Avokatit të Popullit.





# SLLOVAKIA

**VEÇORITË NATYRORE** Sllovakia është vend mesjetar dhe nëndanubian që kufizohet: në lindje me Ukrainën, në veri me Poloninë, në jug me Hungarinë dhe në perëndim me Austrinë dhe Çekinë. Këta kufij përfshijnë një sipërfaqe prej 49.035 km<sup>2</sup> dhe në atë hapësirë jetojnë rreth 5.5 milionë banorë.

**Relievi** i Sllovakisë është kryesisht **malor**. Malet mbulojnë 75% të territorit të saj, kurse ultësirat 25%.

**Malet** e plotësojnë pjesën veriore të Sllovakisë. Këto janë Karpatet me vargmalet: **Tatrat** (2655), **Fatri, Malet Xehetare dhe Beskidet**. Karpatet janë të pasura me pyje (38%), kullota (10%), liqene akullnajash dhe xehesh.

**Ultësirat** e Sllovakisë janë të vendosura në jug dhe juglindje. Këto janë degët veriore të Ultësirës së Panonisë.

Nga **relievi karstik**, Sllovakia veçohet me **2.400 shpella**, pesë prej të cilave janë nën mbrojtjen e UNESCO-s.

**Klima** në Sllovaki është kontinentale dhe malore.

**Lumenjtë** më të rëndësishëm në Sllovaki janë **Danubi dhe Vllah**. Danubi është rrugë e rëndësishme dhe "portë" për në Evropë, kurse Vllah përdoret për hidrocentralet.



<b>Emri</b>	Sllovakia
<b>Kryeqyteti</b>	Bratisllava
<b>Sipërfaqja (km<sup>2</sup>)</b>	49.035
<b>Numri i banorëve</b>	5.445.000
<b>Rregullimi</b>	republikë
<b>Gjuha zyrtare</b>	sllovakishtja

Harta topografike e Sllovakisë (75% reliev malor)



Shpella akullnajore e Dobshinës

### Shpella nën mbrojtjen e UNESCO-s

- Shpella akullnajore e Dobshinës
- Shpella Domika
- Shpella Gombasek
- Shpella Jasovska
- Shpella Oktinska Aragonite

**POPULLSIA DHE EKONOMIA** Popullsia e Sllovakisë përbëhet kryesisht nga: **sllovakët** (80%), **hungarezët** (9%), **romët** (3%), **çekët** dhe **rusët**. Gjuha zyrtare është sllovakishtja, por hungarishtja përdoret gjithashtu nga pakica hungareze. Shumica e popullsisë është **katolike** (62%), protestante (9%), ortodokse (1%), etj. Kryeqyteti i Sllovakisë është **Bratisllava**. Është një qytet i vjetër dhe një port i rëndësishëm në Danub.

**Nevojat energjetike**, Sllovakia i plotëson nevojat e saj për energji kryesisht nga **energjia bërthamore** (54%), termocentralet (18%) dhe hidrocentralet (15%). Minierat më të zakonshme janë: ari, argjendi, bakri, hekuri, nikeli, antimoni, mangani, grafiti e shumë të tjera. Reputacioni i vendit,

ekonomikisht i prapambetur, Sllovakia, në dekadën e fundit ka ndryshuar në epitetin "Tigri tatar". Këtë e arriti për shkak të rritjes së shpejtë vjetore, falë sektorit industrial dhe investimeve të huaja të tërhequra. Përveç metalurgjisë, Sllovakia është një qendër evropiane e **industrisë së automobilave**. Mbi 1 milionë automobila (Volkswagen, Audi, Porsche, Peugeot, Citroen, Kia, Jaguar) prodhohen çdo vit për markat e huaja.

**Turizmi** po rritet vazhdimisht. Mbi 5 milionë turistë i vizitojnë vendpushimet për skijim, kështjellat mesjetare dhe shpellat.

**NDARJA RAJONALE** Rajonet natyrore të Sllovakisë janë **malore** dhe **ultësinore**. Administrativisht vendi është i ndarë në 8 pjesë.



Bratisllava

#### Për njohuri të thelluara:

- Çekia krenohet me 12 vende të mbrojtura nga UNESCO. Sidoqoftë, vizitat më të mëdha turistike tërhiqen nga festivalet e mëdha të birrës në: Pëlzen dhe Çeske Budejovice, që zgjasin 17 ditë.
- Çekia nuk ka arritur ende popullsinë prej 10,7 milionë që nga viti 1930. Arsyeja për këtë është emigrimi i 2,87 milionë gjermanëve sudetë pas Luftës së Dytë Botërore dhe emigrimi i çekëve gjatë viteve të krizës, para fillimit të shekullit XX-të.
- Bratisllava konsiderohet "perla" e Danubit dhe "dera e hapur" e miqësisë dhe mikpritjes për të gjithë popujt dhe vendet.
- Vlerat e njohura dhe tërheqëse për ta vizituar Çekinë dhe Sllovakinë:

Objekte natyrore	Vende turistike	Monumentet kulturore-historike	Qytete
Moravski Krsh	Karlovi Vari	Oborri mbretëror, Krumlov	Pragë
Parajsa çeke	Pëlzen	Kutna Hora	Bërno
Propast Makoça	Kromerizh	Telç	Çeske Budejovice
Sllovake Krsh (Sllovaki)	Shtërpske Pleso (Sllovaki)	Kalaja Bojnice (Sllovaki)	Koshice (Sllovaki)
Parku Tatra (Sllovaki)	Trencin (Sllovaki)	Qendra, Bardejov (Sllovaki)	Preshov (Sllovaki)

#### Për të kontrolluar njohuritë e fituara:

- Cilët janë lumenjtë kryesor në Çeki dhe Sllovaki?
- Cilat industri zhvillohen në Çeki dhe Sllovaki?
- Çfarë vizitojnë më shumë turistët në Çeki dhe Sllovaki?

Google

#### Detyra me aplikimin e TIK-ut:

- Kërko, hulumto dhe prezanto pamjet e qytetit të Pragës!
- Hulumto dhe bëj një projekt për prezantim në orë (Power Point) me album dhe të dhëna themelore mbi vlerat natyrore të parqeve ose shpellave kombëtare në Sllovaki! (Detyra është e përshtatshme për të punuar në çifte).

# ZVICRA DHE AUSTRIA



## Diskutim interaktiv hyrës:

- Monumentet dhe vlerat kombëtare: Alpet, Nestle, Roleks, Mocart, Shtraus... - Cilat janë paranjohuritë e tua?



## ZVICRA

**VEÇORITË NATYRORE** Zvicra është vend i Evropës Qendrore dhe **Alpine**. Zvicra kufizohet me Gjermaninë në veri, Austrinë në lindje, Italinë në jug dhe Francën në perëndim. Brenda këtyre kufijve ajo zë një sipërfaqe prej 41.285 km<sup>2</sup> dhe në të jetojnë mbi 8.5 milionë banorë.

**Relievi** është malor, me një lartësi mesatare prej 1370 metrash. Në të ka tri njësi: **Alpet** në jug, **Jura** në veri dhe në veriperëndim dhe **Rrafshnalta Zvicerane** midis tyre. Alpet ngrihen me më shumë maja mbi 4000 metra. Më i larti është Monte Roza (4.640). Ato janë pjesërisht të mbuluara me akullnaja, por në disa vende janë të prera nga luginat akullnajore dhe mbikalimet.

**Klima** kryesisht është **kontinentale**, në pjesën e den-  
dur me popullsi, ndërsa në Alpe është malore dhe subpolare, mbi vijën e akullit të përhershëm (2800 metra).




Liçeni i Gjenevës



<b>Emri</b>	Zvicra
<b>Kryeqyteti</b>	Bern
<b>Sipërfaqja (km<sup>2</sup>)</b>	41.285
<b>Numri i banorëve</b>	8.508.000
<b>Rregullimi</b>	republikë federale
<b>Gjuha zyrtare</b>	gjermanishtja, italishtja, frëngjishtja, retromanishtja



Harta topografike e Zvicrës



■ Kontinentale  
■ Mesatare-kontinentale.  
■ Malore  
 Llojet e klimës në Zvicër

**Pasuria ujore** është në liqenet piktoreske me origjinë akullnaje: liqeni i **Gjenevës, Bodenit, Cyrihut** etj. Lumenjtë janë: malorë, të shpejtë dhe përdoren për hidroenergji. Më të mëdhenjtë janë: **Reni, Rona** dhe **In**.

**POPULLSIA DHE EKONOMIA** Një komb, dy fe dhe katër gjuhë. Zvicra është një **vend kozmopolit** me katër gjuhë zyrtare, të përdorura tradicionalisht nga katër popuj të barabartë (**gjermanë, francezë, italianë dhe retromanë**), si dhe një numër i madh i imigrantëve evropianë (serbë, turq, spanjollë, portugezë, shqiptarë etj.). Te përkatësia fetare, më të shumtët janë: **katolikët** (37%), **protestantët** (kalvinistë, ungjillorë, luterianë, 25%), **ortodoksët** (2%) e të tjerë. Sipas kushteve financiare dhe mjedisore, popullsia e Zvicrës është në krye të Evropës dhe botës. Zvicra është **selia bankare botërore**, për shkak të asnjansisë së saj tradicionale ushtarake, sistemit të qëndrueshëm politik dhe ligjor.

**Industria** është aktiviteti kryesor, duke siguruar mbi 25% të të ardhurave. Ajo mbështetet nga energjia relativisht e lirë, e cila kryesisht merret nga hidrocentralet dhe më pak nga termocentralet bërthamore. Degët kryesore janë: **kimike, ushqimore, mekanike dhe elektroteknike**. Zvicra është udhëheqëse botërore në industrinë e mekanikës precize (orë, peshore, instrumente matëse).

**Turizmi** është një aktivitet i vjetër dhe fitimprurës, të cilin Zvicra nuk e zgjeron me vetëdije për shkak të ruajtjes së cilësisë së mjedisit. Qendrat më të njohura turistike janë: **Sen Moris, Davos, Lucern, Vengen** etj.

**NDARJA RAJONALE** Rajonet natyrore të Zvicrës janë: **Alpet, Jura dhe Rrafshnalta Zvicerane**. Sipas rendit shtetëror, Zvicra është republikë federale - konfederatë, e përbërë nga 26 shtete (kantone).

Sen Moris është qytet dhe destinacion turistik në Zvicrën lindore. I takon kantonit të Graubinden, ku është një nga vendbanimet më të mëdha. Sen Moris është qendër turistike me famë botërore, ku mblidhet "xhet-set" botëror. Sen Moris është unik në atë që është qyteti më i lartë në Evropë - ndodhet në 1.822 metra mbi nivelin e detit.



**Tabela 4:** Gjigantët në industrinë zvicerane

Kompania	Dega
Nestle	ushqyese
Novartis	farmaceutike
Roshe	farmaceutike
ABB	inxhinieri elektrike
Sika	kimike
Svoç	orëpunuese
Roleks	orëpunuese
Lind	ushqyese



Berna



Sen Moris



# AUSTRIA

**VEÇORITË NATYRORE** Austria është vend i Evropës Qendrore, Alpeve dhe Danubit. Në veri kufizohet me Gjermaninë dhe Çekinë, në lindje me Sllovakinë dhe Hungarinë, në jug me Slloveninë dhe Italinë, ndërsa në perëndim me Zvicrën. Brenda këtyre kufijve, Austria zë një sipërfaqe prej 83.879 km<sup>2</sup> dhe në atë sipërfaqe jetojnë mbi 8.5 milionë banorë. Kryeqyteti është **Vjena**.

**Relievi** është malor (66%). **Alpet** shtrihen në të gjithë vendin në tre kreshta paralele, me majën më të lartë **Grosglokner** (3797). Në veri dhe lindje janë ultësirat periferike të Rrafshit të Panonisë.



Grosglokner

<b>Emri</b>	Austria
<b>Kryeqyteti</b>	Vjena
<b>Sipërfaqja (km<sup>2</sup>)</b>	83.879
<b>Numri i banorëve</b>	8.857.000
<b>Rregullimi</b>	republikë federale
<b>Gjuha zyrtare</b>	austriakishtja-gjermanishtja

**Klima** është **kontinentale** në viset e ulëta alpine dhe **malore** në Alpe, me: dimra të gjatë, të ftohtë dhe me dëborë.


**Rrjeti i lumenjve** më së shumti i përket pellgut të Detit të Zi: **Danub, In, Ens, Drava, Mura** etj.

**POPULLSIA DHE EKONOMIA** Popullsia është më e përqendruar në ultësira. **Austriakë** janë 85%. Komunitete të shumta minoritare janë: **gjermanët, turqit, boshnjakët, serbët** etj. Gjuha zyrtare është austriakishtja-gjermanishtja. Rreth 57% e popullsisë e deklaruan veten **katolikë**. Austria dhe kryeqyteti Vjenë kanë lënë shenjë të pashlyshme në kulturën evropiane, veçanërisht në historinë e muzikës, si qendër e komponimit muzikor në shekujt 18 dhe 19.



Harta topografike e Austrisë

Grafiku 3: Struktura fetare në Austri



**Burimet natyrore** nga: livadhet, kullotat dhe pyjet, mundësojnë zhvillimin e **blegto-risë** dhe **pylltarisë**. **Pasuria minerale** e: xehereve të hekurit, kripës së gurit, grafit, volfram e të tjerë, mundësuan zhvillimin e: **metaleve, mekanike, automobilave, kimi-ke, ushqimit, tekstilit, industrisë së drurit** e të tjera.

**Turizmi** sjell 9% të të ardhurave vjetore. Austria vizitohet nga mbi 20 milionë turistë në vit në qendrat e dimrit dhe ato kulturore: **Insbruk, Salzburg, Vjenë, Kicbil, Grac** etj.

**NDARJA RAJONALE** Rajone natyrore të Austrisë janë **Alpet** dhe **ultësi- rat periferike**. Sipas rregullimit të shtetit, Austria është republikë federale e përbërë nga 9 shtete.



Salzburgu

**Për njohuri të thelluara:**

- Zvicra është vend i shumë organizatave botërore. Ruajtja e mjedisit është përparësi. Deri në 90% e transportit të mallrave bëhet përmes trafikut hekurudhor, i cili është plotësisht i elektrizuar. Trenat në Zvicër ngjiten në shpatet malore mbi 3.000 metra.
- Austria e sotme u formua në vitin 1918, gjatë shpërbërjes së Monarkisë Austro-Hungareze, e cila përfshinte zona të mëdha të Evropës Qendrore, Lindore dhe Jugore.
- Vjena është "perla" e Danubit dhe qendra e muzikës klasike evropiane. Veprat e kompozitorëve të mëdhenj u krijuan dhe u interpretuan atje: Hajdn, Shtraus, List, Shubert, Mocart etj.
- Vlerat e njohura dhe tërheqëse për ta vizituar Zvicrën dhe Austrinë:



Objekte natyrore	Vende turistike	Monumentet kulturore-historike	Qytete
Aleç	Kalaja Çilon	Kalaja Çilon	Cyrih
Materhorn	Sen Moris	Brunsvik	Lucern
Liçeni Lugano	Cermat	Solothurn, qendër	Gjenevë
Liçeni Holshtat (Austri)	Insbruk (Austri)	Shenbrun (Austri)	Vjenë (Austri)
Grosglokner (Austri)	Kicbil (Austri)	Qendra, Salzburg (Austri)	Grac (Austri)

**Për të kontrolluar njohuritë e fituara:**

- Cilat janë majat më të larta malore në Zvicër dhe Austri?
- Cilët janë lumenjtë dhe liqenet kryesorë në Zvicër dhe Austri?
- Cili lloj turizmi është më i zhvilluar në Zvicër dhe Austri?



**Detyra me aplikimin e TIK-ut:**

- Kërko, hulumto dhe prezanto pamjet e qytetit të Vjenës!
- Me përdorim të një mjeti (Google Earth) përcakto lartësinë e liqeneve më të mëdha akullnajorë në Zvicër dhe bëje një listë të të dhënave të marra, si dhe qytetet që gjenden në brigjet e tyre!






# HUNGARIA



### Diskutim interaktiv hyrës:

- Monumentet dhe vlerat kombëtare: Çardash, Budapest, Balaton, gilash... - Cilat janë paranjohuritë e tua?



**VEÇORITË NATYRORE** Hungaria është vend kontinental i vendosur në Danubin e Mesëm. Hungaria kufizohet me Sllovakinë dhe Ukrainën në veri, Serbinë dhe Kroacinë në jug, Rumaninë në lindje, kurse në perëndim me Austrinë dhe Slloveninë. Brenda këtyre kufijve, Hungaria zë një sipërfaqe prej 93.030 km<sup>2</sup> dhe në të jetojnë 9,8 milionë banorë. Rrugë të rëndësishme ndërkombëtare që lidhin Hungarinë me vendet e Evropës Veriore dhe Jugore kalojnë nëpër territorin e Hungarisë. Lumi Danub, i cili e lidh atë me të gjitha vendet e Danubit si rrugë ujore, ka një rëndësi të madhe për të.


**Relievi** është kryesisht ultësitor (95%). Hungaria zë pjesën më të madhe të Ultësirës së Panonisë. Ka pak male në Hungari. Malet i përkasin grupit të maleve të ulëta dhe maleve mesatare për nga lartësia. Këto janë: **Matra** me majën Kekesh (1015) dhe **Buk** (959) në pjesën veriore, kurse **Bakonjska Gora** (713) dhe **Meçek** (683) në jugperëndim të Danubit.

**Klima** në Hungari është **kontinentale**. Dimrat janë të ftohtë dhe me shi, kurse verat janë të thata dhe të nxehta. Reshjet bien nga 450 në 900 mm në vit dhe klimës i japin karakter **kontinental-stepor**.

**Lumenjtë** më të rëndësishëm në Hungari janë **Danubi** dhe **Tisa**. Ata janë të lundrueshëm dhe ujërat e tyre përdoren për trafik, ujitje dhe nevoja industriale. Më i madhi nga liqenet është **Balaton**.

**POPULLSIA DHE EKONOMIA** Popullsia e Hungarisë përbëhet nga **hungarezët** (84%). Ata janë popull që ndryshon nga fqinjët e tyre në origjinë, gjuhë hungareze dhe tipare të tjera kombëtare. Ata i përkasin **racës së verdhë**, respektivisht janë me origjinë **mongole**. Popujt e pakicave janë: romë, gjermanë, rumunë, sllovakë, kroatë e të tjerë. Kryeqyteti i shtetit është **Budapesti**. Me përkatësi fetare janë të ndarë si: katolikë (37%), protestantë, 13% (kalvinistë dhe luterianë), hebrenjë, budistë dhe myslimanë.

Grafiku 4: Shpopullimi në Hungari



■ kontinentale  
■ kontinentale e thatë  
■ stepore (e thatë)

Llojet e klimës në Hungari

**Problemi demografik** në Hungari është shtimi vjetor i ulët i popullsisë, pas Luftës së Dytë Botërore, e cila ka qenë negative për tri dekadat e fundit. Kjo do të thotë se popullsia po zvogëlohet. Pjesëmarrja e popullatës së re po zvogëlohet gjithashtu, kurse pjesa e popullsisë së vjetër po rritet.

**Toka e punueshme** nga lavërtaria dhe kopshtet është burimi më i madh natyror, që mbulon rreth 50% të territorit

të Hungarisë. Fondi i përgjithshëm bujqësor, së bashku me livadhet, kullotat, pemishtet dhe vreshtat, mbulon mbi 65% të territorit.

**Lavërtaria** është e orientuar në: misër, grurë, patate, luledielli, panxhar sheqeri, duhan etj. Derrtaria dhe shpendëtaria janë degët kryesore të blegtorisë.

**Industria** bazohet në përpunimin e lëndëve të para bujqësore dhe minerale shtëpiake: **boksit, mangan, hekur dhe naftë**. Degët kryesore janë: metalurgjia, mekanika, elektroteknika, kimia, tekstili dhe industria ushqimore. Hungaria është një prodhues i njohur i: autobusëve, makinerive bujqësore (traktorëve, kombajnave, etj.), gomave, pajisjeve elektrike, kimikateve, produkteve ushqimore. Hungaria është eksportues i madh rajonal i pajisjeve elektrike në Evropën Qendrore dhe Lindore: televizorë, matës elektrikë, çelësa elektrikë, telefona celularë dhe kompjuterë.

**Turizmi** është me ndikim në ekonominë hungareze. Mbi 15 milionë turistë e vizitojnë çdo vit: Liqenin Balaton, Budapestin dhe parqet kombëtare.

**NDARJA RAJONALE** Hungaria është e ndarë në mënyrë administrative në 19 rrethe shtetërore dhe qytetin e Budapestit si njësi e veçantë.

**Tabela 5:** Pesë qytetet më të mëdha në Hungari

Qyteti	Popullsia
Budapesti	1.757.000
Debrecin	204.000
Segedini	162.000
Mishkolci	160.000
Peçuj	146.000



Budapesti

**Për njohuri të thelluara:**

- Liqeni Balaton ka statusin e një "deti hungarez". Ai është i gjatë 77 km, kurse sipërfaqja sillet 592 km<sup>2</sup>. Thellësia është relativisht e vogël, rreth 3 metra. Në verë, temperatura e ujit tejkalon 25 °C, gjë që e bën atë shumë tërheqës për shumë turistë.
- Hekurdha e elektrizuar nëntokësore e qytetit - metro, në Budapest është më e vjetra në Evropën kontinentale. Daton nga viti 1896.
- Vallja popullore tradicionale hungareze është Çardash, kurse specialiteti i kuzhinës është gullashi.
- Vlerat e njohura dhe tërheqëse për ta vizituar Hungarinë:

Objekte natyrore	Vende turistike	Monumentet kulturore-historike	Qytete
Liqeni Balaton	Budapesti	Qyteti i vjetër, Peçuj	Debrecin
Aktel Park	Eger	Pallati mbretëror	Peçuj
Mali Buk	Tihani	Banja Çaçar	Gjer

**Për të kontrolluar njohuritë e fituara:**

- Përshkruaj çfarë burimesh natyrore ka Hungaria?
- Cilët janë lumenjtë më të rëndësishëm që rrjedhin në Hungari?
- Cilat industri zhvillohen në Hungari?



**Detyra me aplikimin e TIK-ut:**

- Përcaktoji koordinatat gjeografike të Budapestit dhe llogarite ndryshimin në shkallët këndore të gjerësisë në krahasim me Shkupin!
- Bëje një mini-projekt (Power Point) me fotografi dhe të dhëna themelore për pamjet kulturore dhe historike të qytetit të Budapestit (detyra është e përshtatshme për punë në çifte ose grupe)!



# RUMANIA



## Diskutim interaktiv hyrës:

- Monumentet dhe vlerat kombëtare: Dakia, Bukureshti, grofi Drakulla... - Cilat janë paranjo-huritë e tua?

**VEÇORITË NATYRORE** Rumania përfshin pjesën jug-lindore të Evropës Qendrore. Është vend: karpatik, danubian dhe bregdetar. Në veri kufizohet me Ukrainën, në jug me Bullgarinë, në lindje me Moldavinë dhe Detin e Zi, kurse në perëndim me Hungarinë dhe Serbinë. Brenda këtyre kufijve, Rumania zë një sipërfaqe prej 238,397 km<sup>2</sup>. Më shumë se 19 milionë njerëz jetojnë në këtë territor. Rumania ka pozitë të volitshme gjeografike, sepse lumi **Danub** rrjedh nëpër të dhe ka dalje në **Detin e Zi**. Ajo është udhëkryq midis Evropës Qendrore, Jugore dhe Lindore.

**Relievi** në Rumani ka tri tërësi natyrore: male, rrafshnalta dhe ultësira.

**Malet** e plotësojnë pjesën e Rumaninë qendrore. Këto janë: **Karpatet**, të cilat shtrihen në formën e një harku nga veriu në jugperëndim. Ato janë male me kurora të reja me maja të mprehta dhe jo të rumbullakëta. Në pjesën jugore ato quhen **Karpatet Jugore** (Alpet e Transilvanisë) në të cilat ka qafa malore, të favorshme për ndërtimin e rrugëve.


**Rrafshnalta** në Rumani ndodhet në perëndim të Karpateve. Kjo është **Transilvania** (Erdeli). Transilvania kufizohet me male të ulëta xeherore, të cilat kryqëzohen nga luginat.

**Ultësirat** në Rumani shtrihen në jug, lindje dhe perëndim. Këto janë: **Ultësira e**


**Vllahisë, Moldavisë, Ultësira e Panonisë** dhe **Dobruxa Veriore**. **Ultësira e Vllahisë** shtrihet nga ultësira e Alpeve Transilvaniane në veri deri në Danubin në jug. Rajoni i **Moldavisë** shtrihet në lindje nga Karpatet deri në lumin Prut. **Ultësira e Panonisë** me pjesët e saja lindore ka depërtuar në pjesët perëndimore të Rumanisë. **Dobruxa Veriore** mbulon pjesën juglindore të Rumanisë. Ndodhet midis Danubit, Detit të Zi dhe Bullgarisë.

**Klima** në Rumani kryesisht është kontinentale. Vetëm në disa vise (Moldavi, Banat) ajo ka karakter kalimtar të **klimës kontinentale-stepore**.

**Lumenjtë** në Rumani i përkasin pellgut të Detit të Zi. Lumi Danub ka rëndësinë më të madhe të trafikut dhe hidroenergjisë. Degët e saj janë: **Tisa, Samosh, Muresh, Prut, Olta** dhe **Seret**.



<b>Emri</b>	Rumania
<b>Kryeqyteti</b>	Bukureshti
<b>Sipërfaqja (km<sup>2</sup>)</b>	238.397
<b>Numri i banorëve</b>	19.638.000
<b>Rregullimi</b>	republikë
<b>Gjuha zyrtare</b>	rumunishtja



Harta topografike e Rumanisë



Rashnov

Rashnov qytet në Qarkun Brashov gjendet në Rumaninë qendrore të provincës historike të Transilvanisë. Sipas regjistrimit të fundit, kishte 15.456 banorë.


Rashnov ndodhet në rajonin e njohur turistik në Karpitet Rumune. Menjëherë sipër qytetit është kështjella me të njëjtin emër - Rashnov. Në jug gjendet kështjella e njohur Bran dhe vendpushimet e njohura për skijim: Pojana Brashov dhe Predeal.

**POPULLSIA DHE EKONOMIA** Popullsia e Rumanisë përfaqësohet nga **rumunët** (89%), që i përkasin grupit roman të popujve. Popujt e pakicave janë: hungarezët (6%), romët (3,3%), ukrainasit, gjermanët e të tjerë. Gjuha zyrtare është rumunishtja, kurse në mënyrë fetare përcaktohen si: **ortodoks** (81%), **katolik** (4%), **protestant** (6%) e të tjerë.

**Problemi demografik** në Rumani është shtimi negativ vjetor i popullsisë. Nga viti 1990, popullsia filloi të bjerë. Shtimi natyror në dekadën e fundit është -2.6 ‰ (përmijë) në vit, përkatësisht shkalla e vdekshmërisë (mortalitetit) është më e lartë se shkalla e lindshmërisë (natalitetit). Kjo, duke folur në mënyrë numerike, do të thotë se vendi humb rreth 50,000 banorë në vit.

**Toka e punëshme** nga arat dhe kopshtet përfshin 40% më tepër të territorit të Rumanisë, që është më se e mjaftueshme për kultivimin e **drithërave** (grurit, misrit, elbit), **kulturave industriale** (lulediellit, duhanit, panxhar sheqerit), **frutave të Evropës Qendrore** dhe **hardhisë**.

**Grafiku 5:** Shpopullimi në Rumani



**Tabela 6:** Pesë qytetet më të mëdha në Rumani

Qyteti	Popullsia
Bukureshti	1.883.000
Kluzh Napoka	324.000
Temishvari	320.000
Jashi	290.000
Konstanca	284.000



Bukureshti

**Industria** prej kohësh ka qenë e varur nga lëndët e para vendore: nafta, qymyri dhe gazi natyror. Prandaj, industria më e zhvilluar është **industria petrokimike**, qendrat kryesore të së cilës janë: **Ploeshti, Brazi, Krajova, Konstanca** etj. Përveç tyre, janë të zhvilluara: **industria mekanike, përpunimi i metaleve, tekstili dhe industria ushqimore**. Ato janë të vendosura në qytetet: Arad, Bukuresht, Brashov, Temishvar etj. Rumania është prodhues dhe eksportues i njohur i automobila-ve dhe autobusëve (Dacia, Ford, Roman). Industria dhe bujqësia përbëjnë 49% të të ardhurave vjetore, përkundrajt shërbimeve (51%).

**Turizmi** është me ndikim në ekonomi me 9 milionë turistë në vit. Më të vizituarat janë qendrat bregdetare (Mamaja), vendpushimet dimërore dhe mesjetare dhe kështjellat e qyteteve.

**NDARJA RAJONALE** Rajonet natyrore në Rumani janë: rajoni i Panonisë, Transilvanisë, Karpateve, Vllahisë, Moldavisë dhe Dobruxhës. Rumania është e ndarë në 41 rrethe shtetërore dhe qytetin e Bukureshtit si njësi e veçantë.



**Për njohuri të thelluara:**

- Bukureshti është seli e vendosur në Ultësirën e Vllahisë. Është qytet i bukur, i pastër, i gjelbër i pasur me ndërtesa kulturore dhe historike. Më të theksuara janë: Ateniumi, Muzeu Kombëtar i Historisë, Kalaja Tepesh, Pallati Parlamentar etj.
- Gryka e Gjerdapit, që do të thotë “porta e hekurit” në Danub, është më e gjata në Evropë (100 km). Këtu janë ndërtuar diga dhe dy hidrocentrale për nevojat energjetike të Serbisë dhe Rumanisë. Për krahasim, prodhimi vjetor i energjisë në centralet e Gjerdapit tejkalon nevojat tona (maqedonase) për tri herë.
- Vlerat e njohura dhe tërheqëse për ta vizituar Rumaninë:

Objekte natyrore	Vende turistike	Monumentet kulturore-historike	Qytete
Delta e Danubit	Konstancë	Kalaja Korvin	Bukureshti
Karpatet Lindore	Sibiu	Kalaja Drakulla	Brashova
Parku Retezat	Manastiri Voronet	Kalaja Pelesh	Kluzhi
Gryka e Gjerdapit	Alba Julia	Pallati Parlamentar	Plojeshti
Sfinga, Brasov	Pojana Brashov	Mauzoleumi Marashesti	Temishvari



**Për të kontrolluar njohuritë e fituara:**

- Cilat male dhe ultësira e përbëjnë relievin e Rumanisë?
- Cilët janë lumenjtë më të rëndësishëm në Rumani?
- Çfarë pasuri natyrore ka Rumania?



**Detyra me aplikimin e TIK-ut:**

- Kërko, hulumto dhe bëje një raport të shkurtër për Parkun Kombëtar “Delta e Danubit”!
- Bëje një mini-projekt (Power Point) me fotografi dhe të dhëna themelore për një temë sipas dëshirës tënde: kështjella, parqe kombëtare ose fusha të naftës në Rumani! (detyra është e përshtatshme për punë në çifte ose grupe).

*Konceptet kryesore:*

- *Klima kontinentale;*
- *Klima polare;*
- *Klima subpolare;*
- *Makie;*
- *Shelgu polar;*
- *Mështekna polare;*
- *Depresioni;*
- *Dhelpra polare.*

**Trakaj është kështjellë ishullore e vendosur në Trakaj, në Lituani në liqenin Galve. Është ndërtuar kah fundi i shekullit XIV-të dhe fillimi i shekullit XV-të.**



# TEMA VII: VEÇORITË GJEOGRAFIKE TË EVROPËS LINDORE

EVROPA LINDORE.....	126
RUSIA.....	126
UKRAINA .....	129
BJELLORUSIA DHE MOLDAVIA.....	132
LETONIA, ESTONIA DHE LITUANIA.....	135

# EVROPA LINDORE

- 1 ESTONIA
- 2 LETONIA
- 3 LITUANIA
- 4 MOLDAVIA



## RUSIA



### Diskutim interaktiv hyrës:

- Monumentet dhe vlerat kombëtare: Kremlin, Bolshoj, Ermitazh... - Cilat janë paranjohuritë e tua?

<b>Emri</b>	Rusia
<b>Kryeqyteti</b>	Moska
<b>Sipërfaqja (km<sup>2</sup>)</b>	17.125.191
<b>Numri i banorëve</b>	146.793.000
<b>Rregullimi</b>	republikë federale
<b>Gjuha zyrtare</b>	rusishtja

**VEÇORITË NATYRORE** Rusia është vendi më i madh në Evropë dhe në botë, i cili shtrihet në dy kontinente: Evropë dhe Azi. Në drejtim paralel, ajo shtrihet nga Deti Baltik dhe Deti i Zi në perëndim, Oqeani i Qetë në lindje, në një gjatësi prej 10.000 km. Në veri dhe lindje, ajo del në Oqeanin e Ngrirë të Veriut (Arktik) dhe Oqeanin e Qetë. Rusia ka kufij tokësorë në jug dhe perëndim. Kufizohet në tokë me 14 vende. Gjerësia e Rusisë në drejtimin meridional, nga kufiri verior deri në jug, është mbi 5.000 km. Brenda këtyre kufijve ajo zë një sipërfaqe prej mbi 17 milionë km<sup>2</sup>. Rusia nuk ka pozitë të volitshme gjeografike, përkundër faktit se ajo ka hyrje në tre oqeanë dhe 12 dete bregdetare. Vija bregdetare tejkalon 37.000 km. Ndahet në disa ishuj, gadishuj dhe gjire, por në pjesën më të madhe të dimrit, uji ngrin.

Në **relievin** e Rusisë mbizotërojnë shumë ultësira. Ato mbulojnë tërë gjysmën evropiane dhe perëndimore të Azisë. **Ultësira e Evropës Lindore** në pjesën evropiane të Rusisë shtrihet nga Deti Baltik në perëndim deri në malet Ural në lindje. Ka lartësi të ulta (**pllajë**), të cilat nuk janë më të



Moska

larta se 400 metra. Në lindje të malit Ural shtrihet **Ultësira e Siberisë Perëndimore**, deri në lumin Jenisei. Në lindje të këtij lumi, drejt Oqeanit të Qetë, shtrihet **Siberia Lindore** me: **Malet Jabllanovë** dhe **Stanovoj**.

**Klimatikisht**, Rusia shtrihet në dy breza të nxehtësisë: **brezin e mesëm** dhe **të ftohtë**. Territoret në veri të shkallës 66° gj.gj.v. hyjnë në brezin e ftohtë. Këtu haset klima **polare** dhe **subpolare**. Bashkësi bimore më e përhapur në zonën klimatike subpolare është **tundra**. Ajo është bashkësi e: **myshqeve, bimëve të lulëzuara, shelgut polar** dhe **mështeknës polare**. Në jug të tyre shtrihet brezi i butë. Ka disa lloje të klimave: **kontinentale, mesatarisht kontinentale, stepore-shkretëtinore, malore** dhe **subtropikale**, rreth Detit të Zi.

**Pasuria ujore** përbëhet nga **mbi 150 mijë lumenj dhe 250.000 liqene**. Lumenjtë u përkasin disa pellgjeve ujëmbledhëse. Lumenjtë më të gjatë derdhen në **pellgun e Oqeanit të Ngrirë të Veriut, ata janë: Dvina Veriore, Peçora, Ob, Jenisej, Lena** etj. Këta lumenj kanë kapacitet të madh hidroenergjetik. Në **Liqenin Kaspik** derdhen **Volga** dhe **Urali**, kurse në **Detin Azov** lumi **Don**. Lumenjtë në Rusi janë: të gjatë, të thellë dhe të lundrueshëm. Diga me liqene të mëdha artificiale dhe hidrocentrale janë ndërtuar në pjesën më të madhe të tyre. Lumenjtë janë të ndërlidhur me **kanale të lundrueshme**. Ka shumë liqene në Rusi. Numri i tyre është mbi 250.000. Më i madhi prej tyre është **Liqeni Kaspik**, kurse më i thelli është **Liqeni i Bajkalit**. Baseni i Liqenit Kaspik është **depression** i madh, sepse ndodhet 28 metra nën sipërfaqen e "detit botëror".

**POPULLSIA DHE EKONOMIA** Në Rusi jetojnë mbi 146 milionë banorë. Shumica janë **rusë** (82%), pjesëtarë të grupit të popujve sllavë. Përveç rusëve, ka 130 popuj të tjerë të pakicave në përbërjen etnike: **tatarë, ukrainas, armenë** dhe popuj nga grupet mongole dhe kaukaziane. Shumica përcaktohen si: **ortodoksë** (43%), popullsia myslimane (6,5%) dhe ateistë (38%), etj. Rusia është një vend me dendësi të rrallë të popullimit, 9 banorë në një kilometër katrorë (9 b/km<sup>2</sup>). Kryeqyteti i vendit është **Moska**. Problemi demografik në Rusi është të shtimi vjetor i ulët, i cili disa vite është negativ, si dhe mospërputhjet e mëdha në përbërjen gjinore. Përkatësisht, popullsia e gjinisë femërore është 20 milionë më shumë se popullata e gjinisë mashkullore, kryesisht si pasojë e Luftës së Dytë Botërore.

**Degët bujqësore** zhvillohen në pjesën evropiane. Nga kulturat bujqësore



Liqeni Kaspik



Llojet e klimës në Rusi

Grafiku 1: Renditja e ekonomisë në Rusi




Tabela 1: Kompanitë e mëdha industriale në Rusi

Kompania	Dega	Selia
Gazprom	petrokimike	Moska
Lukoil	petrokimike	Moska
Euro Hem	kimike	Moska
AvtoVAZ	automobilistike	Tolati
GAZ Grup	automobilistike	Nizhni Novgorod
Kamaz	automobilistike	Naberezhnie Çelni
Rusal	miniera dhe metalurgji	Moska
Evraz	miniera dhe metalurgji	Moska
Severstal	miniera dhe metalurgji	Moska
Metalinvest	miniera dhe metalurgji	Moska

kryesisht kultivohen: gruri, misri, panxhari i sheqerit, duhani, luledielli, hardhia, etj. Një pjesë të madhe të aktiviteteve parësore përfshin peshkimi.

Rusia gjendet në pesë vendet e para më të zhvilluara evropiane. Parakushtet për këtë janë burimet e mëdha natyrore **nga burimet e energjisë dhe xeheroret**. Mëse 80% e eksporteve ruse përfshinë: naftë, gaz, metale dhe dru. Rusia konsiderohet prodhuesi kryesor botëror i: **naftës, gazit, hekurit, arit, platinës, aluminit, argjendit, zinkut, diamanteve** etj. Kështu, në



Liçeni i Bajkalit

Rusi janë të zhvilluara të gjitha degët industriale: metalike, mekanike, kimike, elektroteknike, petrokimike, e tekstilit, drurit e të tjera. Qendrat kryesore industriale janë: **Moska, Shën Peterburgu, Arhangelski, Gorki, Volgograd, Rostovi** etj.

**Turizmi** në Rusi zhvillohet me shpejtësi vitet e fundit. Kushtet më të favorshme për këtë industri sigurohen nga brigjet e Detit të Zi. Këtu janë të zhvilluara qendrat më të rëndësishme turistike.

**NDARJA RAJONALE** Rajonet natyrore të Rusisë janë: Ultësira e Evropës Lindore, Ultësira Siberiane-Perëndimore, Rrafshnalta Qendrore Siberiane, Siberia Lindore, Lindja e Largët, Rajoni i Bajkalit, Azia Qendrore dhe Kaukazi. Rusia përbëhet nga 8 rrethe federale për menaxhim më të lehtë. Njësitë përbërëse të Federatës Ruse gjithsej janë 85 njësi federale.

**Për njohuri të thelluara:**

- Rusia ka 15 qytete milionëshe. Pesë të parët janë: Moska, Shën Peterburgu, Novosibirski, Ekaterinburgu dhe Nizhni Novgorodi.
- Hekurudha është lloji i trafikut të përdorur më tepër në Rusi. Rrjeti i përgjithshëm hekurudhor është 85.000 km. Linja më e gjatë nga Moska në Vladivostok është 9.259 km.
- Liçeni i Bajkalit është baseni i vetëm i ujërave të ëmbla në botë i banuar me foka.
- Vlerat e njohura dhe tërheqëse për vizitë në Rusi

Objekte natyrore	Vende turistike	Monumentet kulturore-historike	Qytete
Liçeni i Bajkalit	Soçi	Muzeu Hermitazh	Nizhni Novgorod
Kamçatka	Shën Peterburg	Teatri Bolshoj	Volgograd
Bregdeti i Detit të Zi	Moska	Sheshi i Kuq	Vladivostok
Urali	Kazan	Shën Isaku, Katedrale	Irkutsk
Altaj	Ekaterinburg	Teatri Marinski	Smolensk

**Për të kontrolluar njohuritë e fituara:**

- Cilët janë lumenjtë dhe liqenet më të mëdha në Rusi?
- Me cilat burime energjetike dhe minerale është e pasur Rusia?
- Cilat industri zhvillohen në Rusi?

**Detyra me aplikimin e TIK-ut:**

- Përdorni teknologjinë kompjuterike (Google Map) për të monitoruar rrjedhën e lumit Volga në Rusi! - Sa akumulime artificiale vëreni dhe cilat janë ato?
- Kërkoji dhe mësoji tiparet hidrografike dhe biogeografike të Liçenit të Bajkalit! - Bëj një prezantim të shkurtë!



# UKRAINA



## Diskutim interaktiv hyrës:

- Monumentet dhe vlerat kombëtare: Kiev, Krime, Çernobil, Dniepri...  
– Cilat janë paranjohuritë e tua?

**VEÇORITË NATYRORE** Ukraina përfshin pjesën jugperëndimore të Evropës Lindore. Nga tri anë kufiri i saj është tokësor. Në veri kufizohet me Bjellorusinë, në lindje me Rusinë, në perëndim me Moldavinë, Rumaninë, Hungarinë, Sllovakinë dhe Poloninë. Vetëm kufiri jugor nuk është tokësor. Ukraina ka dalje në ujërat e **Detit Azov** dhe **Detit të Zi**. Brenda këtyre kufijve, Ukraina zë një sipërfaqe prej 603.628 km<sup>2</sup>. Rreth 43 milionë banorë jetojnë në Ukrainë. Ukraina ka pozitë të volitshme gjeografike. Ajo del në dy dete, përmes të cilave lidhet me Detin Mesdhe dhe të gjitha vendet bregdetare në botë. Lumi **Danub** kalon nëpër territorin e saj, i cili e lidh atë me ujë me të gjitha vendet e Danubit.


**Relievi** në Ukrainë është kryesisht **ultësinor**, veçanërisht në zonën pellgut të poshtëm të lumit Dniepër. Në pjesën perëndimore, në kufirin me Rumaninë, ngrihen **Karpatet**. Në perëndim të Dnieprit, ka rrafshnalta të ulta (pllaja): **Volinska**, **Podolska** dhe **Pranë Dnieprit**). Në lindje të Dnieprit është **Rrafshnalta Donjeck**.

**Klima** në Ukrainë është **kontinentale**. Në jug mbizotëron **klima mesdhetare**, nën ndikim nga Deti i Zi, ku shtrihet bashkësia e **myshqeve**.

**Lumenjtë** janë të pasur me ujë. Lumi **Dniepër** ka rëndësi më të madhe. Ai është i lundrueshëm dhe shumë i rëndësishëm për ujitje. Kjo është arsyeja pse disa **liqene artificiale** janë ndërtuar mbi Dniepër. Uji prej tyre përdoret dyfish - për ujitje dhe energji elektrike. Nga lumenjtë e tjerë, më të rëndësishëm janë: **Donjec**, **Bug**, **Dniestri** e të tjerë.



<b>Emri</b>	Ukraina
<b>Kryeqyteti</b>	Kievi
<b>Sipërfaqja (km<sup>2</sup>)</b>	603.628
<b>Numri i banorëve</b>	42.418.000
<b>Rregullimi</b>	republikë
<b>Gjuha zyrtare</b>	ukrainishtja



Harta topografike e Ukrainës



Dniestri

**POPULLSIA DHE EKO-NOMIA** Popullsinë e Ukrainës e përbëjnë **ukrainasit** (78%) dhe **rusët** (17%). Këta janë popuj që i përkasin grupit sllav. Gjuha zyrtare është **ukrainishtja**, megjithëse në regjistrimin e fundit, 30% e popullsisë e kanë deklaruar rusishten si gjuhën e tyre amtare. Si përkatësi kryesore fetare konsiderohet feja ortodokse. Ngjyrosjen tradicionale e vezëve të Pashkëve, ukrainasit e kanë ngritur në nivelin e artit. **Problemi demografik** në Ukrainë është rënia e popullsisë, për shkak të emigrimit, vdekshmërisë së lartë dhe nivelit të ulët të lindjeve. Që nga viti 1990, Ukraina mesatarisht zvogëlohet rreth 150.000 banorë në vit. Ukraina është republikë, dhe kryeqyteti i saj është **Kievi**.

**Burimet natyrore** të Ukrainës janë hapësira të mëdha të tokave pjellore të pasura me humus. Ajo është thesari i saj më i madh natyror. Nga pasuria minerale, ky vend ka: **qymyr guri, antracit** (qymyr me cilësi më të lartë), **xehe hekuri, mangan, uranium** etj. Në qytetin **Zaporozhje** gjendet centrali më i madh bërthamor në Evropë. Gjysma e energjisë prodhohet në **centrale bërthamore**. Pjesa tjetër sigurohet nga hidrocentralet, termocentralet dhe panelet diellore.


**Bujqësia** është një degë me rëndësi të lartë. Përpunimi i tokës është plotësisht i mekanizuar. Nga kulturat kryesisht kultivohet: **gruri, panxhar sheqeri, misri, patatja, luledielli**, etj. Përveç kësaj, kultivohen: pemët, hardhitë dhe kulturat kopshtare.

**Industria** zhvillohet në bazë të qymyrit, i cili ndodhet në basinin Donjeck. Në Ukrainë zhvillohen: **industria metalike, mekanike, kimike, ushqimore,**



Kievi

**Grafiku 2:** Shpopullimi në Ukrainë



Harkovi

e tekstilit e të tjera. Vitet e fundit prodhimi industrial ka përjetuar një recesion të përgjithshëm, për shkak të kushteve të reja të krijuara të tregut, pasi prej kohësh është përqendruar në nevojat e vendit të mëparshëm (BRSS), kur u prodhuan: armë (tanke, topa, raketa), makina minerale dhe bujqësore, teknologjia hapësinore, aeroplanë, kamionë, automobila etj. Qendrat industriale janë: **Kievi, Harkovi Odesa, Zaporozhje, Lavov** etj.

**Turizmi** sjell të ardhura modeste. Më të vizituara janë disa vendpushime verore dhe qendra për skijim në Karpate.

**NDARJARAJONALE** Ukraina është e ndarë në aspektin administrativ në 24 provinca dhe qytetin e Kievit si njësi e veçantë. Provinca jugore e **Krimesë**, së bashku me njësinë speciale, qyteti i **Sevastopolit**, kanë status autonom që nga aneksimi nga Rusia në vitin 2014.

**Tabela 2:** Pesë qytetet më të mëdha në Ukrainë

Qyteti	Popullsia
Kiev	2.900.000
Harkov	1.440.000
Odesa	1.016.000
Dniepropetrovsk	980.000
Donjeck	929.000



Odesa

**Për njohuri të thelluara:**

- Gjatë shekullit XX-të, Ukraina përjetoi tri kriza demografike me miliona viktima. E para, gjatë Luftës Civile (1918-1921), më pas Uria e Madhe (1932-1933) dhe Lufta e Dytë Botërore, e cila mori gjithsej mbi 14 milionë jetë.
- Ukraina ka zhvilluar mbi 2.400 km rrugë ujore.
- Vlerat e famshme dhe tërheqëse për ta vizituar Ukrainën:

Objekte natyrore	Vende turistike	Monumentet kulturore-historike	Qytete
Dniepër	Jalta	Shën Sofia, katedrale	Bahçisaraj
Kanioni Dniestër	Odesa	Qyteti i vjetër, Lavov	Kerç
Liçeni Sinevir	Kiev	Man. Peçerskaja Lavra	Çerkasi

**Për të kontrolluar njohuritë e fituara:**

- Përshkruaj çfarë burimesh natyrore ka Ukraina?
- Çfarë probleme demografike ka Ukraina?
- Cilat industri janë zhvilluar në Ukrainë?



**Detyra me aplikimin e TIK-ut:**

- Mundohu të bësh një studim të përafërt kompjuterik për gjatësinë e lumit Dniepër. Sa është i gjatë? Cilat qendra të qyteteve janë të vendosura në brigjet e Dnieprit?
- Kërko dhe shiko video mbi pasojat mjedisore të katastrofës bërthamore të vitit 1986 në Çernobil në Ukrainë. - Hap diskutim në klasë bazuar në përshtypjet!

# BJELORUSIA DHE MOLDAVIA



## Diskutim interaktiv hyrës:

- Monumentet dhe vlerat kombëtare: Minsk, Kishinjev, Dniestër...  
- Cilat janë paranjohuritë e tua?



## BJELORUSIA



**VEÇORITË NATYRORE** Bjellorusia është shtet **kontinental** dhe nuk ka dalje në det. Kufizohet nga këto shtete: Rusia, Ukraina, Polonia, Lituania dhe Letonia. Bjellorusia ka një sipërfaqe prej 207.595 km<sup>2</sup> brenda këtyre kufijve. Sot, rreth 9.5 milionë njerëz jetojnë në Bjellorusi. Bjellorusia, edhe pse nuk ka dalje në det, ka **pozitë të volitshme gjeografike**. Shtrihet midis Moskës në lindje dhe Varshavës në perëndim. Shumë rrugë dhe hekurudha të rëndësishme trans-evropiane me rëndësi rajonale dhe ndërkombëtare kalojnë nëpër të. Ato e lidhin Bjellorusinë me Evropën Perëndimore dhe atë Lindore.

**Relievi** në Bjellorusi është **ultësinor**. Tokat janë pjesë të llore dhe të përshtatshme për bujqësi. Por në Bjellorusi ka edhe tokë me moçal, rreth 25%.


**Klima** në Bjellorusi është **kontinentale**. Verat janë të ngrohta, por dimrat janë dukshëm më të ftohtë se ata në Evropën Qendrore. Sasia maksimale e reshjeve që bie në

muajt e verës, qershor dhe korrik, në kryeqytetin Minsk mbizotëron klima kontinentale. Pasuria e ujit shihet në lumenjtë: **Dniepër, Pripjat, Berezina, Dvina Perëndimore, Njemen** etj. Në Bjellorusi ka mbi 4.000 liqene. Liqenet janë të vegjël dhe nuk kanë rëndësi të madhe ekonomike.

**POPULLSIA DHE EKONOMIA** Popullsia e vendit përbëhet nga: bjellorusët (84%), rusët (8%), polakët (3%) dhe ukrainasit. Gjuhët zyrtare janë rusishtja dhe bjellorusishtja, të cilat bëjnë pjesë në grupin e gjuhëve sllave. Feja ortodokse është më e përhapur me 48% të popullsisë. Si të gjitha vendet e Evropës Lindore, Bjellorusia ka problem me zvogëlimin e popullsisë për shkak të emigrimit dhe të mortalitetit të lartë dhe natalitetit të ulët. Bjellorusia është **republikë**. Kryeqyteti i saj është **Minski**.

<b>Emri</b>	Bjellorusia
<b>Kryeqyteti</b>	Minski
<b>Sipërfaqja (km<sup>2</sup>)</b>	207.595
<b>Numri i banorëve</b>	9.490.000
<b>Rregullimi</b>	republikë
<b>Gjuha zyrtare</b>	bjellorusishtja, rusishtja

**Grafiku 3:** Temperaturat mesatare mujore dhe sasia e reshjeve në Minsk



**Tabela 3:** Qendrat e rajoneve me emër të njëjtë në Bjellorusi

Qendrat rajonale	Popullsia urbane
Minsk	1.920.000
Gomel	526.000
Grodno	356.000
Mogilev	374.000
Brest	330.000
Vitebsk	366.000



Minsk

**Ekonomia** i trashëgoi marrëdhëniet e mëparshme ruso-bjelloruse. Energjetikisht është e varur nga Rusia dhe në varësi të politikës ekonomike ruse. Monedha **rubla** ruse përdoret në Bjellorusi. Nga burimet e energjisë, Bjellorusia ka **qymyr torfe** (lloji më i dobët i qymyrit). Pyjet janë shumë më të rëndësishme, pasi ato mbulojnë 31% të territorit. Përpunimi i tokës në Bjellorusi bëhet me makina moderne. Nga kulturat lavërtare më të kultivuara janë: **liri, patatet, thekra, panxhar sheqeri**, etj. Nga degët industriale më të zhvilluara janë: industria mekanike, kimike, e drurit dhe ajo ushqimore. Qendrat kryesore të këtyre degëve janë: **Minsk, Gomel, Vitebsk** etj.

**NDARJA RAJONALE** Bjellorusia është e ndarë në gjashtë rrethe administrative, të cilat ndahen në 118 rajone.



## MOLDAVIA

**VEÇORITË NATYRORE** Republika e Moldavisë shtrihet në Evropën Lindore, midis lumenjve Dniestër dhe Prut. Moldavia kufizohet me Ukrainën në lindje dhe Rumaninë në perëndim. Moldavia zë një sipërfaqe prej 33.846 km<sup>2</sup> dhe sot jetojnë mbi 3 milionë banorë. Kryeqyteti i shtetit është **Kishinjevi**.

**Relievi** në Moldavi është kryesisht ultësitor. Maja më e lartë në këtë vend është vetëm 430 metra.



Kishinjevi

Emri	Moldovia
Kryeqyteti	Kishinjevi
Sipërfaqja (km <sup>2</sup> )	33.846
Numri i banorëve	3.350.000
Rregullimi	republikë
Gjuha zyrtare	rumunishtja

**Klima** në Moldavi është e mesme kontinentale. Karakterizohet nga: dimra të ftohtë, vera të nxeh-ta dhe me sasi të vogël reshjesh.

Nga **lumenjtë**, me shumë rëndësi për këtë vend janë: **Dniestri** dhe **Pruti**, të cilët janë të lundru-eshëm dhe rrjedhin në Detin e Zi.

**POPULLSIA DHE EKONOMIA** Përveç **moldavëve** (75%) në këtë vend jetojnë po-puj të tjerë: **rumunë, ukrainas, rusë, gagau-zë** e të tjerë. Shumica janë **ortodoksë** (94%). Gjuha zyrtare është **rumunishtja**, një dialekt i quajtur moldavishte.


Moldavia është një nga vendet më pak të zhvilluara ekonomikisht në Evropë, me një standard të ulët dhe popullsi mjaft të varfër. Energjetikisht është e varur nga Rumania dhe Ukraina. Pjesëmarrja e bujqësisë në të ardhur-at vjetore është e lartë (20%).

Nga kulturat **bujqësore** përfaqësohen më shumë: drithërat, kulturat kopshtare, industriale, frutat dhe hardhitë.

Nga degët **industriale** në Moldavi, më e zhvilluar është industria ushqimore, e cila përpunon pro-dukte bujqësore, pastaj: industria metalike, tekstile, elektroteknike, kimike e të tjera.

**NDARJA RAJONALE** Moldavia është e ndarë administrativisht në 32 provinca, tri komuna të qyteteve të veçanta dhe dy rajone autonome.

**Grafiku 4:** Struktura etnike në Moldavi



**Për njohuri të thelluara:**

- Gagauzët janë grup etnik me prejardhje turke që jetojnë në pjesët jugore të Moldavisë, Ukrainës, Azerbajxhanit, Kazakistanit dhe vendeve të tjera. Ata përdorin gjuhën e grupit turk dhe u përkasin të krishterëve ortodoksë.
- Bizoni evropian është simbol i Bjellorusisë. Areali i tij natyror, si një nga speciet e rrezikuara dhe të rralla në Evropë, është Parku Kombëtar Belaveskaja, në kufirin midis Bjellorusisë dhe Polonisë.
- Vlerat e njohura dhe tërheqëse për ta vizituar Bjellorusinë dhe Moldavinë:

Objekte natyrore	Vende turistike	Monumentet kulturore-historike	Qytete
Parku Belaveskaja	Grodna	Kalaja, Paqja	Gomel
Parku Bjarezinski	Minsk	Kalaja, Niavizh	Vitebsk
Liçeni Manta	Orhej (Mol.)	Porta triumfale (Mol.)	Tiraspol (Mol.)
Prut i Ulët, rezervat	Kishinjev (Mol.)	Muzeu komb. hitorik (Mol.)	Balti (Mol.)



**Për të kontrolluar njohuritë e fituara:**

- Pse Bjellorusia ka pozitë të volitshme gjeografike edhe pse nuk ka dalje në det?
- Cilët lumenj janë më të rëndësishëm në Bjellorusi?
- Me cilat probleme përballen popullsia dhe ekonomia e Bjellorusisë dhe Moldavisë?



**Detyra me aplikimin e TIK-ut:**

- Kërko, hulumto dhe bëje një tabelë me të dhëna themelore natyrore dhe demografike për Bjellorusinë dhe Moldavinë, si dhe një listë të qyteteve të tyre kryesore!
- Kërko dhe krahasoji treguesit bazë ekonomikë të Moldavisë me vendin tonë. - Cilat janë ngjashmëritë dhe dallimet?

# LETONIA, ESTONIA DHE LITUANIA



## Diskutim interaktiv hyrës:

- Monumentet dhe vlerat kombëtare: Talin, Riga, vendi i basketbollit... – Cilat janë paranjohuritë e tua?

Emri	Letonia	Estonia	Lituania
Kryeqyteti	Riga	Talini	Vilnisi
Sipërfaqja (km <sup>2</sup> )	64.589	45.227	65.300
Numri i banorëve	1.925.000	1.324.000	2.794.000
Rregullimi	republikë	republikë	republikë
Gjuha zyrtare	letonishtja	estonishtja	lituanishtja



**VEÇORITË NATYRORE** Vende të Evropës Lindore dhe **Baltikut**, që dalin në brigjet lindore të Detit Baltik.

**Relievi** në këto vende është kryesisht ultësinor, në disa vende me moçal, përveç në pjesë të Lituanisë, ku vërehen më shumë ngritje.

**Klima** lëviz prej **atlantike** në **kontinentale**, duke shkuar drejt lindjes, sa më larg bregdetit.

**Pasuritë ujore** përfaqësohen nga lumenjtë në **Letoni** (Dvina Perëndimore) dhe **Lituania** (Njemen), ndërsa **Estonia** njihet si tokë liqenore (1.400), nga të cilat më i madh është **Liqeni Peipus**.




Trakaj - kështjellë në ishullin Galve në Lituani

**Tabela 4:** Përbërja etnike dhe fetare në: Letoni, Estoni dhe Lituani

Letonia		Estonia		Lituania	
Popujt	Religjioni	Popujt	Religjioni	Popujt	Religjioni
Letonët (62%)	protestantë (34%)	Estonezët (68%)	ortodoksë (16%)	Lituanët (84%)	katolikë (77%)
Rusët (25%)	katolikë (24%)	Rusët (25%)	protestantë (10%)	Polakët (6%)	ortodoksë (4%)
Bjellorusët (3%)	ortodoksë (18%)	Ukrainasit (2%)	katolikë (0,5%)	Rusët (6%)	protestantë (1%)
Ukrainasit (2%)	/	Bjellorusët (1%)	/	Bjellorusët (1%)	/
Polakët (2%)	/	Finlandezët (0,6%)	/	Ukrainasit (0,5%)	/

**Grafiku 5:** Popullsia në qendrat më të mëdha të qyteteve të Letonisë, Estonisë dhe Lituani



### POPULLSIA DHE EKONOMIA

Letonët dhe lituanët si popuj baltikë i përkasin grupit indo-evropian, ndërsa estonezët i përkasin grupit euro-finlandez. Në të tre vendet, përveç shumicës nacionale, përfaqësohen popuj nga vendet fqinje: **rusët, polakët, bjellorusët** dhe **ukrainasit**. Religjionet më të zakonshme janë: **katolike** (Lituani), **protestante** (Letoni) dhe **ortodokse** (Estoni). Në frymën e shumicës së vendeve të Evropës Lindore dhe të Baltikut, ata kanë problem me uljen e popullsisë për shkak të niveleve të ulëta të lindjeve dhe emigracionit. Sipas rregullimit shtetëror, ato janë **republika**.

**Burimet natyrore** në të tre vendet nuk ofrojnë një bazë për zhvillim të lartë ekonomik. Letonia është e pasur me **torfe**, kurse Lituania qëndron me pasurinë e saj pyjore, e cila mbulon 56% të territorit të shtetit.

Ekonomitë kombëtare janë përgjithësisht të paqëndrueshme. Shpesh tronditen nga krizat financiare dhe rritje negative vjetore, kurse Estonia qëndron më mirë në aspektin ekonomik. Eksportet në këto vende janë



Riga



Talini



gjithashtu të kufizuara. Tregtohet kryesisht me vendet fqinje.

**Bujqësia** është e orientuar drejt prodhimit të: patateve, el-bit, grurit, panxhar sheqerit dhe lirit, kurse nga bagëtitë, rritja e: bagëtisë, derrave dhe deleve. Përveç tyre, zhvillohet peshkimi dhe pylltaria (Lituani).

**Degët industriale** janë ndër sektorët më të lehtë dhe kanë për qëllim tregun e brendshëm: ushqim, dru, elektroteknikë, industria e letrës, qelqit dhe industri të tjera. Vitet e fundit, teknologjia e informacionit është zhvilluar më së shumti në Lituani dhe Estoni.

Estonia është ndër vendet e para në Evropë që zhvillon një "shoqëri digjitale".

**NDARJA RAJONALE** Për sa i përket administrimit, Letonia është e ndarë në 9 rajone - qytete, Lituania në 10 qarqe dhe Estonia në 13 qarqe dhe 2 qarqe ishujsh



Vilnius

**Për njohuri të thelluara:**

- Statusin e republikave të pavarura dhe sovraane, vendet baltike Letonia, Estonia dhe Lituania e fituan pas shpërbërjes së ish-Bashkimit Sovjetik (BRSS) në vitin 1991, në të cilin u futën me forcë në fillim të Luftës së Dytë Botërore në vitin 1939/40.
- Një nga parqet më të mëdha kombëtare evropiane, Lahema, në Estoni zë 725 km<sup>2</sup>. Përfshin bregdetin verior të Gjirit të Finlandës. Parku është thesar i: dunave të rërës, liqeneve (lagunave), ujëvarave dhe botës shtazore të pasur.
- Vlerat e njohura dhe tërheqëse për t'i vizituar Letoninë, Estoninë dhe Lituanië:

Objekte natyrore	Vende turistike	Monumentet kulturore-historike	Qytete
Parku Gauja (Letoni)	Sigulda (Letoni)	Qyteti i Vjetër, Riga (Letoni)	Riga (Letoni)
Sarema (Estoni)	Parnu (Estoni)	Katedralja, Tartu (Estoni)	Talin (Estoni)
Ishulli Trakaj (Lituania)	Vilnius (Lituani)	Katedralja, Vilnius (Lituani)	Kaunas (Lituani)

**Për të kontrolluar njohuritë e fituara:**

- Si është pozita gjeografike e Letonisë, Estonisë dhe Lituanië?
- Cilat janë veçoritë e përgjithshme të relievit dhe klimës në vendet baltike të Evropës Lindore?
- Si është rregullimi shtetëror i Letonisë, Estonisë dhe Lituanië?

Google

**Detyra me aplikimin e TIK-ut:**

- Hulumto nëpërmjet vëzhgimit satelitor (Google Earth) sa është largësia detare e Letonisë, Estonisë dhe Lituanië nga fqinjët e tyre më të afërt (Suedia dhe Finlanda)!
- Kërko, hulumto dhe bëje një raport të shkurtër për vlerat kulturore në ndonjë nga kryeqytetet e vendeve baltike të Evropës Lindore!

# FJALORI I FJALËVE MË PAK TË NJOHURA

**Aglomerim**, vendbanime të zgjeruara dhe të shkrira në një zonë të madhe urbane.

**Albedo**, Pjesë e rrezatimit diellor që reflektohet nga sipërfaqet tokësore dhe ujore.

**Aneksim**, përvetësim me forcë dhe bashkëngjitje e territorit të huaj shtetëror.

**Antropogjen**, të natyrës njerëzore; nga faktori njeri.

**Areal**, territor me shpërndarje natyrale të ndonjë grupi të caktuar bimësh ose specie shtazore.

**Asimilim**, shkrirje etnike, gjuhësore ose kulturore të popullit të vogël në popullin më të madh.

**Ateistët**, njerëz që nuk i besojnë hyjnitë ose nuk i përkasin ndonjë feje.

**Bedema**, (Diga-Penda) argjinatura natyrore ose artificiale (mbrojtëse).

**Bezisten**, tregje të mbuluara për tregti me stil orientale-turke.

**Bimë të ulëta**, talofite, bimë që nuk kanë diseksion trupor të: rrënjës, kërcellit dhe gjethit.

**Delta**, hyrje e degëzuar lumore në degë të shumta lumenjsh.

**Demografi**, disiplinë shkencore që merret me studimin e popullsisë.

**Diskriminim**, ndarje ose trajtim jo i njëjtë, i pabarabartë i anëtarëve të grupeve të ndryshme.

**Emigrantë, shpërngulës**; persona që emigrojnë nga ndonjë vend në tjetër.

**Enklavë**, rajon ose shtet që kufizohet vetëm me një shtet nga të gjitha anët; zonë e veçantë nga toka amë.

**Erozion**, shkatërrimi mekanik dhe kimik i relievit nga faktorë të jashtëm.

**Fjeld**, sipërfaqe të sheshta me origjinë akullnajore në malet e Gadishullit Skandinav.

**Fjord**, lugina të zhytura, akullnajore dhe të shndërruara në gjire të thella dhe të ngushta.

**Grimca të pezulluara**, grimca në ajër ose në ujë me diametër 1 - 100 mikrometra (0.001 - 0,1 mm).

**Grykë (Qafë) mali**, pjesë të ulta malore ose hapje të luginës natyrore nëpër të cilat kalojnë rrugët.

**Habitat**, vendbanime natyrore të një lloji.

**Hidrografi**, disiplinë shkencore që merret me studimin e ujërave e Tokës (e kufizuar në përshkrimin dhe paraqitjen e ujërave).

**Homogjene**, e barabartë, e njëjtë, nga e njëjta materie.

**Impozante**, e bukur, mbresëlënëse, e admirueshme.

**Infrastrukturë**, objekte nga baza teknike, ekonomike dhe organizative (rrugë, shkolla, spitale, ujësjellës...).

**Kep**, pjesë e tokës që depërton më thellë në det.

**Klif**, prerje e pjerrët bregdetare e krijuar nga veprimi eroziv i valëve të detit.

**Kozmopolit**, botëror; mosndarja nga kombësia dhe përkatësia shtetërore.

**Kreshta**, pika më të larta përgjatë vargmalit ku takohen shpatet e malit.

**Kriptodepresion**, liqen sipërfaqja e ujit e të cilit është mbi nivelin e detit dhe fundi i tij është nën nivelin e detit.

**Maki**, emër për kaçubë mesdhetare me gjelbërim të përhershëm.

**Mikrometër**, njësi matëse për gjatësi (pjesa e njëmijte e milimetrit;  $10^{-6}$  m).

**Ngushticë**, vend që ndan dy sipërfaqe tokësore dhe lidh dy sipërfaqe ujore.

**Paralele**, vija rrethore të imagjinuara përreth Tokës, që janë paralele me Ekuatorin.

**Përmijë**, pjesë e një mijtë; shprehje e sasisë ose shkallës së karakteristikave demografike (rritje natyrore).

**Pika e matjes**, vende të përcaktuara për matjen e disa vlerave (ndotja meteorologjike, hidrologjike, e ajrit...)

**Regjim i ujit**, ndryshim i nivelit të ujit dhe rrjedhja e ujit në lumenj çdo vit.

**Rrjedhë**, sasi e ujit që rrjedh në njësi të kohës në lumenj (e shprehur në metra kub për sekondë, m<sup>3</sup>/s).

**Sintezë**, bashkim, komponim i pjesëve të ndryshme në një tërësi.

**Shovinizëm**, tendencë negative sociale për përçarje në baza etnike, fetare, gjuhësore ose bazë tjetër.

**Shpopullim**, trend negativ në lëvizjen e numrit të popullsisë, pra zvogëlim i popullsisë.

**Shtete sovrane**, shtete të pavarura me liri të pakufizuar.

**Toreador**, luftëtar me dema në koridë - lojë kombëtare spanjolle ose portugeze.

**Torfe**, qymyr me kalori të ulët, të formuar nga bimë të kalbura në kënetë ose ish pellgje uji.

**Vijë kufitare natyrore**, objekt natyror që në vetvete është kufi (kreshta malore, lumi, bregu i liqenit, etj).

**Zhavorr**, sediment jo i lidhur i copave të mëdha të rrumbullakëta shkëmbore.

## LITERATURA E PËRDORUR

**ВЕЛИКИ АТЛАС СВЕТА.** 1977. Љубљана, Младињска књига

**Гек Р. СВА ЧУДА СВЕТА.** 1977. Љубљана, Младињска књига

**Bridges E. M.** *World geomorphology.* 1994. Cambridge

**Gardner P.** *Enciklopedija svetovne geografije.* 1997, Ljubljana

**Đurić V.** *Ekonomska geografija Evrope I SSSR.* 1974. Beograd, Naučna knjiga

**Natek K., Natek M.** *DRŽAVE SVIJETA.* 2004. Zagreb, Mozaik knjiga

**Norris E. R.** *World regional geography.* 1990. Saint Paul

**Marković J.** *Enciklopedijski Geografski Leksikon Jugoslavije.* 1988. Sarajevo, Svjetlost

**Mayhew S.** *Dictionary of GEOGRAPHY.* 1997. Oxford, Oxford University Press

**Pavlovski Gj.** *Gjeografia për klasën e gjashtë.* 1995. Shkup, Prosvetno dello

**Pavlovski Gj., Pavlov K., Milenkovski A., Mihajlov P.** *Gjeografia për klasën e shtatë.* 2008. Shkup, Prosvetno dello

**Pavlovski Gj., Pavlov K.** *Gjeografia për klasën e shtatë.* 2009. Shkup, MASH

**Regional surveys of world.** *The Europa world year book.* 1999. London

**Smart N.** *The world's religions.* 1998. Cambridge

**www.WorldAtlas.com**

**<https://en.wikipedia.org/wiki/Europe>**

